



Personaliteti drejtues
i PROFETIT MUHAMED (s.a.s),
sipas këndvështrimit të Imam Khameneit

Tiranë, 2021

Titulli: Personaliteti drejtues i Profetit Muhamed (s.a.s), sipas këndvështrimit të Imam Khameneit

Autori: Imam Sejjid Ali Khamenei

Përktheu: Vullnet Merja

Redaktoi: Jerida Kulla

Korrekttoi: Vjollca Karaj

Përgatiti për shtyp: Sabrie Feza

Kopertina: Sabrie Feza

Botoi: Shoqata "FLLADI"

PARATHËNIE

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, të Gjithëmëshirshmit!

*Falënderimi i takon Zotit të botëve! Paqja e mëshira e Allahut
qoftë mbi Muhamedin dhe familjen e tij të pastër!*

Përcjellja e mesazhit islam kaloi në duart e Profetit të madh, Muhamed bin Abdullah (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Pas shpalljes, misioni profetik kaloi në fazat e mëposhtme:

Përballja e parë dhe paralajmërimi i të afërmve:
Kur lajmi i Islamit u përhap në Gadishullin Arabik, si dhe grupi i besimtarëve arriti nivelin shpirtëror, që i bënte ata të aftë për t'u përballur me luftën kundër të keqes, atëherë u pa se ishte e nevojshme të kalohej në fazën e njoftimit publik. Hapi i parë i kësaj faze ishte paralajmërimi i të

afërmve. Më pas, do të fillonte një përballje gjithëpërfshirëse me udhëheqjen tirane të kurejshëve.

Përballja gjithëpërfshirëse: Thirrja e Beni Hashimëve në fenë e re pati një ndikim të madh në mesin e fiseve arabe. Atyre iu bë i qartë serioziteti i profetësisë së Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe serioziteti i fesë në të cilën po thirreshin njerëzit në të. Kështu, u krijuan kushtet dhe mjedisi i duhur për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për ta përcjellë mesazhin.¹ Paria kurejshe ndihej e kërcënuar në gjithçka që ata besonin, në projektet dhe entitetin e tyre. Kjo i bëri ata, që të drejojnë shigjetat e dyshimit, të talljes dhe të përqeshjes mbi Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe në atë që ai ftonte. Ata përdorën persekutimin, vrasjen, torturat dhe bojkotin kundër të gjithë atyre që e besuan dhe e pasuan Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Nga këtu lindi ideja për të kërkuar hapësira dhe vende të tjera, për ta përcjellë dhe për ta përhapur mesazhin hyjnor.

¹Allahu i Madhëruar thotë: "**Ti prediko haptazi atë që të është urdhëruar dhe largohu nga idhujtarët.**" (Sure Hixhr, ajeti 94.)

Emigrimi: Dy vjet pas njoftimit të përgjithshëm të mesazhit hyjnor, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ndjeu vështirësinë e sigurimit të mbrojtjes për të gjithë myslimanët nga tiranët kurejshë. Kjo ishte arsyeja, pse ai i nxiti ata të emigronin në Abisini, sepse aty një mbret nuk i bënte padrejtësi askujt dhe nuk shtypte askënd.

Ngjarjet u përshpejtuan pas emigrimit të myslimanëve në Abisini. Kurejshët vendosën të bojkotonin në mënyrë gjithëpërfshirëse Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Beni Hashimët. Ata i rrethuan, derisa të zhdukeshin.

Ata donin që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të vdesë pas vdekjes së Ebu Talibit (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*), i cili ishte jo vetëm mbrojtësi më i madh i Profetit, por edhe i mesazhit të tij hyjnor, dhe vdekjes së nënës së besimtarëve, Hatixhesë (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*), e cila ishte mbrojtësja dhe mbështetësja e dytë më e madhe e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në mes të këtyre ngjarjeve të dhimbshme, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), vendosi të shkojë në Taif, ku banonte fisi Thekif, i cili ishte fisi më i madh arab pas

kurejshëve. Banorët e Taifit u sollën shumë vrazhdë me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kështu që ai u kthye në Mekë.

Hixhreti (emigrimi) i madh (drejt Jethribit): Pas përfundimit të përgatitjes së brendshme të myslimanëve në Mekën e ndritur dhe arritjes së një lloj komunikimi ndërmjet Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe personaliteteve e fiseve nga Jethribi, u arrit besa, deri në premtimin e besnikërisë. U realizua besa (El Bej'atu) e parë në Akaba dhe besa (El Bej'atu) e dytë. Në këtë mënyrë, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) arriti të përgatisë terrenin e duhur në Jethrib, si një vend i përshtatshëm për ndërtimin e shtetit.

Në të njëjtën kohë, kurejshët i përfunduan përgatitjet e tyre për të zhdukur Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ata përfunduan takimin në Dar el-Nedua, ku vendosën të vrisnin Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Gjaku i tij do të shpërndahej midis fiseve. Atëherë erdhi urdhri hyjnor, që e urdhëronte të lëvizte dhe të emigronte në Jethrib. Hapat e ndërmarra nga Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), mund të përmbledhen si më poshtë:

- Ndërtimi i xhamisë, për të qenë një qendër: për adhurimin, veprimtarinë, menaxhimin e komunitetit dhe punët e çështjet e njerëzve.

- Vëllazërimi midis muhaxhirëve (emigrantëve) dhe ensarëve (mbështetësve, banorëve vendas): me qëllim krijimin e lidhjeve të reja midis njerëzve, mbi bazën e lidhjes së besimit dhe fesë, tejkalimin e marrëdhënieve të gjakut dhe fisnore.

- Traktati i Medines, me fuqitë e tjera: Me qëllim që të përfundoheshin konfliktet dhe luftimet me të tjerët, veçanërisht hebrejve, si dhe t'i kushtohej kohë ndërtimit të bashkësisë së brendshme, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) eci drejt nënshkrimit të një traktati bashkëpunimi midis myslimanëve dhe fuqive të tjera. Mund të thuhet se kjo marrëveshje ishte e para që kishte rolin e projektit të kushtetutës, për të ndërtuar një shtet të zhvilluar islam në shoqërinë e Medines.

- Ky libër, "Personaliteti drejtues i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), sipas këndvështrimit të Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*)" është një studim objektiv analitik mbi cilësitë e personalitetit udhëheqës të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), bazuar

në leximin e asaj që ndodhi me të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Një lexim objektiv dhe analitik gjatë përcjelljes së mesazhit islam dhe ndërtimit të shtetit islam, nga Imam, Zotëria Ali Khamenei.

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve!

Qendra “Nun”

Qendra për botim dhe përkthim

E VËRTETA EKZISTENCIALE

Pishtari ndriçues

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues; njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues”**.²

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte pishtar ndriçues. Çështja e pishtarit nuk është se ai ndriçon, kur do ai të ndriçojë dhe, nëse nuk do të dëshironte të ndriçonte, nuk do të ndriçonte. Pishtari ndriçon, do apo nuk do. Kudo që ai është dhe ndodhet, e ndriçon mjedisin rreth tij. Kudo që ai ndodhet, e kthen atë vend në dritë. Allahu i Madhëruar e ka krahasuar të Dërguarin me një pishtar. Jo pishtar të fikur, por pishtar i ndezur: pishtar ndriçues, kudo që ai

² Sure “El Ahzâb”, ajetet 45-46.

ndodhet. Atmosfera e jetës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe mjedisi përreth tij, në thelb, është ndriçues. Ai e ndriçonte atmosferën me moralin, me sjelljen, me mënyrën e tij të punës, me marrëdhëniet e tij, me njohuritë e tij, me urtësinë e tij, pavarësisht nëse i jepte mësimë dikujt apo jo.

Drita e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ndriçonte vetëm kur ai shkonte në xhami dhe kur u predikonte njerëzve, por ajo ndriçonte edhe kur ai ishte ulur në shtëpinë e tij, kur ishte në heshtje, kur ecte apo kur ishte në fushën e betejës.

Në të gjitha këto situata dhe kushte, prania e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndriçonte. Ai ishte dritë dhe ndriçonte në të njëjtën kohë. Kjo ndodhte nga përsosja e lëvizjeve të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ngaqë qetësia e tij, fjalët dhe veprimet e tij ishin të gjitha në shërbim të Zotit dhe për hir të Zotit.³

³ Fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*), në Takimin vëllazëror për mbrojtjen personale 31.10.1986 (9.8.1365).

* Imam Khomeini, "Erbaine Hadijth", f. 551. Duhet të jeni të vetëdijshëm se Ehli Bejti, me pagabueshmërinë dhe pastërtinë e tij, gëzon një pozitë të lartë shpirtërore në udhëtimin moral drejt Zotit. Kjo e tejkalon aftësinë njerëzore, për ta kuptuar edhe nga pikëpamja shkencore. Ajo është më e lartë se mendjet e atyre që kanë intelekt.

Përgëzimi me mesazhe, në transmetimet e feve të mëparshme

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“...dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill”**.⁴ Ardhja⁵ e Profetit Muhamed

Ashtu si mësohet nga hadithet fisnike, ata ndajnë me të Dërguarin fisnik pozitën shpirtërore. Drita e tyre e pastër madhëron dhe shenjtëron cilësitë e tyre të larta, para krijimit të botës. Hadithet përcjellin përbërjen e trupave të tyre, krijimin e shpirtit të tyre, emri më i madh që atyre u është dhënë, dituritë e fshehta hyjnore nga dijet e profetëve dhe të engjëjve, si dhe çfarë është më madhështore, që askujt nuk i shkon ndërmend. Këto fakte, në lidhje me cilësitë e tyre, janë transmetuar në kapituj të ndryshëm nga librat më të njohur, veçanërisht libri “Usulul Kafi”. Transmetime të tilla arrijnë deri aty sa i hutojnë mendjet. Askush nuk u ka qëndruar të vërtetave dhe sekreteve, vetëm se ata vetë.

⁴ Sure “El A’râf”, ajeti 157.

⁵ Midis këtyre përgëzimeve, janë vargjet 14 dhe 15 të Librit të Judës, i cili thotë: “Tani do të vijë Zoti me dhjetë mijë shenjtorë, për t’i sunduar të gjithë dhe për të gjykuar të gjithë ata që nuk kanë fe dhe ...” (cituar nga teksti). Dhjetë mijë shenjtorët janë të barasvlershëm vetëm me shokët e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilët ishin me të, në historinë e çlirimit të Mekës. (Mukhtasar Hajatu Muhamed, i Sejid Hashim Resul Mahalatij, f. 7). Është përmendur në kapitullin e katërt të Ungjillit të Gjonit: 16, 17, 25 dhe 26: “Nëse më doni mua, atëherë ruajini ligjet e mia dhe unë do të kërkoj nga babai im dhe ... Ai do të jetë gjithmonë me ju.” Përmbledhja e kësaj është se e vërteta nuk mund të pranohet, sepse ai nuk e sheh atë dhe nuk e di atë. Ju e dini atë, sepse ajo mbetet me ju dhe do të jetë në

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)
është përgëzuar⁶ në të dy këta libra.

mesin tuaj. Unë ju thashë juve, se do të jem në mesin tuaj. Por, edhe “El Ferkalijt” Fryma e Shenjtë që Zoti dërgon në emrin tim, do t’ju mësojë gjithçka dhe Ai do t’ju përkujtojë gjithçka që ju kam thënë”. Sipas studimeve, “El Ferkalijt” përkthehet në arabisht si “Berkelitus”, që do të thotë “Ahmed”. Përkthyesit e ungjijve e përkthyen atë, me qëllim, ose gabimisht, si “argëtuesi”. (Ajatullah Xhafer Subhani, “Drita e Përjetësisë”, f. 89)

⁶ Sislsitu Ebhathu Usulul Akaid

BIOGRAFIA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)

Prejardhja e tij fisnike

Para se Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* t'i zbriste Shpallja, në Mekë kishte besimtarë. Ata ishin pasues të fesë hanefite. Prindërit e Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, gjyshërit⁷ dhe të parët e tij, ishin besimtarë.⁸

⁷ Profetit më i nderuar, Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)* rrjedh nga Profeti Ismail, i biri i Profetit Ibrahim. Këta dy personalitete dhe disa prej paraardhësve të mëdhenj të Profetit të madh të Islamit, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e arabëve dhe Islamit ... (Ajatullah Xhafer Subhani, "Drita e Përhetësisë", f. 89.)

* Paraardhësit e Profetit të Islamit, sipas radhës, janë: Abdullahu, Abdul El Mutalibi, Hashimi, Abdu Menafi, Kusai, Kilabi, Murretu, Ka'bi, Luei, Glibi, Fehri, Maliku, Nadari, Kenana, Hudhejma, Madrika,

Pasardhës i një prej familjeve më të mira

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka lindur në një familje të madhe. Ajo ishte një familje e njohur për rrënjët e saj madhështore. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), periudhën e lindjes, fazën e fëmijërisë dhe të rinisë, e jetoi në varfëri. Fisi i Beni Hashimëve⁹

Iliasi, Mudari, Nezari, Saadi dhe Adnani. ("Historia e Profetit të Islamit", Ajetulah Haxhi Shejh Abas Safaui Hairi, f. 115.)

* Banorët e Gadishullit Arabik gjatë shekujve paraislamë u ndanë në dy pjesë. Banorët e rajonit jugor të Hixhazit, sipas pemës gjenealogjike që vendosën. Ata thonë se e kanë prejardhjen nga Xhaurab bin Kahtani. Ai ishte djali i pestë i Nuhut. Ndërsa banorët e qendrës dhe të pjesës veriore të Gadishullit Arabik, thonë se e kanë prejardhjen e tyre nga linja e gjakut të Adnanit, i cili është një nga pasardhësit e Ismailit. ("Biografia analitike e Islamit", Sejid Xhafer Shehidi, f. 3 , cituar nga Muruxh El Dheheb, vëll. 1, f. 300.)

* Banorët e fundit të Hixhazit quheshin Ismail. Ismaili është djali i Ibrahimit (*Paqja qoftë mbi të!*). Ai jetoi afër Qabes dhe bijtë e tij ndërtuan Hixhazin. Në të vërtetë, ata ishin arsyjeja për madhështinë dhe zhvillimin e Hixhazit. Thuhet se Ismaili ishte ai që e ndërtoi Qaben. (Emir Ali, përkthyes: Muhammad Teki Fahr Da'i El Kilani, "Historia e arabëve dhe Islami", f. 5, botimet "Kenhijneh".)

⁸ Nga fjalimi i mbajtur në mbledhjen e Këshillit koordinues për mediat islame, më 24.12.1981 (3.10.1360).

⁹ Pavarësisht numrit të madh të fiseve, arabët u nënshtroheshin kurejshëve dhe ishin vartës të tyre, duke i konsideruar ata si më të nderuarit në mesin e tyre. Ebu Talibi, në ligjërimin e tij të njohur gjatë fejesës së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe*

konsiderohet si një nga degët më të rëndësishme dhe nga zotërinjtë e kurejshëve. A e dini cilët ishin xhaxhallarët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe çfarë respekti u bëhej atyre?! Hamzai, Ebu Lehebi, ose të tjerët konsideroheshin familje tradicionale. Në një familje të tillë, lindi i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).¹⁰

mbi familjen e tij!) me Hatixhen, ka thënë: “Falënderimi i takon Allahut, i cili na bëri nga fara e Ibrahimit dhe pasardhësve të Ismailit, na bëri një vend të sigurt dhe na bëri sundimtarë mbi njerëzit”. (Al'lametu El Mexhlisij, “Biharul Anuar”, vëll. 16, f. 14.)

Le të shohim fjalinë e fundit. Nga kjo fjali bëhet e qartë se kurejshët kishin autoritetin dhe komandën mbi arabët. Në ditën e parë të Dhul Hixhes, Hashimi ligjëroi në mesin e kurejshëve, ku midis të tjerash tha: “O kurejshë! A nuk jeni ju prijësit dhe udhëheqësit e arabëve, zotërinjtë e tyre, me pozitën më të lartë dhe prejardhjen më të mirë?” (“Sherh Nahxhul Belagatu” nga Ibn Ebul Hadid, vëll. 15, f. 211.)

Në të bëhet e qartë se kurejshët ishin zotërinjtë e arabëve, për sa i përket arsyes, paraqitjes, bukurisë dhe prejardhjes së nderuar. Ata kishin udhëheqjen dhe komandën ndaj të gjithë arabëve. (“Biografia e Profetit të Islamit”, Ajatullah Haxhi Shejh Abas Safai Hairi, f.115.)

¹⁰ Nga një fjalim që Imam Khamenei (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) mbajti në Komandën Qendrore të Gardës, më 9.9.1988 (17.07.1367).

TERRENI PËR FORCIMIN E ISLAMIT

Mjedisi i të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ishte nga një familje dhe një pemë që askush nuk e kishte të lehtë të përballej me të. Nëse i Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* do të ishte zgjedhur nga një familje e dobët, ose nga ndonjë familje e shoqërisë së ulët, kundërshtarët e tij do ta kishin më të lehtë të përballeshin me të dhe kjo pemë nuk do të zinte rrënjë.

Morali, sjellja dhe personaliteti i këtij personi, gjatë gjithë jetës së tij dyzetvjeçare, ka lënë shenjë tek të gjithë. Gjatë këtyre viteve ai e filloi thirrjen e tij, në kushte të tilla dhe Islami hodhi rrënjë.¹¹

¹¹ Nga një fjalim që Imam Khamenei *(Allahu i dhëntë jetë të gjatë!)* mbajti në Komandën Qendrore të Gardës, më 9.9.1988 (17.07.1367).

Familja e Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Babai i Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* vdiq para lindjes së tij dhe, sipas një transmetimi tjetër, disa muaj pas lindjes së tij.

Sipas zakoneve të familjeve fisnike dhe tradicionale në Hixhaz, fëmijët e tyre i dorëzonin te gra të dëlira dhe fisnike, për t'i rritur dhe për t'i edukuar. Ky fëmijë i dashur, drita e syve të familjes së tij, u vendos në familjen e një gruaje të respektuar dhe me tradita, nga fisi Beni Sad, e cila thirrej me emrin Halime El Sadije. Ajo e mori atë me vete në fisin e saj. Ky margaritar i çmuar qëndroi me të për gjashtë vjet. Ajo e ushqeui me gjë dhe e edukoi. Prandaj, Profeti Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u rrit në shkretëtirë (midis fiseve arabe).

Kohë pas kohe, ajo e sillte këtë fëmijë të begatë te nëna e tij, që zonja Emine ta shihte. Pastaj e merrte përsëri. Pas gjashtë vjetësh, ky fëmijë mori një edukim të shkëlqyer fizik dhe shpirtëror, pasi u bë i fortë fizikisht, i bukur, aktiv dhe me përvojë (i aftë). Shpirtërisht, ai ishte i fortë, i durueshëm, i sjellshëm dhe largpamës, cilësi thelbësore për jetën në ato rrethana. Ai u kthye te nëna dhe familja e tij.

Nëna u kujdes për këtë fëmijë dhe e mori me vete në Jethrib, për të vizituar varrin e babait të tij, i cili vdiq dhe u varros po atje. Më vonë, kur i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shkoi në Medine dhe po kalonte atje pranë, tha: “Babai im është varrosur këtu dhe mbaj mend se unë kam ardhur me nënën time këtu për ta vizituar varrin e tij”. Gjatë rrugës së kthimit, në një zonë të quajtur El Abua, nëna vdiq dhe fëmija mbeti jetim nga të dy prindërit. Nëna e Ejmenit¹² e çoi atë në Medine dhe e dorëzoi te gjyshi i tij.

Abdul Mutalibi u kujdes për këtë fëmijë sikurse kujdesej për shpirtin e tij. Në një nga poezitë e tij, Abdu Mutalibi thotë: “Unë jam si nënë për të”. Ky njeri i moshuar, i cili ishte afër njëqind vjeç, u kujdes për të. Ai ishte udhëheqësi i kurejshëve, populli i tij e donte dhe gëzonte një respekt të jashtëzakonshëm në mesin e tyre.

Një interes i madh u tregua për këtë fëmijë, në mënyrë që kompleksi i inferioritetit emocional të mos shfaqej fare tek ai dhe, në të vërtetë, nuk u shfaq. Është e mahnitshme se si ai arriti t’i përballojë dhe t’i durojë vështirësitë e të jetuarit pa baba dhe nënë, madje jo vetëm kaq, por t’i rritë aftësitë e tij dhe të forcojë gatishmërinë e

¹² Ummu Ejmen ka qenë shërbëtore e Abdullahut apo e Emine bintu Ueheb e cila u lirua më pas dhe u martua me Harith El Khazrexhij. Pas vdekjes së Harithit ajo u marua me Zejd ibn Harithetu dhe fryt i kësaj martese ishte Usama ibn Zejd.

tij, pa iu shfaqur as maja e gjilpërës shenjë inferioriteti, që mund t'i mundojë fëmijët e moshës së tij. Abdul Mutalibi e nderoi dhe e lartësoi atë në një mënyrë shembullore.

Librat e historisë dhe të haditheve kanë përmendur se një qilim dhe jastëk ishte vendosur për Abdul Mutalibin. Ai ulej në të dhe bijtë e tij dhe të rinjtë e Beni Hashimit mblidheshin me krenari dhe respekt rreth tij. Kur Abdul Mutalibi mungonte, ose ndodhej brenda Qabes, ky fëmijë vinte dhe ulej në vendin e tij. Kur Abdul Mutalibi kthehej, të rinjtë e Beni Hashimit i kërkonin këtij fëmije të ngrihej, duke i thënë: “Ky është vendi i babait tonë”. Abdul Mutalibi u përgjigjej: “Jo, ky është vendi i tij dhe ai duhet të ulet këtu”.

Në atë kohë, Abdul Mutalibi ulej anash dhe e linte atë fëmijë të dashur, të nderuar dhe të respektuar të ulej në vendin e tij. Ai ishte tetë vjeç, kur vdiq gjyshi i tij.

Në një transmetim tjetër përcillet se, kur Abdul Mutalibit po i afrohej vdekja, thirri djalin e tij, Ebu Talibin dhe i la amanet këtë fëmijë. I kërkoi që të kujdesej për të ashtu siç bëri ai. Ebu Talibi e mori fëmijën në shtëpi, duke u kujdesur për të si gjënë më të dashur. Ebu Talibi dhe gruaja e tij trime e mbrojtën atë. Ajo ishte Fatimja, e bija e Esedit, nëna e Prijësit të Besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Ky personalitet i madh, për gati dyzet vjet, u kujdes dhe e ndihmoi atë. Në këto rrethana dhe kushte

kaloi fëmijëria dhe rinia e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Tek ky fëmijë u rrënjosën cilësitë e jashtëzakonshme morale, personaliteti i dashur njerëzor, durimi dhe përballimi i dhimbjeve dhe i mundimeve, që mund t'i ndodhin një personi gjatë fëmijërisë. Të gjitha këto hapën terrenin për krijimin e personalitetit të madh dhe të fortë të ky fëmijë. Në këtë fazë, ai shoqëroi Ebu Talibin në një udhëtim për qëllime tregtare.

Udhëtimet tregtare u përsëritën, derisa arriti në fazën e rinisë dhe të martesës me Hatixhen. Ajo vazhdoi deri në moshën dyzetvjeçare, e cila është faza e profecisë.¹³

¹³ Pjesë nga hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 5.12.2000 (23.2.1379).

VETITË MORALE TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

*(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen
e tij!)*

Edukata hyjnore

Mësimi dhe edukimi i profetëve, të cilët konsiderohen si studentë të veçantë të Zotit të gjithësisë, jo vetëm është një çështje që ekziston, por është edhe mision. Kjo është diçka shtesë për arsimin. Në mision, ka, gjithashtu, mësim, edukim dhe rekomandim. Në të sillet libri dhe mençuria. Sidoqoftë, këto çështje nuk janë gjithçka, përkundrazi, është diçka që i shtohet asaj dhe ajo është ringjallja.¹⁴

Allahu i Madhëruar e ka edukuar karakterin shpirtëror dhe moral të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i*

¹⁴ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarë shtetërorë, më 9.12.1996 (19.9.1375).

Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) në kushte të përshtatshme për të dhe e ka përgatitur atë që të mund të mbartë amanetin e madh.

Mbi këtë bazë, po rritej aftësia shpirtërore e këtij fëmije, të cilit iu besua detyra e edukimit të një bote, bazuar në aftësinë e tij ekzistenciale dhe morale. Tek ky fëmijë ishin rrënjësor cilësitë më të larta morale, personaliteti i dashur njerëzor, durimi, përballimi i dhimbjeve dhe i mundimeve që një person mund të hasë gjatë fëmijërisë.

Allahu i Madhëruar nuk do t'ua caktojë këtë përgjegjësi të rëndësishme dhe serioze atyre që nuk merituan nivelet më të larta të virtyteve të moralit. Ky ishte edhe shkaku që Allahu i Lartësuar iu drejtua të Dërguarit të Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në fillim të misionit: **“Ti je me virtyte madhore”**.¹⁵

Ndërtimi dhe gdhendja e personalitetit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), për t'u bërë një argument i përshtatshëm për Shpalljen hyjnore, është një çështje që e kalon fazën para Shpalljes. Nga transmetime të shumta, shohim se i Dërguari fisnik (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në rininë e tij, merrej me tregti dhe fitonte shumë para nga kjo punë. Të gjitha këto para ai ua jepte sadaka të varfërve.

¹⁵ Sure “El Kalem”, ajeti 4.

Në këtë fazë, e cila është faza e fundit e plotësimit profetik dhe e para e shpalljes hyjnore, faza paraprirëse e profetësisë, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shkante në malin Hira dhe meditonte mbi argumentet hyjnore: qiellin, yjet, tokën dhe krijesat që jetojnë në tokë dhe mbartin një larmi emocionesh dhe ndjenjash. Ai meditonte mbi argumentet e mrekullueshme që Allahu i Madhëruar ka krijuar duke iu shtuar çdo ditë bindja dhe nënshtrimi ndaj të vërtetës. Në zemrën e tij rritej respekti kundrejt urdhrit hyjnor, vullnetit hyjnor. Farërat e moralit të mirë zhvilloheshin në të. Në një transmetim thuhet se ai ishte më i mençuri dhe më bujari i njerëzve. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), para Shpalljes hyjnore, po përsosej ditë pas dite, derisa arriti të dyzetat.¹⁶ Kur ai mbushi dyzet vjeç, Allahu i Madhëruar shikoi në zemrën e tij. Ai e gjeti atë më të mirën e zemrave, të lavdëruar, të bindur dhe të nënshtruar.¹⁷

Në moshën dyzetvjeçare, zemra e tij ishte e ndriçuar dhe e bindur. Ishte zemra më e gatshme për të pritur thirrjen hyjnore.

¹⁶ "Biharul Anuar", vëll. 17, f. 307, Botimi i dytë i korrigjuar, 1403-1983 Miladi, fondacioni "Al Uafa", Bejrut Liban, i autorit Al'lametu El Mexhlisij, Muhamed Bakir.

¹⁷ "Biharul Anuar", vëll. 17, f. 307, i autorit Al'lametu El Mexhlisij, Muhamed Bakir.

Portave të qiellit iu dha leja dhe ato u hapën dhe Muhamedi po shikonte në to. **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka)”**.¹⁸ Kur arriti në këtë fazë të ndjeshmërisë shpirtërore, në lartësinë e përsosmërisë, atëherë Allahu i Madhëruar hapi para tij portat e qiellit dhe dyert e botëve të fshehta. Ai i tregoi botën e fshehtë dhe atë shpirtërore. Ai u dha leje engjëjve dhe ata zbritën, dhe Muhamedi i shikoi ata. Ai i shihte engjëjt dhe u fliste atyre, madje dëgjonte fjalët e tyre, derisa zbriti tek ai engjëlli Xhibril dhe i tha: **“Lexo!”** Ky ishte fillimi i Shpalljes hyjnore.¹⁹

Lidhja me botën e fshehtë

Burimi i Shpalljes që vërshoi dhe qarkulloi në zemrën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ishte një udhëtim i rëndësishëm. Çështja nuk përfundon në kufijtë e asaj që Allahu e zbardhi të vërtetën dhe dritën në zemrën e një personi të veçantë, të shquar dhe të jashtëzakonshëm. Ky është hapi i parë dhe fillimi i punës. Sigurisht, kjo është pjesa më e rëndësishme e çështjes. Ndriçimi i kësaj drite në

¹⁸ Sure “El Alak”, ajeti 1.

¹⁹ Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarë shtetërorë dhe mysafirë të Konferencës së unitetit islam, më 31.5.1385.

zemrën e të Dërguarit fisnik dhe të bekuar, dhe marrja prej tij e përgjegjësisë së Shpalljes, është pjesa që e lidh në mënyrë të qartë botën e krijimit, botën e ekzistencës njerëzore dhe materiale me përbërësit e të padukshmes. Këtu qëndron lidhja.

Megjithëse bekimet hyjnore ishin gjithmonë të pranishme, gjatë gjithë udhëtimit, lidhja ishte e dukshme në momentin e Shpalljes, e cila buroi nga bota e padukshme (alemu el-gajb). Burimi i të vërtetave hyjnore dhe burimi i Shpalljes - kjo fjalë është e mjaftueshme - të shpirti i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është hapi i parë i Shpalljes hyjnore.²⁰

Pagabueshmëria

Pagabueshmëri do të thotë një gjendje e sigurt. I pagabueshëm është personi i shpëtuar, të cilin nuk e kërcënon rreziku. Sa për atë që ai nuk kërcënohet nga rreziku, nuk është sepse ai ka arritur një pikë, ku nuk ka asnjë lloj rreziku. Kjo do të thotë se ai ka arritur në një pikë, ku mbikëqyrja, kujdesi dhe devotshmëria janë në një nivel

²⁰ Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarë shtetërorë, më 19.9.1375.

të tillë që nuk pranon shthurjen. Nëse i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk do ta kishte përjetuar atë gjendje devotshmërie në nivelin më të lartë të imagjinuar te njerëzit, ai do të ishte në rrezik.

Natyra e njeriut dhe vetë individi e pranon shthurjen (dhe papërsosmërinë). Por, kur një individ arrin në atë nivel të vëmendjes dhe të devotshmërisë, që ekziston te personalitete të mëdha, atëherë ndodh pagabueshmëria. Çfarë do të thotë kjo? Do të thotë mungesa e rrezikut, për ta kërcënuar atë. Kush e ka mbikëqyrjen më të ulët, ai është gjithmonë në rrezik.²¹

²¹ Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me punonjësit e Departamentit të Kontrollit dhe Kontabilitetit, në zyrën e Imam El Kaidit, më 20.7.1372.

* Imam Khomeini, “Xhihadul Ekber”, f. 44: “Pagabueshmëria e profetëve dhe e evlijave nuk do të thotë që Xhibrili, për shembull, i merr për dore dhe i udhëzon drejt asaj që duhet bërë. (Sigurisht, n.q.s. Xhibrili do ta kishte marrë për dore Shemar ibn Dhi El Xheushan në këtë mënyrë, ai kurrë nuk do të kishte kryer veprime të ndaluara). Por, pagabueshmëria është produkt i besimit. Nëse një person beson në Zotin e Plotfuqishëm dhe e sheh atë me syrin e zemrës, ashtu sikurse sheh diellin me sytë e tij, atëherë nuk është e mundur që ai të bëjë një mëkat apo gjynah. Nëse një njeri i fortë dhe i armatosur ju vëzhgon plotësisht dhe ju dëgjon, atëherë ju shmangeni të bëni atë që ai nuk e pëlqen. Është e njëjta gjë, rasti me një person që beson dhe është i sigurt se ai është nën shikimin dhe dëgjimin nga Allahu i Lartësuar dhe ai është gjithmonë nën mbikëqyrjen e Tij. Atëherë ai nuk do të guxojë të bëjë atë që Allahu i Madhëruar nuk është i kënaqur. Të

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) zotëronte bindje dhe pastërti personale dhe në qenien e tij të bekuar nuk kishte pikë dobësie. Ai ishte i patëmetë dhe i pastër. Në vetvete, ky është një faktor i rëndësishëm për të dhënë ndikimin e tij.²²

Mesazhi

Unë mendoj se këtu është e përshtatshme dhe me rëndësi t'i referohemi duasë së "Nedbes". Në të vërtetë, ajo është një ligjëratë e pasur, që sqaron besimet, shpresat dhe shkëlqimin e sektit imami dhe shi'it përgjatë historisë. Vini re se, kjo qasje e qartë gjendet në fillim të duasë së "Nedbes": "Falënderimi i takon Allahut, për atë që ndodhi me caktimin tënd për evlijatë e Tu".²³ Kjo qasje vazhdoi që nga fillimi i historisë së mesazheve deri në epokën e mesazhit (Shpalljes) të Profetit të fundit.

pagabueshmësi (*Paqja qoftë mbi ta!*), pasi u krijuan nga balta e pastër dhe si rezultat i aktiviteteve dhe përfitimit të aftësive të virtytshme morale, gjithmonë e shohin veten në praninë e Allahut të Madhëruar, që di dhe vëzhgon gjithçka. Ata besojnë në kuptimin e shprehjes: 'Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut' dhe janë të sigurt se gjithçka është kalimtare, përveç Zotit, se askush nuk mund të ndikojë në fatin e tyre: 'Çdo gjë do të shkatërrohet, përveç Fytyrës së Tij!'" (Sure "El Kasas", ajeti 88)

²² Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 28.2.1380.

²³ Shejh Abas El Kumi, "Mefatihul Xhinan", Dua e "Nedbes".

Për sa i përket përmbajtjes së mesazhit hyjnor, ai ka të bëjë me fenë e Zotit. Në të vërtetë, ai është themeli, drejtimi dhe forma për të gjitha përpjekjet njerëzore. Fe do të thotë rruga e jetës. Nëse shikoni një shoqëri njerëzore dhe një vend kudo qoftë, do të shihni se njerëzit në atë shoqëri bëjnë përpjekje të ndryshme për hir të çështjeve të tyre personale, emocionale, jetësore dhe publike. Është feja ajo që i drejton të gjitha këto veprimtari. Ajo udhëzon dhe ndihmon mendjen njerëzore të jetë në gjendje të organizojë këto aktivitete, ku njeriu të arrijë lumturinë jo vetëm në këtë botë, por edhe në Ahiret.²⁴

²⁴ Nga fjalët e Imamit udhëheqës, në mbledhjen me vizitorët, në El Harem Err Redauj (Xhamia e imam Rizait a.s), më 1.12.1381.

MREKULLITË

Kur'ani

Kur'ani, një libër madhështor, me një rëndësi sublime dhe të jashtëzakonshme, është një koleksion i kufizuar, treqind ose katërqind faqe, por që i ka të gjitha njohuritë e nevojshme që mendja të njohë realitetin e botës. Allahu e ka ndërtuar atë në një mënyrë të veçantë, të thellë. Ai nuk i drejtohet një niveli të caktuar, përkundrazi çdo person e ka të mundur ta lexojë, pa marrë parasysh se sa i përgatitur është ai nga ana intelektuale. Të zhytet, të thellohet dhe të mësojë nga ky oqean i thellë, i cili, në vetvete, është një mrekulli e madhe. Për shembull, nëse merrni një libër shkencor, do të shihni se një person i zakonshëm nuk e kupton atë. Nëse personi ka pak informacion, ai kupton disa gjëra prej tij dhe, nëse informacioni i tij rritet më shumë, ai është në gjendje të përfitojë më shumë nga ai libër. Por, nëse njohuritë e tij janë më të larta se kaq, vetëm atëherë libri mund të jetë për të një burim i dobishëm, që kthehet tek ai.

Por, nëse një person ka njohuri dhe dije më shumë se kaq? Atëherë ai arrin në një gradë ku libri bëhet i parëndësishëm për të. Për një person poliedrik, që e ka studiuar një libër njëqind herë, ai ka studiuar dhe ka kritikuar shumë gjëra në të. Për të nuk ka mbetur asgjë e re në këtë libër.

Për sa i përket Kur'anit, ai nuk është i tillë. Kur'ani mbart një fjalë të re, madje edhe për të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilit i zbritën njohuritë në zemrën dhe veshin e tij, deri në fund të jetës së tij. Sa më shumë që një person thellohet në Kur'an, aq më shumë bëhet i vetëdijshëm për gjërat dhe çështjet.²⁵

Madhështia e Kur'anit

Kur'ani nuk është një libër i zakonshëm, nga i cili shtypim mijëra kopje dhe pastaj nxitim dhe motivojmë të tjerët ta lexojnë atë, ashtu si ndodh me librat e tjerë. Në fund e gjejmë dikë që lexon nga fillimi në fund. Nëse ky

²⁵ Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatët!*) në një takim me studentët pjesëmarrës në konkursin e Kur'anit, më 22.2.1378.

* Imam Khomeini, "Adabu Salati", f. 182: "Të kuptuarit e madhësisë së Kur'anit është jashtë rrethit të perceptimit, por ai është një tregues i përgjithshëm i madhësisë së këtij Libri, i cili është në duart e të gjitha qenieve njerëzore dhe u jep përfitime të mëdha atyre".

person e pëlqen librin, ai e lexon atë për herë të dytë, ose të tretë. Në rastin më të mirë, librat më të bukur lexohen nga një person dy ose tri herë, pastaj mbaron me kaq. Kur'ani nuk është i tillë. Kur'ani nuk është një libër për ta lexuar dhe për ta përfunduar atë.

Ai është një libër, konceptet e të cilit duhet të jenë pjesë e ekzistencës së njeriut, pjesë e mendjes njerëzore dhe pjesë e të vërtetës dhe e integritit moral të shpirtit njerëzor. Kështu që nuk është e mundur që të flitet për Kur'anin dhe për leximin e tij një, dy ose dhjetë herë. Është shpirti njerëzor ai që duhet ta kuptojë Kur'anin.

Çështja nuk është çështje e mendjes dhe e ideve, ku njeriut i duhet zgjuarsia dhe dije që të kuptojë diçka prej tij, por, përkundrazi, shpirti i njeriut duhet ta kuptojë Kur'anin. Ajetet fisnike në Kur'an përfshijnë një gamë të gjerë konceptesh, mbi të cilat, nëse një person mediton vazhdimisht rreth tyre, ai do të gjejë gjëra të reja.²⁶

²⁶ Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në ceremoninë përmbyllëse të Konkursit studentor të leximit të Kur'anit, më 12.12.1366.

* Profetësia, nga këndvështrimi i Imam Khomeinit (*Allahu qoftë i kënaqur me të!*) (Tibjan 41), f. 494: "Dije, njeri i nderuar, se madhështia e çdo fjalimi dhe çdo libri është ose nga madhështia e folësit dhe e shkrimtarit, ose nga madhështia e lajmëtarit dhe bartësit të tij, ose nga madhështia e mbrojtësit dhe e kujdestarit të tij, ose nga madhështia e shpjeguesit dhe e komentuesit të tij, ose me mënyrën dhe kohën kur

Mënyra e zbritjes së Shpalljes

Është e njohur se ekzistojnë fakte të ndryshme mbi mënyrën se si këto ajete zbritën në zemrën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe se si iu përcollën atij në dëgjimin e tij të bekuar. Që kjo dituri të zbresë nga vendi më i lartë - nga prania hyjnore - në masën që një person dhe një zemër njerëzore mund ta kuptojë dhe ta perceptojë atë, është vetë “zbritja”. Kjo çështje ndodhi me të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Zemra e tij e bekuar u frymëzua. Kjo do të thotë se këto dituri u bënë

dhe si u dërgua. Disa nga këto çështje janë madhështore në thelbin e saj, disa prej tyre janë madhështore në shfaqjen e tyre. Të gjitha këto çështje janë të pranishme në gazetën “Nuraniye”, në një mënyrë të qartë dhe të plotë. Ajo është një nga specialitetet e saj, kështu që librat e tjerë, ose janë pjesë e saj, ose nuk kanë të bëjnë fare me të. Për sa i përket madhësisë së folësit dhe shoqëruesit të tij, atij i përket madhështia absolute në të cilën të gjitha format e madhësisë, të perceptuara në mbretërim dhe mbretëri, fuqitë e dukshme dhe të padukshme, janë dëshmi për shfaqjen e madhësisë së Allahut të Lartësuar. I Vërteti dhe Madhështori nuk i zbulohet çdokujt në madhësinë e Tij, përveçse nëpërmjet mijëra perdeve dhe pengesave. Ai nuk është lajm që vjen nga deti apo toka dhe nuk lë asnjë gjurmë në baltë apo në tokë të thatë. Në një hadith përcillet se Allahu ka shtatëdhjetë mijë perde të dritës dhe të errësirës. Nëse do të ekspozohej pamja e fytyrës së Allahut, do të ishin djegur ata që e shihnin. Ky libër është për njerëzit e dijes, i zbritur nga i Drejti për të gjitha çështjet, cilësitë dhe veprat. Ai përfshin gjithçka që e Madhëron, e Lartëson dhe e Madhështon Atë. Asnjë libër tjetër qiellor nuk e ka këtë gradë dhe status”.

të qarta për atë zemër të ndritshme dhe, pas kësaj, zbritën në veshin e tij të bekuar, në formë fjalësh. Ai i dëgjoi dhe ua përcolli njerëzve ato që dëgjoi.

Të dëgjosh këto fjalë dhe të mos marrësh asgjë nga njohuritë dhe faktet e tyre, duke mos menduar dhe duke mos medituuar mbi to, cili do të jetë rezultati? Rezultati është se pas kësaj: **“Prej tij u rrëqethet lëkura atyre që i frikësohen Zotit të tyre e, mandej qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet Allahu”**.²⁷ Duke pasur parasysh se, nëse këto vargje do të zbrisnin mbi një mal, ai do të ishte çarë, është e qartë se ekziston një dallim ndërmjet zbritjes mbi një mal dhe zbritjes mbi njerëzit.

Padyshim, mënyra se si ajo zbret në sendet e pajetë, është tjetër. Duke qenë se ne nuk i logjikojmë dhe kemi dije modeste ndaj këtyre diturive dhe këtyre kuptimeve, ndikimi i saj do të jetë i dobët, ndërsa, nëse nuk jemi në gjendje të kuptojmë domethëniet e këtyre njohurive dhe këtyre fjalëve: **“Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqëdhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori”**²⁸, zemrat tona do të dridhen dhe do të jemi në gjendjen në të cilën ndodhet mali, kur i zbritet Shpallja. Ne nuk kemi ndjenja më pak se mali. Nëse mali do të gjendej në një gjendje të tillë, kjo çështje ndodh nga

²⁷ Sure “Ez Zumer”, ajeti 23.

²⁸ Sure “El Hashr”, ajeti 23.

bereqeti i meditim, që do të thotë se fusha e të menduarit vijon në këto nivele.²⁹

Fazat e zbritjes

Konceptet e Kur'anit fisnik janë koncepte shumë të larta. Allahu i Madhëruar i zbriti ato në zemrën e të Dërguarit të Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai i zbriti ato në masën që të perceptohen nga zemra e të Dërguarit, që është një trup njerëzor, ose mund të themi se ai e percepton atë me shkallën dhe

²⁹ Nga fjalimi i Imam Khameneit (*Allahu i dhëtë jetë të gjatë!*) në takimin me të gjithë Imamët e të xhumave, më 5.10.1999 (20.2.1378).

* Gazeta "El Imam", vëll 17, f. 433: "Mënyra e Shpalljes është një nga gjërat që askush nuk mund ta kuptojë përveç të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe atyre që ishin me të, ose atyre që u frymëzuan prej tij. Kështu që, sa herë që ata duan ta njohin atë, ata e përcaktojnë atë që njerëzit e zakonshëm ta kuptojnë, ashtu si Allahu i Plotfuqishëm e paraqet veten e Tij te njerëzit, bazuar në nivelin e dijes së tyre. Ai ka përmendur devetë, qiellin, tokën, krijimin etj. E gjithë kjo është për shkak se deklarata nuk përmbush të drejtën e subjektit. Kur'ani e ka trajtuar atë aq sa mund ta qartësojë".

* Gazeta "El Imam", vëll. 18, f. 498: "Kur'ani filloi të zbresë në muajin e Ramazanit. Kur'ani zbriti, pasi kaloi perden e dritës në muajin e bekuar të Ramazanit, në zemrën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai zbriti prej andej, derisa arriti në fazën që shprehet me gjuhë".

masën e të kuptuarit njerëzor. Ajo që është në sferat e mbifuqisë dhe hyjnisë, është e ndryshme nga ajo që vjen në botën tonë materiale dhe lidhet në mendjen e njeriut, aty ku kjo zbret. Ne, gjithashtu, mund të meditojmë mbi këto çështje të këtij niveli në mendjet tona.³⁰

Ajetet e Kur'anit përmbajnë rregulla dhe dispozita; u shpallën gradualisht dhe jo të gjitha menjëherë. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), edhe pse i kishte parë vetë të gjitha vargjet kur'anore, përsëri ato u zbritën gradualisht, me qëllim që të përgëzonin dhe të paralajmëronin. Pra, ua komentoi ato njerëzve dhe ia shfaqti ato bashkësisë që e rrethonte.

Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Ne e zbritëm atë Natën e Kadrit”**.³¹ Kur'ani, në tërësi, iu zbrit të Dërguarit

³⁰ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në takimin me familjen e dëshmorit Ajatullah Muthahari, më 2.5.2000 (13.2.1379).

* Imam Khomeini, “Komentimi i sures El Hamd”: “Kur'ani është një e vërtetë. Ai është një e vërtetë që hyn në zemër. Kur'ani është një sekret i fshehur nga një sekret. Është një sekret i maskuar në një sekret. Ai duhet të zbresë në fund dhe të zbresë, derisa të arrijë këtë gradë zbritëse, madje edhe zbritja në zemrën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte derisa të hynte në zemër dhe prej andej, gjithashtu, duhet të zbriste, derisa të arrinte atje ku e kuptojnë edhe të tjerët”.

2- Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) duke shpjeguar parimet e Partisë Republikane Islame, më 19.6.1980 (29.3.1359).

³¹ Sure “El Kadr”, ajeti 1.

të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në Natën e Kadrit. Këtu, duhet të theksohet se është e nevojshme të dimë se **“Ne zbritëm”**³² nuk do të thotë vetëm zbritje.

Por ajo nënkupton zbritjen në mënyrë të menjëhershme, si një e tërë. **“Ne e kemi zbritur Kur’anin në Natën e Kadrit”**, do të thotë që e kemi zbritur të gjithë Kur’anin si një të tërë. Në ndryshim me fjalën *“enzelnahu”* – *“kemi zbritur”*, fjala *“nezelna”* – *“zbritëm”*³³ do të thotë *“e kemi zbritur gradualisht”*, dhe *“nezelnahu”* – *“zbritëm poshtë”*³⁴. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua lexonte këto ajete njerëzve përgjatë një periudhe të shtrirë, të përshtatshme kohore. Sigurisht, që ishte Shpallja (Vahji) ajo që përcaktoi këtë përshtatshmëri për të dhe se çfarë duhet t’u përcillte njerëzve. Kjo ishte edhe Shpallja (Revelata) që zbriste përgjatë periudhës kohore.³⁵

³² Sure “En Nisa”, ajeti 105.

³³ Sure “El Bekare”, ajeti 23.

³⁴ Sure “El Isra”, ajeti 106.

³⁵ Silsiletu Mebahith Nehxhul Belaga.

* Imam Khomeini, “Komentimi i sures ‘El Hamd’”, f.139: **“Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhebraili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë.”**

(Sure “Esh Shuara”, ajetet 193-194). Ajo ka zbritur, gjithashtu, nëpërmjet Xhibrilit... Kjo do të thotë se çdo gjë duhet të zbresë në radhë. Nga ky nivel në atë nivel, derisa të arrijë kufirin që shfaqet në

Hapat për njohjen e Kur'anit

Sigurisht, hapi i parë është njohja me fjalët dhe shprehjet e Kur'anit. Ai është një hap i domosdoshëm. Nëse studiuesit e fesë dhe Kur'anit nuk e ndërmarrin këtë hap, atëherë hapat pasues do të bëhen të vështirë dhe të pamundur. Sot shihni njerëz që flasin aty-këtu rreth Islamit dhe pohojnë gjëra që nuk kanë të bëjnë fare me Islamin. Pse? Sepse ata nuk kanë njohuri rreth teksteve të Kur'anit dhe Sunetit.

Njeriu duhet të njihet me tekstet e Kur'anit dhe të Sunetit – d.m.th. hadithin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe hadithet e Imamëve (*Paqja qoftë mbi ta!*), në mënyrë që të jetë në gjendje t'i kuptojë njohuritë fetare, veçanërisht nëse dëshiron të thellohet në to. Pra, ky është hapi i parë dhe i domosdoshëm në të njëjtën kohë.

Sigurisht, pas kësaj, është e nevojshme të meditohet, të mblidhen të dhëna të bollshme dhe të përfitohet nga ai informacion, për të kuptuar njohuritë e Kur'anit dhe të hadithit. Sa më shumë informacion që të ketë një person, aq më i qartë është kuptimi i tij për Kur'anin dhe hadithin. Dhe përvoja janë gjithashtu të tilla. Sa më e madhe të jetë përvoja e një personi në jetë, aq më e madhe bëhet njohuria

formën e fjalëve. Kur'ani nuk është fjalë, nuk është përcjellje thëniesh të dëguara dhe të shikuara prej tij”.

e tij për Kur'anin dhe çështjet e trajtuara në Kur'an bëhen më të qarta për të.³⁶

Kur Kur'ani hyn dhe bëhet pjesë në një shoqëri, shijohet prej saj ëmbëlsia e tij. Kur'ani sot ka drejtimin dhe pozitën e tij në vendin tonë. Hapi i parë është të mësosh tekstin e Kur'anit dhe ky duhet të rritet dita-ditës. Nëse të gjithë duam ta mësojmë Kur'anin, duhet të jetë një grup në krye që të prijë - si në të gjitha fushat e tjera - dhe kështu që, nëse doni që kjo gjë të bëhet gjithëpërfshirëse, duhet të ketë një grup që të udhëheqë dhe të pasohet prej njerëzve të tjerë.

Nëse dëshironi që Kur'ani të promovohet në shtëpi dhe në mesin e fëmijëve, të rriturve, grave dhe burrave, ju duhet të respektoni heronjtë (lexuesit) kur'anorë. Kjo është arsyeja se pse ne i respektojmë ata (d.m.th. lexuesit e Kur'anit). Këta janë bartësit (hafizët) e Kur'anit. Këta janë të dashur, gjuha e tyre është e dashur, zemrat e tyre janë të dashura, sepse ata kanë gjetur ngushëllim në Kur'an. Jetët tona sakrifikohen për Kur'anin!³⁷

³⁶ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me lexuesit e Kur'anit, më 28.6.1380).

³⁷ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në ceremonitë përmbyllëse të sesionit të pesëmbëdhjetë të garave të Kur'anit, më 1.9.1977.

Nëse Kur'ani nuk do të shprehej në formë letrare, nuk do të ishte e mundur të përfshihen të gjitha këto të vërteta, fakte dhe koncepte të larta. Prandaj, është e pamundur që asnjë interpretim, komentim ose përkthim kur'anor do të jetë në gjendje të shprehë (mësojë) faktet kur'anore. Një njeri që merret me këtë çështje, duhet të njohë shumë mirë gjuhën dhe të gjitha hollësitë teknike e letrare, si dhe të jetë në gjendje të jetojë në hapësirën shpirtërore të Kur'anit, për të kuptuar atë që thotë. Kjo është arsyeja pse vetë Kur'ani Famëlartë shprehet: **“Ai shpie në humbje kë të dojë dhe udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë”**.³⁸

Disa njerëz e lexojnë Kur'anin dhe udhëzohen, ndërsa të tjerët humbasin përmes leximit të tij, për shkak të mungesës së njohjes dhe të kuptuarit të duhur. Këta njerëz, për shkak se nuk ishin në gjendje të forconin një marrëdhënie dhe të mbanin një lidhje të fortë me Kur'anin, nuk arritën të lidheshin me të dhe nuk patën aftësinë për të kuptuar konceptet e tij. Sigurisht, shpjegimi i Kur'anit është i mjaftueshëm, por ai kërkon kushte të veçanta që një person ta njohë Kur'anin, në kuptimin e vërtetë të fjalës. Qëllimi është që gjithëpërfshirja dhe kapaciteti letrar dhe artistik, është i aftë të sqarojë shumë koncepte, duke përfshirë këtu edhe konceptet e larta fetare. Vetëm përmes

³⁸ Sure “En Nahl”, ajeti 93.

njohjes letrare dhe artistike këto koncepte mund njihen dhe të kuptohen.³⁹

Në parim, meditimi nuk është, për të interpretuar dhe për të komentuar, por më tepër është për shkak të të kuptuarit të asaj që nënkuptohet. Një person mund të zotërojë dy lloje të të kuptuarit dhe marrjes së çdo fjale të mençur: e para është sipërfaqësore dhe e thjeshtë, kurse e dyta është e saktë dhe e thelluar. Kjo, në thelb, nuk arrin fazën e interpretimit dhe të shprehjes. Meditimi i kërkuar në Kur'an është të qëndrosh larg vizionit sipërfaqësor në të dhe kjo do të thotë që, kur lexon çdo ajet kur'anor, duhet të përqendrohesh në të, të thellohesh dhe të mendohesh për ta kuptuar. Ky është meditimi dhe ju do të shihni se një njeri nuk ka nevojë të ekspozojë idetë e tij ndaj Kur'anit - domethënë ta komentojë dhe ta interpretojë sipas mendimit të tij, sepse dyert e diturisë do të hapen sipas përmbajtjes së ajetit, çfarëdo qoftë përmbajtja e saj.

Kur'ani fisnik thotë: **“dhe lexoje Kur'anin ngadalë dhe qartë”**.⁴⁰ Ky Libër i shenjtë e ka burimin nga pozita më e lartë, nga maja më e lartë e ekzistencës. Për këtë, një person duhet të meditojë dhe, meqenëse thellësia e këtyre vargjeve dhe koncepteve është shumë e madhe, të gjithë ata që meditojnë në të, do të përfitojnë prej tij, përfshirë

³⁹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me artistët dhe kineastët, më 23.1.1995 (3.11.1373).

⁴⁰ Sure “El Muzzemmil”, ajeti 4.

edhe të Dërguarin e Allahut. Sigurisht që i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe Imamët e mëdhenj e lexonin gjithmonë Kur'anin duke medituar dhe duke menduar rreth fakteve dhe informacioneve, si rrjedhim përfitonin prej tij.⁴¹

Është sikur disa nga vargjet fisnike hyjnore, për shekuj me radhë, ose nuk u shpjeguan në kuptimin realist, ose nuk u kuptuan nga ne dhe nga brezat e zakonshëm njerëzorë. Këto vargje morën kuptim gjatë periudhës së revolucionit tonë dhe gjatë dhjetë e ca viteve. Pra, gjatë

⁴¹ Në një intervistë me një grup grash elitare, më 18.7.1377.

* Imam Khomeini, "Shpjegimi i Hadithit – Ushtarët e arsyes dhe të injorancës", f. 105: "Pas arritjes së sinqeritetit të përgjithshëm, e vërteta mund të trajtohet – ashtu si në Kur'anin Fisnik, në suren e bekuar "Es Saffat" në ajetet 159-160, ku Allahu i Madhëruar thotë: **"Lavdi Allahut, qoftë i pastër nga ajo që ata ia veshin Atij! Por robërit e sinqertë të Allahut nuk adhurojnë askënd tjetër përveç Tij."** Robërit e sinqertë lirohen nga nivelet e politeizmit dhe ideve të dyfishta, si dhe çlirohen nga papastërtia e natyrës. Zoti është i pastër nga ajo që e përshkruajnë njerëzit e tjerë, edhe nëse të sinqertët janë sipërorë ndaj të tjerëve. Ne do ta shpjegojmë, me ndihmën e Zotit, në momentin dhe vendin e duhur. Nëse zemra e njeriut është pastruar nga papastërtitë, ai është i përgatitur për përmendjen (dhikrin) e Zotit dhe leximin e Librit të Tij. Por, përderisa papastërtitë dhe ndyrësitë e kësaj bote kanë mbushur zemrën e tij, atëherë ai nuk do të jetë në gjendje të përfitojë nga përmendja (dhikri) dhe Kur'ani Fisnik. Ashtu si është e treguar në Librin hyjnor, në suren e bekuar "El Uakia", në ajetet 77-79: **"Se ky është vërtet një Kur'an i nderuar, në Librin e ruajtur. Atë (Kur'anin) e prekin vetëm të pastrit."**

këtyre njëmbëdhjetë viteve plot ngjarje dhe fakte, dhe kjo është e vërteta. Janë ngjarjet dhe rrethanat e veçanta të atyre viteve që mund të japin një kuptim të saktë për realitetet hyjnore që janë në fjalët e tyre.

Për shembull, ajetet që u shpallën në betejën e Uhudit nuk mund të kuptohen siç duhet në dritën e një jete luksoze, të qetë dhe komode. Ajetet që u shpallën në dhomën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) si dhe shokët e tij të mëdhenj), në Shiabin (toka, pronë) e Ebu Talibit, ose në rrugën e Mekës, nuk mund të kuptohen nën rrethanat aktuale të jetës, në shtëpi, treg dhe në mjedisin familjar në të cilin dallohen njerëzit. Kjo kërkon diçka tjetër. Duhet të ekzistojnë rrethana të veçanta, që të mund t'u japin kuptim shumë ajeteve, nëse ne duam t'i japim një këndvështrim dhe vizion të vërtetë. Duhet të themi se grupi i ajeteve hyjnore, me interpretimin (transmetimet) e Imamëve të pagabueshëm (*Paqja qoftë mbi ta!*), zbritën në atmosferën e revolucionit, xhihadit dhe martirizimit, e cila është faza e punës, e kërkimit dhe e lëvizjes. Në të mund të kuptoheshin më shumë se çdo fazë tjetër historike, ose thënë ndryshe, është e pranueshme për t'u kuptuar.⁴²

⁴² Pjesë nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me redaktorët, më 26.6.1399.

* Imam Khomeini, "Ruga e Dashurisë", f. 27: "Leximi i thjeshtë i Kur'anit, i cili është mesazhi i të dashurit për dëgjuesin, ndikon shumë

Mbrojtja nga shmangiet

Një nga përparësitë e mëdha të fesë së shenjtë islame është se Shpallja hyjnore është e pranishme deri më sot dhe do të jetë përgjithmonë në duart e atyre që dëshirojnë të mësojnë dhe të udhëzohen. Ai do të jetë kështu, me të njëjtat shkronja dhe fjalë që zbritën në zemrën e shenjtë të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kjo është edhe përmbushja e premtimit hyjnor që erdhi në Kur'an: **“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Kur'anin dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë”**.⁴³

në zemër, por orientimi në të e udhëzon njeriun në gradën më të lartë dhe më sublime. Nëse kjo bravë nuk hapet apo nuk thyhet që të hapet, nuk do të ketë rezultat as nga meditimimi në të”.

⁴³ Sure “El Hixhr”, ajeti 9. Përcjellë nga udhëheqësi i Revolucionit Islamik mbi ruajtjen dhe mos shtrembërimin e Kur'anit, më 21.4.1992 (1.2.1371).

* Gazeta “El Imam”, vëll. 18, f. 423: “Që në fillim, ata bënë një interpretim të pasaktë të gjithçkaje që u përmend në Kur'anin Famëlartë, e cila bie ndesh me interesat e tyre. Duke qenë se ata nuk mund të fshinin apo të ndryshonin gjë nga Kur'ani, ata po i detyronin klerikët e tyre, që i pasonin, ta interpretonin atë gabimisht. Por, Kur'ani mbeti te myslimanët dhe ata nuk ishin në gjendje ta shtrembëronin atë, sepse ata nuk mund ta bënin, përndryshe do ta kishin bërë këtë. Dhe kur dikush donte të fshinte një tekst nga Kur'ani, njëri nga arabët nxori shpatën, duke thënë: ‘Ne do t’ju përgjigemi me shpatë’. Ata parandaluan shtrembërimin e Kur'anit të Shenjtë, i cili

El-Miraxhi

Në suren “En Nexhm” bëhet një diskutim i saktë, i këndshëm dhe i bukur: **“Betohem në yllin kur perëndon, se shoku juaj** (Muhamedi / *Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), **nuk ka humbur e nuk ka devijuar!”**⁴⁴

Kjo lidhet me çështjen e Miraxhit, sikurse përmendet në shumicën e interpretimeve. Është e vërtetë se surja në fjalë, i referohet transformimit të brendshëm të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe gjendjes së pritjes të Shpalljes. Por, duhet thënë se rasti i sures “En Nexhm” është ajo që të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i është sqaruar historia e udhëtimit të tij të Miraxhit gjatë Natës, pasi ata nuk e dëgjuan atë. Ajeti ka vlerën e një deklarate: **“Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm Shpallje hyjnore, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar atij një (engjëll) shumë i fuqishëm (Xhebraili)...”**⁴⁵

është sot siç ishte në periudhën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)”.

⁴⁴ Sure “En Nexhm”, ajetet 1-2.

⁴⁵ Sure “En Nexhm”, ajetet 3-5.

“e i shpalli robit të Allahut, atë që i shpalli. Zemra (e Muhamedit) nuk gënjen për atë që ka parë”.⁴⁶

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk gaboi në vëzhgimet e tij të zemrës. Ai vërtet dëshmoi dhe nuk gaboi.

“Vallë, a do ta kundërshtoni atë për çfarë ka parë?”⁴⁷

⁴⁶ Sure “En Nexhm”, ajetet -11.

⁴⁷ Sure “En Nexhm”, ajeti 12.

Imam Khomeini, “Raportet e udhëtimeve”: “Vula e Profetëve realizoi një Miraxh, ngjitje fizike, që nënkupton se shpirti i Zotërisë, Vulës së Profetëve, kërkoi të udhëtonte në të gjitha botët dhe Allahu përgatiti për të nevojat e udhëtimit. Trupi i Zotërisë, Vulës së Profetëve dhe shpirti i tij i bekuar realizoi ngjitjen fizike. Natyrisht, Miraxhi nuk ka për qëllim të shohë trupat fizikë, siç ndodhi në rastin e Profetit Ibrahim, të cilit iu shfaqën mrekullitë e qiejve dhe të tokës. Kjo ndodhi, sepse bota e trupave fizikë nuk është e asaj rëndësie që kërkon Miraxhin (ngjitjen). Por, Miraxhi është për të vështruar botën e abstraksioneve dhe të mendjeve. Disa mund të mendojnë se *el-burak* është një kalë i zakonshëm si kuajt që ne hipim dhe i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) hipi mbi të, kurse Xhibrili tërhiqte kalin prej freri. Por, jo nuk është kështu. El-Burak është, gjithashtu, një ekzistencë abstrakte. Sa për këto koncepte fizike dhe materiale rreth Miraxhit dhe detajeve të tij, ato nuk janë të sakta”.

* Imam Khomeini, “Adabu Salati”, f. 139: “Namazi është, në të vërtetë, realiteti i Miraxhit (ngjitjes) së besimtarëve dhe burimi i dijes së njerëzve të dijes. Ky është rezultati i asaj që iu shfaq Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ai, me sjelljen

Përballja me udhëheqjen hyjnore dhe sundimin absolut

Pa dyshim se universi i errët, me lindjen e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), dritës hyjnore, u ndriçua. Ajo ditë duhet të jetë fillimi i një historie të re për njerëzimin. Prijësi i Besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), në hadithet e tij e ka bërë të qartë se drita e lumturisë ka humbur te shoqëritë njerëzore, për shkak të sundimit të ligjeve dhe autoriteteve të padrejta (zullumqare).

“Dhe botës i është eklipsuar drita, për shkak të gjynaheve dhe kotësisë”. Drita e pranisë së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që në fillimet e saj, tregoi shenja të sundimit të së vërtetës dhe dëshmi të pranisë së provave hyjnore midis njerëzve.⁴⁸

e tij shpirtërore, hijeshinë hyjnore dhe tërheqjen e mëshirshme, ka arritur në një pozitë – ndërmjet dy harqeve ose më poshtë – e pasuar nga cilësitë personale dhe cilësitë e frymëzuara. Ai zbuloi realitetin e këtij namazi në praninë e padukshme hyjnore. Në të vërtetë, ajo është një dhuratë për umetin e tij, i cili është nga umetet më të mira. Kjo është dhurata që ai solli nga ky udhëtim i bekuar shpirtëror, i zhytur në detin e mirësive”.

⁴⁸ Es Sejid Err Rrida, Muhamed ibn El Hasan El Musaui, “Nehxhul Belaga”, realizuar nga Subhi Es Salih, Hytbeja 89, f. 122, Botimi i parë, 1387 hixhri (1967), Bejrut.

Padrejtësia

Islami, fillesat e tij, i pati në Mekë. Veprimtaria islame ishte kundër padrejtësive, shtypjes dhe forcimit të qëndrueshmërisë së besimtarëve. Medina, Jethribi në atë kohë, ishte vendi i parë ku arritën rrezet e tij. Sakrifika e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e shokëve të tij në Mekë, është sakrifika e njerëzve të shtypur dhe që u është bërë padrejtësi e madhe. Ata përmendnin emrin e Zotit dhe bënë thirrje për monoteizëm dhe maturi. Ata u përballën me rrahje, tortura dhe vrasje, si dhe iu nënshtuan të gjitha llojeve të presioneve.

Në fund, çështja arriti tek prona e Ebu Talibit, e cila ishte një nga presionet më të vështira mbi Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët. Këto çështje nuk janë të panjohura dhe të fshehta. Sigurisht, në ato ditë, nuk kishte mundësi mediatike si sot, por Meka ishte vendi ku mblihdeshin fiset e ndryshme arabe. Ata vinin në Mekë në ditë të veçanta nga Taifi, Jethribi dhe vende të tjera të ndryshme. Gjatë asaj kohe ata mësonin për kushtet e Mekës dhe për Islamin. Fjala e vërtetë ndikonte në veprimtarinë njerëzore, veçanërisht nëse shoqërohej me padrejtësinë. Ajo do të ndikonte në zemrat e gatshme, veçanërisht kur buroi dhe u pasua nga njerëzit e drejtë që e

donin të vërtetën. Më në fund, ky ishte rezultati i asaj që ndodhi.⁴⁹

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte kolona qendrore, që qëndronte në mes të bashkësisë myslimane dhe mbi të cilën ishin mbështetur myslimanët. Myslimanët iu nënshtruan rrahjeve, torturave, frikës, shqetësimit, privimit dhe dëbimit nga shtëpia dhe privimit nga trashëgimia. Ata iu nënshtruan rrahjeve dhe torturave nga duart e prijësve dhe zotërinjve të tyre. Por sa herë që njëri prej tyre i nënshtrohej presionit, ata do të kërkonin strehim te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), i cili i forconte ata shpirtërisht nga shpirti hyjnor që kishte, u jepte atyre forcë nga ai burim i pashtershëm, i cili ishte në gjendje të derdhej me forcë mbi të gjitha krijesat. Edhe pse ishin të paktë, myslimanët që ndoqën të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe kërkuan ndihmë, ishin të palëkundur.

⁴⁹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë, më 10.6.2001 (20.3.1380).

* Gazeta "El Imam", vëll 20, f. 452: "Qeveria, e cila konsiderohet si një degë e kujdestarisë absolute të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është një nga urdhëresat kryesore të Islamit dhe merr përparësi mbi të gjitha aktet nënligjore, madje edhe namazin, agjërimin dhe Haxhin".

Kjo qëndrueshmëri e bëri të vetën. Shfaqja dhe shenja e parë e këtij ndikimi ishte te banorët e Jethribit. Çështja përfundoi me ftesën e tyre, që i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) të vinte tek ta. Ata thanë: “Ejani në qytetin tonë, Jethrib, sepse banorët e Mekës ju refuzuan”. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pranoi ftesën e tyre dhe shkoi.

Sigurisht, ai nënshkroi me ta një besëlidhje dhe tha se që nga momenti që do të shkonte aty, ata duhet ta mbronin dhe ta mbështesnin. Kjo tregon se ai paramendonte luftë. Ata deklaruan gatishmërinë e tyre: “Nëse do të vini në Jethrib, shpirtrat tanë do të jenë për ju; familjet tona do të jenë për ju dhe paratë tona do të jenë për ju”. Ata kryesisht ishin të rinj. Një grup të rinjsh nga Jethribi treguan dhe dëshmuan një besim të thellë dhe të fortë. Të njëjtën gjë bënë edhe disa nga të vjetrit e tyre, si: Sad bin Ubadehi dhe Sad bin Muadhi. Ata e ftuan të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e morën në Medine. E ndryshuan emrin e Jethribit dhe e kthyen atë në “Qytetin e Profetit”.

Bëni kujdes dhe kushtojini vëmendje të veçantë: padrejtësia, fjalët e reja (feja e re), fytyrat ndriçuese dhe ngjarjet e reja, prekën dhe ndikuan këdo. Kjo ndodhi në atë masë, që edhe disa hebrenj dhe ata që ishin në Medine, u prekën prej tyre. Por, duhet bërë e ditur se hebrenjtë më

vonë ishin kundërshtarët më të ashpër të Islamit. Në fillim ata u prekën nga ajo që ndodhi, me ardhjen e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në atë gjendje, se kurejshët nuk i lanë rehat, edhe kur myslimanët u larguan, por u dhanë atyre goditje, i gjurmuan, i rrethuan dhe i ndaluan disa prej tyre. Ky ishte nga shkaqet e pranimit të hyrjes së të Dërguarit në Medinë.⁵⁰

Bashkimi i virtyteve të larta

Profeti i nderuar i Islamit, ishte një person përtej të zakonshmes (i veçantë, i jashtëzakonshëm) për sa i përket personalitetit njerëzor. Ai ishte i gradës së parë, i pakrahasueshëm dhe i pashembullt. Tek ai u kombinuan cilësitë më të larta morale. Tregoi shumë durim dhe qëndrueshmëri në përballimin e dhimbjeve dhe të vështirësive. Tek ai u përmbloodhën të gjitha cilësitë pozitive të një njeriu madhështor.⁵¹

⁵⁰ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në mbledhjen e mobilizimit të Brigadës së 10-të, Sejfid Esh Shuheda, më 10.18.1998 (26.7.1377).

⁵¹ Fragment nga hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 12.5.2000 (23.2.1379).

Përfundimi i profetësisë

Dita e përzgjedhjes dhe e dërgimit të një Profeti është një festë për të gjithë, jo vetëm për myslimanët. Lindja e çdo Profeti dhe shfaqja e çdo misioni profetik është një festë për të gjithë njerëzimin. Kur erdhën Profetët e Zotit të Plotfuqishëm, secili prej tyre po i drejtonte karvanët e njerëzimit drejt përsosmërisë, dijes, moralit dhe drejtësisë. Pra, ata i afronin një hap më pranë fazave të përsosjes njerëzore.

Të gjitha format e arsyes njerëzore përgjatë historisë, kthehen te mësimet e Profetëve. Krijimi njerëzor (etika njerëzore), i cili siguron aftësinë për të mbështetur vazhdimësinë e jetës për njerëzit, si dhe virtytet morale, janë të gjitha nga mësimet e Profetëve. Ata kanë bërë rregullimin e jetës për njerëzit dhe i kanë udhëhequr drejt arenës së zhvillimit dhe integritetit. Profeti i nderuar i Islamit është vula e Profetëve që u dërguan dhe erdhën tek njerëzimi me fjalën e fundit, e cila nuk përfundon.⁵²

⁵² Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë, më 2.9.2005 (11.6.1384).

SHENJAT (NDIKIMET, GJURMËT) DHE BEREQETI I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)

Dridhja e flamujve të politeizmit dhe adhurimit të idhujve

Ajo që është përcjellë nga transmetimet dhe historitë, në lidhje me plasaritjen e ballkoneve të pallateve të Kisras dhe dridhjen e flamujve të idhujtarisë dhe politeizmit, në të gjitha pjesët e botës, nëse këto transmetime janë të sakta, mund të jetë një manifestim i fuqisë hyjnore. E gjithë kjo për të treguar dhe për të shprehur në mënyrë simbolike praninë e kësaj fuqie, që do të zhdukë rrënjët e padrejtësisë dhe të korrupsionit, do të pastrojë shkencën nga mitet, si dhe qytetërimin do ta shpëtojë nga korrupsioni.

Allahu i Madhëruar i dërgoi botës së ekzistencës mrekullinë më të madhe hyjnore, të shprehur në praninë e

të Dërguarit fisnik (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajo ishte një pikënisje për një fazë të ndjeshme. Pra, fillimin e një faze themelore në fatin e njerëzimit. Ajo erdhi me argumentet (shenjat) e lindjes së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Kur lindi ai njeri i madh, ballkonet e Kisras u shkatërruan; zjarret e tempullit të Adharkashabës, që ishin ndezur me shekuj, u shuan; u tha liqeni Sava, i cili konsiderohej i shenjtë nga disa njerëz në atë kohë dhe u shkatërruan idhujt që ishin varur rreth Qabes.⁵³

Këto shenja krejtësisht të dukshme dhe simbolike, tregojnë drejtimin e vullnetit hyjnor për të nxjerrë në pah këtë qenie madhështore, këtë personalitet të lartë dhe unik. Kuptimi i këtyre ngjarjeve simbolike është se me këtë ardhje të bekuar, është i pashmangshëm largimi i petkut të poshtërimit mbi njerëzimin, qoftë ai (poshtërimi) përmes sundimit të tiranëve dhe sundimtarëve despotikë - siç ishte ajo që po ndodhte në atë kohë në Iran dhe Romën e lashtë, qoftë ai i politeizmit, që ishte produkt i adhurimit të dikujt tjetër përveç Zotit.

Përmes duarve të këtij të porsalinduri të bekuar, njerëzimi duhet të çlirohet nga zinxhirët e padrejtësisë të imponuar nga sundimtarët shtypës mbi njerëzit e shtypur përgjatë historisë, si dhe nga prangat e miteve dhe

⁵³ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me përfaqësues të popullit, më 5.9.1993 (14.6.1372).

besimeve të rreme dhe poshtëruese, që e bënë njeriun të nënshtruar para qenieve më të ulëta se ai, ose kundër qenieve të tjera njerëzore. Kjo është arsyeja pse është përcjellë në ajetin kur'anor, në kapitullin mbi misionin e Profetit fisnik, thënia e Allahut të Plotfuqishëm: **“Është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me Udhëzimin dhe Fenë e Vërtetë, për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë. Allahu mjafton si dëshmitar!”**⁵⁴

Fraza **“për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë”**, nuk i nënshtrohet një afati kohor, por përkundrazi tregon vendmbërritjen. Pas kësaj ngjarjeje, njerëzimi duhet të ecë drejt lirisë shpirtërore, shoqërore, të vërtetë dhe logjike. Kjo çështje ka filluar dhe vazhdimi i saj është në duart tona. Ky është një rrugëtim tjetër në botën njerëzore.⁵⁵

Zbritja e mëshirës hyjnore mbi njerëzimin

Kjo lindje madhështore, është shembulli më i mirë i mëshirës hyjnore ndaj njerëzimit, sepse prania dhe dërgimi i Profetit të madh është mëshira e Allahut të Madhëruar

⁵⁴ Sure “El Fet’h”, ajeti 28.

⁵⁵ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë, më 30.5.2002 (9.3.1381).

ndaj krijesave të Tij. Njerëzimi duhet të kuptojë se kjo mëshirë është e pandërprerë dhe e vazhdueshme.⁵⁶

Lëvizja e myslimanëve drejt përsosmërisë

Asnjë qenie njerëzore nuk është në gjendje të shpjegojë plotësisht dimensionet e personalitetit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe të paraqesë një pamje të afërt në lidhje me personalitetin e atij kolosi. Ajo që ne dimë dhe e kemi mësuar, është se ai është përzgjedhur nga Zoti i gjithësisë për të qenë pararoja e profetëve përgjatë historisë, është hija e padukshme e ekzistencës shpirtërore të brendshme, që është e vërtetë për atë kolos.

Kjo sasi njohurish është e mjaftueshme për myslimanët, që të sigurojnë lëvizjen e tyre të vazhdueshme drejt përsosmërisë, në mënyrë që kulmi i humanizmit dhe i integritetit njerëzor të qëndrojë para tyre. Ajo i nxit ata të lëvizin drejt unitetit islam dhe të mblidhen rreth atij aksi (boshti). Bazuar në sa më sipër, ne rekomandojmë që të gjithë myslimanët në botë të rrisin punën sipas dimensionit të personalitetit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i*

⁵⁶ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në takimin me mysafirët pjesëmarrës në Konferencën e Unitetit Islam, më 3.8.1996 (13.5.1375).

Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), jetës, biografisë, moralit dhe mësimëve të lartpërmendura.⁵⁷

Prirja ndaj Islamit

Ka shumë njerëz në botë që, nëse do ta njihnin të Dërguarin e Islamit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), aq sa e njohin myslimanët, apo edhe më pak, domethënë, nëse do të shfaqej ai personalitet i ndritshëm në zemrat e tyre, do të ishte një garanci e besimit dhe e angazhimit të tyre ndaj Islamit. Prandaj, ne duhet të punojmë për këtë çështje.⁵⁸

Uniteti i myslimanëve

Prania e Profetit fisnik të Islamit ishte faktori më i madh i unitetit të myslimanëve në të gjitha epokat islame. Edhe sot ai mund të jetë kështu. Besimi monoteist i myslimanëve në atë ekzistencë të shenjtë dhe të madhe është binjake e pasionit dhe e dashurisë. Prandaj, ai njeri i madh ishte qendra e emocioneve dhe i besimit të të gjithë

⁵⁷ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në takimin me mysafirët pjesëmarrës, në Konferencën e Unitetit Islam, më 16.10.1989 (24.7.1368).

⁵⁸ I njëjti burim.

muslimanëve. Ky bosht qendror është një nga pikat kyçe, që zbut zemrat e muslimanëve dhe afron më afër sektet (shkollat) islame.⁵⁹

⁵⁹ I njëjti burim.

MORALI I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)

Etika e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Shkurtimisht, ne mund ta ndajmë etikën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në “etikë personale” dhe “etikë udhëheqëse”, domethënë etikën e tij si qenie njerëzore, veçoritë e tij, moralin dhe sjelljen e tij si udhëheqës. Sigurisht, këto aspekte janë një pjesë e vogël e asaj që ishte e pranishme në personalitetin e tij. E gjithë kjo, pasi qenia e tij i përfshin shumë herë këto veçori të jashtëzakonshme dhe të bukura, disa prej të cilave do t’u referohemi. Ai personalitet i madh ishte besnik, i ndershëm, i durueshëm, i përlulur, mbrojtës i të shtypurve në të gjitha rastet.

Sjellja e tij ishte e drejtë. Marrëdhëniet e tij me njerëzit bazoheshin në ndershmërinë, pastërtinë dhe mirësinë. Ai ishte gojëmbël dhe në fjalët e tij nuk ishte i dëmshëm. Ai ishte i pastër. Në rininë e tij, ai ishte i njohur

për dëlirësinë, modestinë dhe pastërtinë, në atë mjedis moralisht të korruptuar të Gadishullit Arabik paraislam.

Të gjithë e pranonin atë dhe ai nuk u ndot nga asgjë. Ai ishte një person i pastër: rrobat e tij ishin të pastra, fytyra e tij ishte e pastër dhe sjellja e tij ishte gërshtetim pastërtie. Ai ishte trim dhe asnjë front armik, sado i madh që ishte, nuk mundi ta thyejë, ose ta frikësojë atë. Ai ishte i sinqertë dhe fjalët e tij ishin të qarta dhe të ndershme. Në jetën e tij ai ishte i mençur, i urtë dhe asket. Ishte i mëshirshëm, tolerant dhe bujar. Dhuronte pasuri dhe nuk hakmerrej, si dhe ishte tolerant dhe falës.

Zotëronte shumë butësi, tolerancë dhe përvetshësi, si dhe ishte një nga prijësit e adhurimit. Këto veçori ishin të pranishme në personalitetin e tij të madh, në të gjitha aspektet e jetës së tij, që nga periudha e rinisë dhe deri në vdekjen e tij, afërsisht prej një periudhë gjashtëdhjetë e trevjeçare.⁶⁰

⁶⁰ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 12.5.2000 (23.23.1379).

Përkushtimi i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) **ndaj Zotit**

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), pavarësisht pozitës së lartë që gëzonte, nuk e linte pas dore adhurimin e tij. Ai qante në mes të natës, lutej dhe kërkonte falje. Një natë, Umu Seleme e vizitoi të Dërguarin dhe e gjeti atë duke u lutur. Teksa lotët rridhnin nga sytë e tij, ai kërkonte falje dhe thoshte: “O Zot, mos më lër të vetëm as sa hap e mbyll sytë!”⁶¹

Umu Seleme qau. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u afrua tek ajo dhe e pyeti se pse kishte ardhur afër tij. Ajo e pyeti: “O i Dërguari i Allahut, ti je i dashur tek Allahu dhe mëkatet të janë falur. **“...për të t'i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme”**⁶². Pse qan dhe pse përsërit: ‘O Zot, mos më lër vetëm?’

Ai i tha: “Dhe çfarë më siguron mua? Kush do të më mbrojë, nëse harroj Allahun?”⁶³

⁶¹ Al'lametu Mexhlisij, “Biharul Anuar”, vëll. 16, K. 9, “Moral i tij fisnik, biografia dhe suneti i tij”.

⁶² Sure“El Fet’h”, ajeti 2.

⁶³ “Biharul Anuar”, vëll. 16, kreu 9, “Moral i lartë i tij, jetëshkrimi dhe suneti i tij (Profetit)”.

Ky është një mësim për ne. Mësimi i madh që na ka mësuar i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është që të mos e harrojmë Zotin, por duhet të jemi të mbështetur tek Allahu dhe ta kërkojmë Atë në ditën e lavdisë, në ditën e poshtërimit, në ditën e vështirë, në ditën e pushimit, në ditën kur njeriu është i rrethuar nga armiku dhe në ditën kur armiku, me të gjithë madhësinë e tij, i dorëzohet njeriut.⁶⁴

Vlera e babait të Fatimes tek Allahu i Madhëruar në adhurim manifestohet në parimin se Fatimja është burimi i virtyteve të të gjithë të pagabuarve. Ajo dhe Prijësi i Besimtarëve janë pika nga oqeani i qenësisë së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). “Unë dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij”. Në fillim ishte robëria e tij, pastaj mesazhi i tij. Në të vërtetë, pozita e mesazhit iu dha atij dhe kjo është një pozitë e lartë, për shkak të adhurimit.⁶⁵

⁶⁴ Al'Imetu Mexhlisij, “Biharul Anuar”, vëll. 16, K. 9, “Morali i tij fisnik, biografia dhe suneti i tij”.

⁶⁵ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 9.27.1991 (5.7.1370).

Adhurimi dhe kërkimi i faljes (istigfari)

Bëhet fjalë për salavatet (lutjet) e përshkruara në “El Mefatih”: “I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i kryente me zell agjërimet dhe lutjet e tij, natën edhe ditën, duke treguar mënyrën e nënshtrimit dhe duke e nderuar e duke e respektuar atë. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ka nderuar muajin Shaban deri në fund të jetës së tij dhe tregonte nënshtrimin e tij. Ai ishte mësuar me agjërimin dhe qëndrimin në adhurim gjatë muajit Shaban.

Ajo erdhi në frazat që pasuan hyrjen: “O Zot, na ndihmo të ndjekim Sunetin e tij!”⁶⁶

Adhurimi i tij ishte adhurimi i atyre që këmbët e tyre fryhen nga qëndrimi në mihrab (adhurim). Ai kalonte një pjesë të gjatë të natës zgjuar dhe me adhurim, lutje, duke qarë, duke kërkuar falje dhe duke u lutur. Ai e luste Allahun dhe i kërkonte falje. Përveç muajit të Ramazanit, ai agjëronte çdo dy ditë në muajt Shaban dhe Rexheb, po ashtu edhe në pjesën tjetër të vitit, pavarësisht motit të nxehtë. Shokët iu drejtuan atij duke i thënë: “Pse gjithë

⁶⁶, Uesailu Shi'ati, i autorit El Hurr El Amilij, Shejkh Muhamed bin El Hasan: vëll. 10, K. “Istixhabetu Saumu Sha'ban”, f. 492, realizuar nga fondacioni “Ehli Bejti, për ringjalljen e trashëgimisë”, Botimi i dytë, 1414 hixhri, shtypur në shtypshkronjën Mehr - Kum - Iran.

këto lutje, adhurime dhe kërkim falje? Ju nuk keni gjynahe. Kështu thuhet në suren “El Fet’h”: **“...për të t’i falur ty Allahu gabimet e mëparshme dhe të ardhshme”**.⁶⁷

Ai u përgjigjej: *“A nuk duhet të jem një njeri mirënjohës dhe falënderues? A nuk duhet të jem një rob mirënjohës, kur Allahu i Madhëruar më ka dhuruar të gjitha këto mirësi?”*⁶⁸

Përmendja vazhdimisht e Allahut

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), edhe pse ishte në kulmin e fuqisë së tij udhëheqëse, gjithmonë e përmendte Allahun, kthehej tek Ai dhe e luste gjithmonë Atë.⁶⁹

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka thënë: *“A dëshironi t’ju tregoj për një armë, që do t’u shpëtojë nga armiqetë tuaj? Luteni Zotin tuaj ditë e natë, sepse arma e besimtarit është duaaja (lutja)”*.⁷⁰

⁶⁷ Sure “El Fet’h”, ajeti 2.

⁶⁸ Uesailu Shiati” i autorit El Hurr El Amilij, vëll. 6, f. 191.

⁶⁹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me banorët e Kunit, më 9.1.1993 (19.10.1371).

⁷⁰ El Kulejni, Shejkh Muhamed bin Ja'kub, “El Kafi”, vëll. 2, f. 468; Korrigjimi dhe Komenti nga Ali Ekber El Gaffarij, Teheran, Dar El Kutub El Islamijetu, shtypshkronja “Hajdari”, 1365 H.Sh, Botimi i dytë.

Kjo është arsyeja, se pse i Dërguari i nderuar i Islamit i kryente të gjitha detyrat e nevojshme në fushën e luftës. Ai organizonte ushtarët, e vendoste secilin prej tyre në vendin e tij, u siguronte atyre bazën e nevojshme materiale dhe i këshillonte ata të bënin atë që duhet. I mbikëqyrte ata ashtu si komandanti mbikëqyr ushtarët e tij.

Në të njëjtën kohë, i lutej me përgjërëm Allahut të Madhëruar, që t'i jepte atë që donte.⁷¹

Mbështetja tek Allahu

I Dërguari ynë i nderuar, kur iu lut Allahut të Madhëruar dhe kërkoi ndihmë prej Tij, në momentet e vështira, nuk e mori parasysh se do të linte përshtypje jo të mirë në mendjen e të pranishmëve dhe ata do ta kuptonin pafuqinë e tij. Përkundrazi, ai thoshte singlerisht se ishte i pafuqishëm dhe nuk mund të bënte një punë pa ndihmën e Allahut të Madhëruar. Gjatë Betejës së Ahzabit, armiq të rrethuan Medinen, të Dërguarin dhe besimtarët, nga disa anë, pasi donin të zhduknin plotësisht Islamin, Kur'anin dhe mesazhin e ri. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në këtë rast, organizonte ushtarët dhe merrte masa të sakta. I nxiste

⁷¹ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 12.5.2000 (23.2.1379).

njerëzit të bënin rezistencë. Përveç kësaj, ai qëndronte në gjunjë dhe lutej. Kjo skenë u përsërit shumë herë dhe u përmend në librat e biografisë. Ai ngrinte duart, lutej dhe qante. Bisedonte me Zotin dhe kërkonte ndihmë, fitore dhe sukses nga Ai, nga më i Larti.⁷²

Të mos kesh frikë nga askush tjetër, përveç Allahut

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e përmendte Allahun në të gjitha rastet dhe kërkonte ndihmë prej Tij në të gjitha fushat e jetës. Ai kërkonte prej Allahut dhe nuk kishte frikë nga askush tjetër përveç Tij. Sekreti themelor i nënshtrimit të të Dërguarit para Allahut të Madhëruar është se ai nuk mori parasysh asnjë fuqi tjetër përkundër Zotit. Marrëdhënia e tij me Allahun nuk ishte një iluzion. Për asnjë moment dhe për dëshirën e askujt, ai nuk e ndërpreu dhe nuk u shkëput nga rruga e Allahut. Shoqëria jonë duhet të shndërrohet në një shoqëri islame, përmes mësimave të nxjerra nga morali profetik.⁷³

⁷² Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 21.10.2005 (29.7.1384).

⁷³ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 27.9.1991 (5.7.1370).

MARRËDHËNIA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT

(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)

ME VETVETEN

Disiplina dhe rregulli

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që nga fëmijëria, ka qenë i pastër dhe i papërlyer. Ndryshe nga fëmijët e tjerë të Mekës dhe fëmijët e fiseve arabe, ai ishte i pastër dhe i rregullt. Në rininë e tij, ai i krihte flokët dhe më pas, kur u bë burrë, filloi të krehë edhe mjekrën. Në moshën pesëdhjetë apo gjashtëdhjetëvjeçare, ai përkujdesej shumë për pastërtinë. Gërshetat e tij të pastra arrinin te veshët. Qëndronte i pastër dhe i donte aromat.

Kam lexuar në një transmetim se në shtëpinë e tij qëndronte një enë me ujë, që ai të shikonte fytyrën e tij, pasi pasqyrat nuk ishin të njohura në atë kohë. Ai e

drejtonte dhe e rregullonte çallmën dhe mjekrën, kur donte të dilte te shokët e tij.⁷⁴

E përdorte parfumin. Në udhëtimet e tij, ai merrte krehër dhe parfum me vete, pavarësisht jetës askete që bënte. Dua të theksoj se jeta e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte një jetë askete. Ai merrte kohl me vete, për të lyer sytë, sepse burrat në atë periudhë i lyejin sytë.

Ai e përdorte misvakun disa herë në ditë dhe i udhëzonte të tjerët të pastronin dhëmbët me misvak dhe ta mbanin të rregullt pamjen e jashtme.⁷⁵

Islami i kushton rëndësi çështjes së bukurisë. Ne kemi dëgjuar shpesh: “Zoti është i bukur dhe e do të bukurën”.⁷⁶ Librat tanë modernë kanë përmendur shumë transmetime në lidhje me kujdesin që tregonte Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për kokën dhe pamjen e tij. Në librin “El Nikah” është bërë një studim i hollësishëm mbi domosdoshmërinë që burrat dhe gratë të kujdesen për veten e tyre. Disa njerëz mendojnë se burrat, për shembull,

⁷⁴ Ekziston një informacion i ngjashëm në veprën “Biharul Anuar”, vëll. 76, f. 307: “Ai qëndronte drejt e shihte mjekrën e tij dhe e rregullonte atë”.

⁷⁵ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 12.5.2000 (23.2.1379).

⁷⁶ El Al'lametu El Mexhlisij, “Biharul Anuar”, vëll. 62, f. 125.

duhet të shkurtojnë flokët e tyre. Jo, në shariat, është e pëlqyeshme, që të rinjtë t'i lënë flokët (sipas zakonit të shoqërisë). Në një transmetim përcillet: *“Flokë i mirë vjen nga mirësia e Zotit, kështu që nderojeni atë”*.⁷⁷

Marrim si shembull një transmetim, ku i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur dëshironte të dilte te shokët e tij, shikohej në një enë me ujë dhe rregullonte pamjen dhe kokën e tij. Në atë kohë, nuk kishte pasqyrë në formën që ekziston sot. Gjithashtu, ajo nuk ishte e përhapur në masë të gjerë, si dhe shoqëria e qytetit ishte një shoqëri e varfër. Kjo tregon se pamja e rregullt, veshja e mirë dhe dëshira drejt bukurisë, kërkojnë të gjitha në shariatin islam. Ndërsa e keqja dhe e dëmshme bëhen mjet trazirash, korrupsioni dhe shfaqjeje.⁷⁸

Nderimi dhe prestigji

Edhe pse i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kishte prestigj hyjnor dhe

⁷⁷ El Hurr El Amilij, “Uesailu Shi'ati”, vëll. 2, K. “Pëlqimi i nderimit të poezisë”, Seksioni 78, f. 129.

⁷⁸ Dialogu me të rinjtë, më 27.4.1998 (7.2.1377).

natyror dhe njerëzit ishin të hutuar në praninë e tij, ai ishte i sjellshëm me njerëzit dhe kishte sjellje të mira me ta.⁷⁹

Pastërtia

Veshja e tij ishte e thjeshtë. Ai hante çfarëdo ushqimi që i vinin para. Nuk kërkonte ushqim të veçantë dhe nuk refuzonte asnjë ushqim si të padëshirueshëm. Këto etika dhe sjellje ishin të pashembullta në historinë njerëzore. Kur komunikonte me të tjerët, ai kishte një pastërti të përsosur. Pastërti të jashtme dhe morale. Abdullah bin Umeri⁸⁰ ka thënë: “Unë nuk kam parë kurrë askënd më bujar, më fisnik, më guximtar dhe më të pastër se i Dërguari i Allahut”.⁸¹⁻⁸²

⁷⁹ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 27.9.1991 (5.7.1370).

⁸⁰ Abdullah bin Umer, sahabiu i njohur, i biri i Khalifit të dytë. Ai lindi në Mekë para hixhretit. Hyri në Islam me babanë e tij dhe migroi para tij në Medine. Në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare, ai ishte midis atyre që morën pjesë në Betejën e Hendekut. Disa u përpoqën ta përzgjidhnin kalif, pas vrasjes së Osmanit, por ai e refuzoi atë dhe, gjithashtu, refuzoi të merrte pozitën e gjyqtarit. Janë transmetuar në “Es Sihah” 2630 hadithe prej tij. Ai vdiq në vitin 73 hixhri, në moshën tetëdhjetë e trevjeçare dhe është i fundit nga sahabët që vdiqën në Mekë.

⁸¹ El Al'lametu El Mexhlisij, “Biharul Anuar”, vëll. 16, f. 231.

⁸² Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran më 27.9.1991 (5.7.1370).

Thjeshtësia në veshje

Transmetohet se në dhomën e vjetër dhe të errët të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kishte një pasqyrë natyrale, një enë me ujë, ku ai drejtonte çallmën, krihte mjekrën, kur donte të dilte te shokët e tij. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) kujdesej dhe e rregullonte çallmën e tij dhe krihte mjekrën. Pse Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e rregullonte çallmën e tij?

Pse e pastronte dhe e krihte mjekrën? Pse transmetimet e shumta përcjellin dhe këshillojnë rregullimin e flokëve të kokës dhe mjekrës dhe përdorimin e krehrave? Cila është arsyeja për këtë?

U transmetua se i Dërguari i Allahut e rregullonte çallmën dhe linte një pjesë të saj të dalë. Cila është rëndësia e kësaj? Rëndësia e kësaj është se ai donte të na jepte një mësim disipline dhe rregulli⁸³. Nuk na është thënë mos vishni rroba të zbukuruara. Në thelb, nuk është e nevojshme të veshim rroba të zbukuruara. Përkundrazi, është më mirë të veshim rroba modeste dhe të thjeshta, por kjo veshje modeste duhet të jetë e pastër dhe jo e ndotur, duhet të jetë e rregullt dhe e sistemuar. Butonat (kopsat) e

⁸³ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët e mobilizimit, më 14.5.1994 (4.2.1373).

saj nuk duhet të jenë të këputura dhe nuk duhet të jenë të hapura. Kjo është ajo që nënkuptohet me disiplinë dhe rregull të dukshëm.⁸⁴

Disa gabojnë, kur imagjinojnë se pamja e rregullt është e njëjtë (barasvlershme) me sjelljen arrogante dhe është simotër e ekstravagancës. Një person mund të jetë i rregullt dhe i pastër, madje edhe me veshje të vjetër dhe modeste. Veshja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)⁸⁵ ishte e vjetër dhe modeste, por fytyra e tij ishte e pastër. Këto çështje ndikojnë shumë në nivelin e ndërveprimit me të tjerët, sjelljen dhe situatën e jashtme dhe shëndetësore. Këto çështje, në dukje të vogla, kanë një ndikim të madh nga brenda.⁸⁶

⁸⁴ I njëjti burim.

⁸⁵ Gazali në librin “El Ihja”: “Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), vishte të gjitha rrobat që mund të gjente, të tilla, si: bluzë, mantel, këmishë, xhube etj. Pëlqente rrobat me ngjyrë të gjelbër. Rrobat e tij ishin nga më të pastrat”. (El Al'lametu Et Tabatabai, Muhammad Husejn, Sunen En Nebij, “Farush Islamiye”, f. 120, Teheran, Botimi i pestë, 1370 Hixhri).

⁸⁶ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 12.5.2000 (23.2.1379).

Qëndrueshmëria dhe drejtësia

Pozita e tij udhëheqëse nuk e ndryshoi atë, as pasuria kombëtare. Sjellja e tij në periudhën e vështirësive nuk ndryshoi nga ajo në fazën kur vështirësitë u kaluan.⁸⁷

⁸⁷ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 27.9.1991 (5.7.1370).

MARRËDHËNIET E TIJ ME NJERËZIT

Modestia dhe dëlirësia

Ai njeri i madh, në rininë e tij, në atë mjedis të korruptuar dhe të shthurur të Gadishullit Arabik para Islamit, ishte i njohur për modestinë dhe dëlirësinë e tij. Të gjithë e njihnin pastërtinë e tij. Ai ishte shumë i sjellshëm. Nuk i zgjati këmbët në prani të askujt dhe nuk ofendoi askënd asnjëherë. Ai ishte shumë i turpshëm. Kur dikush e fajësonte atë për diçka që ai e konsideronte të drejtë, ulte kokën në tokë nga turpi dhe ndrojtja.⁸⁸ Në histori ka shembuj të kësaj natyre.

Falja dhe toleranca

Transmetohet se një beduin që jetonte në shkretëtirë dhe nuk kishte njohuri për qytetërimin, mirësjelljen dhe etikën në jetë, erdhi në Medinë. Me vrazhdësinë dhe karakterin e tij të ashpër, hyri tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). I

⁸⁸ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 12.5.2000 (23.2.1379).

Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në atë moment ishte në mesin e shokëve të tij në xhami.

Ky beduin i kërkoi Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) diçka. Ai e ndihmoi dhe i dha disa para, ushqim dhe rroba. Pas asaj që i ofroi, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e pyeti: “A jeni i kënaqur? A u solla mirë me ju? A është kjo e pranueshme?”

Ai, me atë ashpërsinë e shkretëtirës, sinqeritetin dhe mungesën e mirësjelljes që i karakterizojnë këta njerëz dhe me një ndjenjë se ajo që i kishte dhënë, ishte e vogël, u përgjigj: “Ju nuk keni kryer asnjë punë për mua. Nuk treguat as dashurinë më të vogël dhe ajo që më keni dhënë, nuk është asgjë për të kujtuar”.

Kjo sjellje e vrazhdë me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) pati një ndikim të hidhur dhe la një shije të rëndë në zemrat e shokëve të tij. Të gjithë u zemëruan. Disa nga shokët u ngritën të zemëruar dhe donin ta qortonin beduinin për sjelljen dhe reagimin e tij. Por i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i ndaloi dhe u kërkoi atyre të qëndronin, se ai vetë mund ta zgjidhte çështjen me të.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i la shokët dhe e mori beduinin në shtëpinë e tij. Është e qartë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk kishte shumë, përndryshe ai mund t'i jepte më shumë. Ai i dha gjëra të tjera, si: rroba, ushqim dhe para. Pastaj e pyeti: “A je i kënaqur tani?”

Ai u përgjigj: “Po”.

Ky njeri dukej i kënaqur dhe njëkohësisht i turpëruar nga dashamirësia dhe durimi i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

I Dërguari iu drejtua: “Ju folët disa fjalë para shokëve të mi, gjë që i bëri zemrat e tyre të mërzhiten dhe t’ju urrejnë. A do të donit që ne të shkonim tek ata dhe t’ju tregonim atë që më thatë dhe të shprehnim kënaqësinë tuaj?”

Ai tha: “Po, unë jam gati për këtë”.

Pastaj i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e shoqëroi beduinin natën e asaj dite dhe ditën tjetër te shokët dhe iu drejtuar atyre, duke u shpjeguar se ky vëlla beduin ishte i kënaqur me ta. I tha: “Nëse jeni të kënaqur, atëherë flisni”.

Beduini foli, duke shprehur kënaqësinë, gëzimin dhe falënderimin për të Dërguarin fisnik, për dashurinë që tregoi për të. Pasi i tha këto dhe mbaroi së foluri, u largua.

Beduini u largua. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu drejtua shokëve të tij, duke u shpjeguar atyre se beduini është si një deve që ndahet nga tufa dhe vrapon në shkretëtirë. Ai u shpjegoi atyre se, nëse do ta sulmonin devenë për ta kapur dhe për ta kthyer, ata do ta ndiqnin atë në çdo anë. Kjo ia shton frikën asaj. Atëherë ashpërsia e saj do të rritet dhe do të bëhet e vështirë për ta kapur atë. Ai nuk i lejoi t'ia shtonin frikën. Përkundrazi, e drejtoi me dashuri dhe butësi dhe e solli përsëri në gjirin e tyre.

Kjo është rruga e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).⁸⁹

Ndershmëria

Ndershmëria e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) arriti në atë masë, sa që në periudhën paraislame ai u quajt “el emin” dhe njerëzit vinin tek ai me amanetet e tyre shumë të rëndësishme. Kjo çështje vazhdoi edhe pas fillimit të

⁸⁹ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989 (7.28.1368).

thirrjes islame dhe ndezjes së armiqësisë me kurejshët. Në këtë periudhë, armiqtë, nëse do të donin t'i besonin diçka një personi, do të vinin tek i Dërguari i Allahut. Kjo është arsyeja pse ju keni dëgjuar se, kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) emigroi në Medine, ai e la Aliun për t'ua kthyer amanetet pronarëve të tyre. Nëpërmjet kësaj bëhet e qartë se në atë kohë ai kishte disa amanete. Ato nuk ishin amanet për myslimanët, por amanet për jobesimtarët dhe njerëzit që janë armiqësorë ndaj tij.⁹⁰

Dashuria

Sjellja e tij me njerëzit ishte e mirë dhe ai ishte gazmor mes tyre. Ankthet, hidhërimet dhe dhimbjet e tij i shfaqte kur ishte vetëm. I përshëndeste të gjithë. Nëse dikush e lëndonte, ai do ta shprehte atë në fytyrë, por gjuha e tij nuk e shprehte diçka të tillë. Nuk e lejonte fyerjen ose ofendimin e një personi në praninë e tij. Ai ishte i butë me fëmijët dhe sillej mirë me gratë. Kishte sjellje të dashur me të dobëtit, bënte shaka me miqtë e tij dhe merrte pjesë në garat me kuaj.⁹¹

⁹⁰ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 12.5.2000 (23.2.1379).

⁹¹ I njëjti burim.

Drejtësia

Marrëdhëniet e tij me njerëzit bazoheshin në ndershmëri, pastërti dhe miqësi.⁹²

Cila ishte gjëja që e drejtonte lëvizjen e madhe të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)? Monoteizmi, i shoqëruar me adhurim, përgjërëm dhe të qara në mes të natës. Kishte dukuri të tilla, si: dija, guximi, xihadi, politika. Nëse do të shikoni historinë, do të gjeni shembuj të këtyre dukurive, në atë periudhë të shkurtër të jetës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Dhjetë vitet e jetës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishin një jetë e çuditshme.

Në fakt, aty ekzistojnë shumë argumente, që, për fat të keq, shumë prej nesh nuk i njohin. Ndershmëria, ishte shenja e atij vizioni monoteist. Ata e ruanin gjithmonë këtë ndershmëri në punë dhe në të folur. Asnjë metodologji që ndiqet, asnjë udhërrëfyes politik, asnjë manovër politike nuk mund të ketë tërheqjen që gjendet te ndershmëria që tërheq zemrat drejt saj. Në fakt, ai e zotëronte këtë veçori.⁹³

⁹² I njëjti burim.

⁹³ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me anëtarët e Tubimit studentor islam, më 8.10.2000 (17.8.1379).

Shpenzimet

Të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i sollën një dele. Ai e theri atë. Të varfrit dhe ata që meritonin prej mishit të saj, u mblodhën së bashku për të marrë pjesën e tyre të mishit. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) priste mishin e deles që kishte therur për vete dhe e ndante mes tyre. Nga e gjithë delja i mbeti atij vetëm shpatulla. Dhe meqenëse nuk kishte mbetur askush pa marrë mish, ai mori shpatullën në shtëpi për ta gatuar. Njëra nga gratë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i tha: “O i Dërguari i Allahut, e gjithë delja është shpërndarë dhe ka mbetur vetëm kjo shpatull”.

I Dërguari i Allahut iu përgjigj: “Jo. Gjithçka ka mbetur prej deles, por shpatulla është ajo që do të humbasim, sepse do ta konsumojmë ne dhe asgjë nuk do të mbetet prej saj. Ajo që kemi dhuruar, ajo do të na mbetet”.⁹⁴

⁹⁴ Nga fjalat e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në takimin me personat me aftësi të kufizuara, më 19.7.1989 (28.4.1368).

Sjella e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte larg arrogancës

Kështu ishte sjellja e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me njerëzit. Sillej mirë me ta dhe në mënyrë njerëzore. Vepronte njerëzisht, pa arrogancë dhe pa i detyruar. Edhe pse ai kishte prestigj hyjnor dhe natyror, edhe pse njerëzit hutoheshin nga prania e tij, ai ishte i sjellshëm dhe kishte moral të mirë me ta.⁹⁵

Trimëria

Ai ishte trim. Askush nga frontet e mëdha armike nuk mund ta frikësonte dhe ta trembte atë. Këto karakteristika mund të shiheshin gjatë gjithë jetës së atij njeriu të madh, që nga rinia deri në vdekjen e tij, për gjashtëdhjetë e tre vjet.

Thjeshtësia

Thjeshtësia e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte se ai mund të

⁹⁵ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 27.9.1991 (5.7.1370).

duronte të dëgjonte gjëra që të tjerët nuk mund të duronin t'i dëgjonin. Armiqtë e tij në Mekë ndonjëherë silleshin me të në atë mënyrë sa Ebu Talibi u zemërua dhe hoqi shpatën, kur dëgjoi diçka të tillë. Përkundrazi, atë e shoqëronte shërbëtori i tij dhe i tregonte për ata që guxonin të sulmonin të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke i kërcënuar ata me vdekje. Për sa i përket Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ai i përballonte këto skena me përlulësi të madhe.

Në një rast, u zhvillua një debat me Ebu Xhehlin. Ebu Xhehli e ofendoi të Dërguarin, por ai zgjodhi të heshte dhe tregoi përlulësi. Dikush shkoi dhe i tregoi Hamzasë se çfarë kishte bërë Ebu Xhehli me nipin e tij. Hamzai, i zemëruar, shkoi te Ebu Xhehli dhe e goditi me hark në kokë dhe gjaku rrodhi prej tij. Pastaj, nën ndikimin e këtij incidenti, ai erdhi dhe njoftoi se kishte hyrë në Islam dhe ishte bërë mysliman.

Po kështu ishte çështja e pranimit të Islamit me disa myslimanë. Ata ndonjëherë, si rezultat i neglizhencës ose injorancës, do ta fyenin të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) për ndonjë çështje të caktuar.

Në një rast tjetër, një nga gratë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*),

Zejneb bint Xhahsh⁹⁶, e cila ishte një nga nënat e besimtarëve, shkoi tek ai dhe i tha: “Ti je i Dërguari i Allahut, por nuk je i drejtë!”

Profeti buzëqeshi dhe heshti, pasi ajo po priste diçka prej tij në jetën bashkëshortore. Herë pas here, disa njerëz vinin në xhami. Ata qëndronin ulur, duke shtrirë këmbët dhe i kërkonin që t’u shkurtonte thonjtë. Aty u vinte dëshira për të shkurtuar thonjtë. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e duronte me përlulesi gjithë këtë guxim dhe mungesë sjelljesh.⁹⁷

⁹⁶ Nëna e besimtarëve, Zejneb, vajza e Xhahsh bin Rabab bin Jamad El Esedi. Nëna e saj ishte Umaima, vajza e Abdul Mutalibit, teza e të Dërguarit të Allahut. Pseudonimi i saj ishte Ummu El Hakim. Ajo besoi në ditët e para të thirrjes së Profetit dhe ishte një nga emigrantet e para femra. Ajetet e Hixhabit, ajeti 53 i sures “El Ahzab”, u shpallën për Zejnebin, Nënë e besimtarëve, me rastin e martesës së saj. Ajo e shoqëroi Profetin Muhamed në Betejën e Hajberit. Ajo ishte një grua e mirë dhe e përlulur. Ishte shumë e dhënë pas namazit (të lutej) dhe jepte lëmoshë për të varfrit.

⁹⁷ Hytbeja e namazit të xhumasë, më 12.5.2000 (23.2.1379).

Shërim për dhembjet e njerëzve

Ajo që ne mësojmë, është se misioni i Vulës së Profetëve është një festë për mbarë njerëzimin. Kjo u bë e mundur nëpërmjet mësimave të Islamit. Nëpërmjet tij shëroheshin të gjitha vuajtjet njerëzore, me melhemet më të mira.⁹⁸⁻⁹⁹

⁹⁸ Es Sejid Err Rradij, “Nehxhu el Belaga”, Hytbeja 108.

⁹⁹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë, më 13.2.1991 (24.11.1369).

MORALI QEVERISËS

Robërim dhe bindje e pastër ndaj Zotit

Kur duam të përmendim emrin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gjatë teshehudit në namaz dhe, kur duam ta respektojmë atë, themi: “Unë dëshmoj se Muhamedi është robi i Tij”. Pra, së pari, përmendim robërinë dhe më pas themi “i Dërguari i Tij”. Robëria është më e lartë se mesazhi. Robëria është baza dhe thelbi i veprimtarisë.¹⁰⁰

Baza është robëria ndaj Zotit

Vlera e babait të Fatimes (*Paqja qoftë mbi ta!*) tek Allahu i Madhëruar, në adhurim, manifestohet në parimin se Fatimja është burimi i virtyeteve të të gjithë të pagabuarve. Ajo dhe Prijësi i Besimtarëve janë pika nga oqeani i qenësisë së të Dërguarit të Allahut. “Unë dëshmoj

¹⁰⁰ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në takimin me recituesit e Ilahive të Ehli Bejtit (*Paqja qoftë mbi ta!*), më 19.8.2003 (28.5.1382).

se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij". Në fillim ishte robëria e tij, pastaj mesazhi i tij. Në të vërtetë, pozita e mesazhit iu dha atij dhe kjo është një pozitë e lartë, për shkak të adhurimit. Allahu i Madhëruar e di mirësinë e krijesave të Tij.¹⁰¹

Thirrja drejt të drejtës dhe të vërtetës

Veprimtaria e rëndësishme e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte thirrja (daveti) drejt të vërtetës, të drejtës dhe xhihadi (sakrificën) në rrugën e kësaj thirrjeje. I Dërguari fisnik nuk u step përballë botës së errët të kohës së tij, qoftë kur ishte vetëm në Mekë, qoftë kur ishte i rrethuar nga një pakicë myslimanësh, duke u përballur me udhëheqësit arrogantë arabë dhe prijësve kurejsh.

Ai u përball me parinë e tyre, me moralin e tyre të ashpër dhe mundësitë e tyre të panumërta. Gjithashtu, u takua me njerëzit e thjeshtë që nuk ishin njerëz të dijes. Ai nuk kishte frikë. Ai fliste gjithmonë të vërtetën, e përsëriste atë, i sqaronte, duronte fyerjet e tyre dhe pranonte

¹⁰¹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në takimin me recituesit e Ilahive të Ehli Bejit (*Paqja qoftë mbi ta!*), më 27.7.2005 (5.5.1384).

vështirësitë dhe dhimbjet. Rezistoi, derisa arriti ta paraqiste Islamin në një numër të madh njerëzish.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk u tërhoq për asnjë moment nga fusha e thirrjes dhe xhihadit. Bashkësia islame po përparonte fuqishëm, për të arritur kulmin e lavdisë dhe të fuqisë.¹⁰²

Xhihadi në rrugën e thirrjes për të vërtetën

Kjo krijesë unike hyjnore dhe ky njeri i përsosur, i cili arriti këtë fazë të përsosmërisë para zbritjes së Shpalljes hyjnore, që në momentet e para të misionit, filloi një xhihad sakrifice kompleks dhe të vështirë nga të gjitha anët, ku kaloi njëzet e tre vjet me vështirësi të mëdha. Ishte një xhihad me njerëz që nuk e kishin kuptuar të vërtetën dhe një xhihad në atmosferë shumë të zymtë. Ai mbushi faqet e errëta të historisë në të gjitha aspektet e jetës njerëzore. Xhihadi i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) filloi me energji të madhe dhe punë të vazhdueshme, pa u ndalur, që në orët e para të misionit dhe marrjen e Shpalljes hyjnore. Shpallja hyjnore zbriste në zemrën e tij të shenjtë si uji i shiut që zbret në tokën e përgatitur dhe i jep forcë, duke përdorur

¹⁰² Hytbja e namazit të xhumasë në Teheran, më 9.27.1991 (5.7.1370).

të gjitha fuqitë e tij për të krijuar një transformim të madh në këtë botë. Ai pati sukses.¹⁰³

Biografia e profetëve, që në fillim është lëvizje dhe guxim. Që nga fillimi ato që shpreheshin me gjuhën e tyre, u realizuan me veprimet e tyre. Kjo është pikërisht ajo që ndodhi në jetën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Mësimet dhe lëvizjet e tij ishin për krijimin e barazisë. Për këtë arsye, që në momentin e parë, filloi përballja dhe kundërshtimi.

Që nga momenti, kur i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) filloi ta përhapte thirrjen e tij në një masë të gjerë, në përgjigje të ajetit: **“Paralajmëroje farefisin tënd më të afërm”**¹⁰⁴, çështja vazhdoi në këtë formë deri në kohën kur thirrja përfshiu të gjithë njerëzit dhe u bë publike. U rrit dhe u bë sistem shoqëror dhe sistem drejtësie.¹⁰⁵

¹⁰³ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë dhe mysafirët e Konferencës së unitetit islam, më 22.8.2006 (31.5.1385).

¹⁰⁴ Sure “Shuara”, ajeti 214.

¹⁰⁵ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë më 20/12/1995 (29/9/1374).

Përmbushja e premtimeve

Në etikën e tij qeverisëse, ai ishte besnik ndaj besëlidhjes dhe premtimeve. Kurrë nuk e ka shkelur zotimin. Kurejshët nuk i përmbushën zotimet e tyre me të, por ai nuk iu përgjigj atyre me të njëjtën mënyrë. Po kështu, shumë herë jehudët nuk i përmbushën premtimet e tyre, por ai nuk i shkeli ato.¹⁰⁶

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e theu asnjëherë besëlidhjen. Edhe armiqtë pranojnë se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e theu besëlidhjen në asnjë rast, por ishin ata që e thyen besëlidhjen dhe marrëveshjet me të.

Ai nuk i braktisi besëlidhjet dhe traktatet e tij me njerëzit dhe grupet me të cilat krijonte besëlidhje dhe lidhte marrëveshje me ta. Edhe me armiqtë e tij, edhe me të pafetë e Mekës, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e prishi besëlidhjen dhe marrëveshjen e tij me ta, por ishin ata që i thyen. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) iu dha përgjigje përfundimtare. Kështu,

¹⁰⁶ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë më 20/12/1995 (29/9/1374).

të gjithë e dinin se, kur lidhnin një pakt apo marrëveshje me këtë person, mund t'i besonin atij.¹⁰⁷

¹⁰⁷ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001 (2.2.1380).

THEMELIMI I QEVERISJES ISLAME

Misioni i të Dërguarit të Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)* **për krijimin e qeverisë islame**

I Dërguari i Allahut *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, me të mbërritur në Medinë, nisi krijimin e qeverisë. Çfarë do të thotë qeveri? Ai nuk shkoi dhe u ul në një qoshe dhe t'u thoshte njerëzve se, meqenëse dëmi që vinte prej të pafeve kurejsh është larg, ata mund të vinin pranë tij dhe të interesoheshin për çështjet që u interesonin atyre. Ose t'u thoshte, se, nëse doni të mësoni namazin, shkoni tek filani, ose ejani tek unë për t'jua mësuar. Në fillim ai krijoi një qeveri dhe një udhëheqje. Ky ishte akti i parë në Islam.

Menjëherë kjo qeveri filloi të praktikojë veprimet e saj me kompetencë dhe të përgatitej për luftë. Më pas ajo filloi dërgimin e mesazheve në vende të ndryshme dhe kujdesej për zgjidhjen e çështjeve të tjera. Përkundër këtij

fakti, kush mund të kishte këndvështrim dhe koncept tjetër përveç bashkimit të fesë dhe politikës në Islam?¹⁰⁸

Të Dërguarit e Allahut erdhën me një mision: **“Ne i kemi nisur të Dërguarit vetëm me qëllimin që njerëzit, me lejen e Allahut, t’u binden atyre”**.¹⁰⁹ Profeti erdhi dhe njerëzit duhet t’i binden. Profeti nuk erdhi për të dëgjuar një person në një çështje dhe për të folur për një numër çështjesh, që disa njerëz e dëgjojnë dhe të tjerët jo. Çështjet mund të arrijnë në luftë për të vendosur këtë urdhër

¹⁰⁸ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët e Haxhit, më 3.3.2001 (13.12.1376).

* Gazeta “El Imam”, vëll. 8, f. 41: “Qëllimi i Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), nuk ishte zhdukja e politeistëve të Mekës apo i politeistëve të Gadishullit Arabik, por përkundrazi, synimi i tij ishte përhapja e fesë islame dhe të ishte qeverisja e tij, qeveria e Kur’anit, qeveria e Islamit. Por, për shkak se ata u bënë pengesë për arritjen e qeverisë islame, çështja arriti në pikën e luftës. Politeistët e kundërshtonin qeverinë islame dhe besimtarët po përballeshin me ta. Luftërat e shumta që udhëhoqi i Dërguari i Allahut ishin të gjitha në këtë kontekst, heqja e pengesave përmes vullnetit hyjnor. Qëllimi i tij ishte sipëror dhe ai ishte udhëheqja e qeverisë islame, domethënë qeveria e Zotit dhe e Ku’ranit mbi të gjithë. Po të mos e kishin kundërshtuar krijimin e qeverisë islame, nuk do të ndodhte konfrontimi dhe as do të zhvillohej lufta. Ata kundërshtuan dhe nuk e lejuan krijimin e qeverisë islame dhe ndodhi lufta ndërmjet tyre”.

¹⁰⁹ Sure “En Nisa”, ajeti 64.

hyjnor. Sa profetë njihni? **“Sa e sa profetë bashkë me shumë besimtarë të vërtetë luftuan?”**¹¹⁰

Ka pasur shumë profetë, por ne nuk i njohim ata, si dhe nuk kemi asnjë lajm për ta. Një nga kërkesat e para që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vendosi në programin e tij, që në momentin e parë kur hyri në Medine, ishte krijimi qeverisë islame. Ishte kërkesa për të demonstruar fuqinë e qeverisë. Kjo do të thotë që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), kur hyri në Medine, hyri si udhëheqës.

Sfondi qeveritar që i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dëshironte të krijonte, ishte dashuria, doktrina dhe besimi. Një qeveri e tillë është qeveria më e fuqishme dhe prestigjioze. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) krijoi një kordon sigurie rreth qytetit, duke u mbështetur tek këta njerëz. Ju e dini se vrasja dhe bastisja ishin ndër gjërat më të thjeshta dhe më të lehta për fiset arabe.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e nisi këtë praktikë që në vitin e parë. Fillimisht dërgonte çeta, pastaj vijoi me betejat. Ai i kritikonte njerëzit që ishin indiferentë ndaj kësaj lëvizjeje,

¹¹⁰ Sure “Ali Imran”, ajeti 146.

ose që kishin frikë të merrnin pjesë në to. **“A nuk i ke parë (o Muhamed) ata që janë porositur: ‘Tërhiqni duart tuaja nga lufta, falni namazin dhe jepni zekatin!’?! Por kur, pas kësaj, u urdhëruan që të luftojnë...”**¹¹¹

Një ditë prej ditësh atyre iu tha të mos gabojnë. Ku? Në Mekë. Kur ishte ajo ditë? Dita **“për të tërhequr duart tuaja”**. Kur hytë në qytet dhe krijuat një qeveri. Është dita, kur duhet të përpiqeni me gjithë forcën tuaj, përfshirë forcën tuaj fizike (muskujt), forcën e luftës dhe sakrificave. Duhet të punoni për t’i dhënë pushtet sundimit të Islamit. Qeverisja e Islamit është një nga dijet më të larta islame.¹¹²

Përkujdesje serioze për të siguruar interesat e myslimanëve

Morali qeveritar i atij kolosi të madh është: Vigjilenca dhe përgatitja kundër ngacmimeve të armiqve, përvulësia para besimtarëve, bindja dhe robërimi i pastër në kuptimin e vërtetë ndaj urdhrave të Zotit, shpejtësia në veprim dhe lëvizja drejt interesave të myslimanëve. Kjo

¹¹¹ Sure “En Nisa”, ajeti 77.

¹¹² Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) me një grup dijetarësh shi’it dhe suni, në provincën Sistan dhe Belushistan, më 23.2.2003 (4.12.1381).

është një përmbledhje e personalitetit të atij njeriu të madh.¹¹³

“Nuk ka asgjë që ju afron me Xhenetin dhe ju mban larg nga Xhehenemi, përveçse unë ju kam ndaluar prej tij dhe ju kam urdhëruar ta bëni atë”.¹¹⁴

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ka sqaruar të gjitha gjërat që e çojnë njeriun dhe shoqërinë njerëzore drejt lumturisë. Ai jo vetëm që e shpjegoi atë, por, gjithashtu, edhe e veproi dhe e punoi atë. Në kohën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), u krijua qeveria islame, u zbatua ekonomia islame, u krijua xhihad islam, u mbledh zekati islam, vendi u bë islam dhe sistemi islam.

Për sa i përket arkitektit të këtij sistemi dhe drejtuesit të këtij treni në këtë linjë, ai është Profeti fisnik (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe personi që ishte pasardhësi i tij.¹¹⁵

¹¹³ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 12.5.2000 (23.2.1379).

¹¹⁴ El Alametü Mexhlisi, “Bihar el Enuar”, vëll. 2, f. 171.

¹¹⁵ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 9.6.1995 (19.3.1374).

Durimi dhe përballimi i vështirësive

Profeti i madh, së bashku me shokët e tij besnikë, duruan trembëdhjetë vjet dhe përballuan vështirësi dhe hidhërime, derisa fara e Islamit zuri rrënjë. Pasi u realizua besëlidhja e Akabesë me banorët të Jethribit dhe hixhretit (emigrimit) të bekuar në qytetin e Profetit; pas torturimit të shokëve të tij, si: Bilali, Amari, Jasiri, Sumeja, Abdullah bin Mes'udi dhe të tjerë; pas një udhëtimi të gjatë, të mundimshëm dhe të pafrytshëm të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) midis fiseve të Mekës dhe Taifit, u themelua qeveria islame, e cila u krijua në pronën e Ebu Talibit.¹¹⁶

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i kërcënuar nga të gjitha anët. Disa njerëz u mërzitën, të tjerët u pezmatuan, disa u ankuan, të tjerë fajësuan të Dërguarin të Allahut dhe i kërkuan atij të bënte paqe, por ai nuk u tërhoq për asnjë moment nga arena e thirrjes dhe xhihadt, madje e udhëhoqi bashkësinë islame, që të arrijë kulmin e lavdisë dhe të forcës. Në vitet në vijim, ky sistem dhe kjo shoqëri ishte në gjendje të bëhej forca numër një në botë me bekimet e qëndrueshmërisë së të Dërguarit në fushat e betejës dhe davetit.¹¹⁷

¹¹⁶ Një apel për haxhinjtë e Shtëpisë së Zotit, më 16.6.1991 (26.3.1370).

¹¹⁷ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 27.9.1991 (5.7.1370).

Vendosja e rregullit në shoqëri

Administrata e tij shoqërore dhe ushtarake ishte në nivelin më të lartë dhe i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ndiqte çdo çështje. Sigurisht, ai ishte një komunitet i vogël, në qytet dhe periferitë e tij. Më pas, kësaj administrate iu shtua Meka dhe një ose dy qytete të tjera. Ai shqetësohej për çështjet e njerëzve dhe ishte i organizuar dhe i disiplinuar. Në atë shoqëri beduine, ai administronte, llogariste, gjykonte, i motivonte dhe i këshillonte njerëzit. Kjo ishte jeta shoqërore e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që ne të gjithë duhet ta imitojmë, duke filluar nga zyrtarët e shtetit dhe populli.¹¹⁸

Puna për të vendosur drejtësinë mes njerëzve

Pika tjetër në thirrjen islame ishte vendosja e drejtësisë mes njerëzve. Ndër veçoritë e shoqërisë së injorancës ishte sistemi i padrejtë. Padrejtësia ishte një praktikë e zakonshme. Islami punoi fort në të kundërtën e

¹¹⁸ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 27.9.1991 (5.7.1370).

saj, duke sjellë drejtësi. **“Allahu urdhëron për drejtësi dhe mirësi”**.¹¹⁹

Drejtësia nuk është vetëm një parullë, por ajo është nga veçoritë e shoqërisë islame. Përkundrazi, shoqëria islame duhet të ecë drejt drejtësisë. Nëse drejtësia mungon, ajo duhet ta vendosë atë. N.q.s. në botë ekzistojnë dy skaje të kundërta, njëra prej tyre është drejtësia dhe tjetra është padrejtësia. Edhe nëse të dyja janë joislame, atëherë Islami tregon pajtueshmërinë e tij me drejtësinë, edhe nëse ajo është joislame. I Dërguari fisnik (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është ai që i urdhëroi myslimanët të emigrojnë në Abisini.

Ai i dërgoi ata për të qenë nën mbrojtjen e një mbreti (jomysliman), për shkak të drejtësisë së tij. Me fjalë të tjera, njerëzit qëndruan larg nga mjedisi në të cilin jetonin dhe vendlindja e tyre, për shkak të padrejtësisë që u ishte shkaktuar atyre.¹²⁰

Përmbledhja e kuptimit të ajetit: **“dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt”**¹²¹, është që njerëzit të jetojnë në një mjedis me drejtësi, në një shoqëri të drejtë dhe në një sistem të drejtë shoqëror. Për këtë

¹¹⁹ Sure “En Nahl”, ajeti 90.

¹²⁰ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë, më 31.12.1991 (10.10.1370).

¹²¹ Sure “El Hadid”, ajeti 25.

çështje erdhi i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Sigurisht, në sistemin e drejtë, njerëzit gjejnë mundësinë për të arritur përsosmërinë: **“që njerëzit të veprojnë drejt”**.

Më pas Allahu i Madhëruar thotë: **“Ne e zbritëm hekurin”**.¹²² A mjafton vetëm të flasësh, të predikosh dhe t’u thuash njerëzve, që të vijnë për të krijuar një sistem të drejtë?

Nëse supozojmë se njerëzit ishin në gjendje të krijonin një sistem të drejtë, por a do të lejonin ujqërit, hajdutët dhe kriminelët të ekzistonte ky sistem i drejtë? Kështu që ne zbritëm hekurin. Pse e zbritëm hekurin? Kur kthehemi te librat e hadithit, gjejmë se një nga imamët e Ehli Bejtit (*Pqja qoftë mbi ta!*), kur e komentoi ajetin dhe arriti te fjalja: **“Ne e zbritëm hekurin”**, tha: “për të krijuar armën”, shpatë, shigjetë dhe armë që janë bërë prej hekuri. Allahu i Madhëruar flet për armët, përkundër asaj që flet për davenin dhe profetësinë. Allahu i Lartësuar flet për armët dhe forcën madhore të tyre, ashtu sikurse flet për këshillat dhe butësinë që i urdhëroi profetët për themelimin e rendit monoteist dhe hyjnor.

¹²² Sure “El Hadid”, ajeti 25.

Mirësjellja

Njerëzit jetuan me Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhjetë vjet. Ata shkuan në shtëpinë e tij dhe ai i vizitoi ata në shtëpitë e tyre. Ishin së bashku në xhami dhe në rrugë. Udhëtuan së bashku. Fjetën dhe ishin të uritur dhe të lumtur. Ata njerëz që jetuan me të për dhjetë vjet, në zemrat e tyre po thellohej dashuria dhe besimi tek ai ditë pas dite. Ebu Sufjani u fsheh, gjatë pushtimit të Mekës dhe për të qenë i sigurt, hyri në kampin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), me mbrojtjen e Abasit, xhaxhait të Profetit. Ai shihte Profetin që merrte abdes në mëngjes dhe njerëzit u mblodhën rreth tij për të kapur pikat e ujit që i binin nga fytyra dhe duart. Ai tha në atë moment: “Kam parë Kisran dhe Çezarin, dy mbretërit e mëdhenj dhe të fuqishëm në botë, por këtë lavdi nuk e kam parë tek ata”.¹²³

Skenë tjetër nga jeta e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), është etika dhe sjellja e tij me njerëzit. Ai kurrë nuk e harroi moralin, karakterin popullor, dashurinë dhe mirësinë ndaj njerëzve dhe përpjekjen për të vendosur drejtësi mes tyre. Ai jetoi si njerëzit dhe në mesin e tyre. Ulej dhe ngrihej me ta. Ishte mik i tyre, shok i djemve dhe i shtresave të ulëta të

¹²³ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001 (2.2.1380).

shoqërisë. Hante dhe qëndronte me ta, si dhe u shfaqte atyre dashuri dhe mirësjellje. As pushteti dhe as pasuria kombëtare nuk e ndryshuan atë. Sjellja e tij në periudhën e vështirësive nuk ndryshonte nga ajo në fazën e përfundimit të vështirësive. Ai ishte me njerëzit dhe qëndroi me ta në të gjitha rrethanat. Ai ishte i sjellshëm dhe donte drejtësi për ta.¹²⁴

Caktimi në udhëheqje

Personi për të cilin po flasim në këtë ditë (Kurban Bajrami), është shenjtëria e tij, Prijësi i Besimtarëve, kujdestari i të devotshmëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*). Ishte një model dhe një figurë e shkëlqyer në dy aspekte të udhëheqjes. Trashëgimia për vetveten dhe nënshtrimin ndaj saj është pjesa bazë. Ai ishte shembull në lidhje me qeverinë islame dhe me juridiksionin hyjnor. Shembulli më i përsosur dhe shembulli më i ndritshëm në histori për këdo që dëshiron të njohë mandatin hyjnor, qëndron këtu.

Ai duhet të paraqitet dhe të jetë si mësim për ne sot. Ne duhet të bëjmë përpjekje dhe të përpiqemi në këto dy aspekte. Çdo fjalë dhe çdo lëvizje e udhëheqësit dhe të dashurit tonë, Ali bin Ebu Talibit (*Paqja qoftë mbi të!*), mund

¹²⁴ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 29.7.1991 (7.5.1370).

të jetë një mësim për çdo qenie njerëzore. Në portën e qeverisjes ka dy çështje kryesore:

E para: Fusha e shpirtit njerëzor, ku një person mund ta bëjë vullnetin hyjnor udhëheqës për veten e tij dhe ai futet në kujdestarinë e Allahut. Ky është hapi i parë dhe thelbësor.

E dyta: Është hyrja e mjedisit jetësor në kujdestarinë e Zotit. Domethënë, ajo shoqëri lëviz nën kujdestarinë hyjnore, në mënyrë që asnjë pozitë të mos e pengojë atë, qoftë ajo pozita e pasurisë, e njerëzve dhe e fisit, e pushtetit, e traditave, e moralit dhe e zakoneve të gabuara etj. Të gjitha këto mund të përbëjnë pengesë për sundimin hyjnor, ose të shpallen si kundërshtarë të kujdestarisë së Allahut.¹²⁵

Profeti fisnik i Islamit ka kryer një nga detyrat më të rëndësishme në ndjekjen e urdhrave të Allahut dhe në përputhje me ajetet e qarta të Kur'anit: **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt!”**¹²⁶ Çështja e emërimit të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), si udhëheqës dhe khalif, ka një rëndësi aq të

¹²⁵ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë, më 9.6.1993 (19.3.1372).

¹²⁶ Sure “El Maide”, ajeti 67: **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij; Allahu të ruan ty prej njerëzve. Natyrisht që Allahu nuk i udhëzon njerëzit që nuk besojnë”.**

madhe, saqë, nëse nuk e keni vepruar, atëherë nuk e keni përcjellë mesazhin e tij. Ajo që nënkuptohet këtu, është se ju nuk e keni dhënë mesazhin në këtë rast të veçantë. Është sikur të gjesh një gërvishtje në origjinën e mesazhit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Duke mos e emëruar, është sikur të mos e kishte përcjellë origjinën e mesazhit. Ka të ngjarë që ky të jetë kuptimi i saj.

Në këtë rast, çështja është shumë e rëndësishme. Kjo do të thotë se çështja e krijimit të qeverisë, e udhëheqjes dhe e administrimit të vendit bëhet pjesë e teksteve bazë të fesë. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i shqetësuar për ta përcjellë mesazhin para njerëzve. Në një mënyrë apo formë, duket sikur ai nuk kishte komunikuar asnjë urdhër të detyruar: as namaz, as zekat, as agjërim, as Haxh.¹²⁷

Pasimi i ligjit hyjnor

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte shumë konservator dhe kujdesej për rregullin dhe ruajtjen e ligjit. Nuk lejonte askënd të shkelte ligjin, qoftë nga ana e tij, apo nga ana e të tjerëve.

¹²⁷ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë, më 7.5.1996 (18.2.1375).

Ai qeverisi me ligjet hyjnore. Ajetet kur'anore e shprehin qartë këtë çështje. I zbatoi me përpikëri ligjet që duhet të ndiqnin njerëzit dhe nuk lejonte neglizhimin e tyre. Në luftën me Beni Kurejdhat u vranë tradhtarët dhe pjesa tjetër u zu rob. Sollën paratë dhe pasurinë e Beni Kurejdhave. Disa nga gratë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i folën atij. Mes tyre ishin nënat e besimtarëve: Zejneb bintu Xhahsh, Aisheja dhe Hafsaja të cilat i kërkuan një pjesë të këtij ari dhe të kësaj pasurie që ishte mbledhur nga hebrenjtë.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e plotësoi kërkesën e tyre, pavarësisht nga dashuria dhe sjellja e tij e mirë ndaj tyre. Nëse Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) do të donte t'u jepte grave e tij nga ajo pasuri, myslimanët nuk do ta kishin kundërshtuar, por ai nuk e bënte këtë. Gratë e tij këmbëngulnin për këtë.

Për këtë arsye, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qëndroi larg tyre për një muaj. Pas kësaj ngjarjeje zbritën ajetet e shpallura në suren "El Ahzab: **"O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera"**

"O i Dërguar! Thuaju grave tua: 'Nëse dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, ejani, unë do t'ju lë të

¹²⁸ Sure "El Ahzab", ajeti 32.

kënaqeni për ca kohë dhe do t'ju lëshoj si është më mirë. Por, nëse dëshironi Allahun, të Dërguarin e Tij dhe Botën Tjetër, dijeni se Allahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë vepra të mira'''.¹²⁹

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ua bëri të qartë atyre: "Nëse doni të jetoni me mua, atëherë do të bëni një jetë askete, në të cilën nuk ka vend për shkeljen e ligjeve dhe të rregullave".¹³⁰

Njohja e armikut

Një ndër pikat e rëndësishme në jetën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte se ai nuk i barazoi armiqtë. Disa armiq, edhe pse armiqësia e tyre ishte e thellë, por, kur i Dërguari konstatonte se ata nuk përbënin një rrezik themelor, ai i linte ata dhe i toleronte. Kurse disa armiq, që ishin të

¹²⁹ Sure "El Ahzab", ajetet 28-29.

¹³⁰ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 12.5.2000 (23.2.1379).

* Gazeta "El Imam", vëll. 8, f. 281: "Qeveria e të Dërguarit të Allahut dhe qeveria e Prijësit të besimtarëve është qeveria e ligjeve dhe e rregullit, që do të thotë se ligjet aty zbatohen. **"Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe udhëheqësve tuaj"**. Ky është ligji i Allahut dhe jemi të detyruar t'i bindemi sundimit të ligjit. Rregulli është sundimi i ligjit. Ai duhet të sundojë në vendet islame dhe nuk duhet të ketë qeveri tjetër veç tij".

rrezikshëm, i mbante nën vëzhgim. Ndër ta përmendim Abdullah bin Ubejin. Ai ishte një hipokrit i klasit të parë dhe komplotoi kundër të Dërguarit të Allahut.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e mbante nën vëzhgim atë. Ai nuk ndërhyri në veprimet e tij dhe në këtë mënyrë mbeti gjallë deri në fund të jetës së të Dërguarit të Allahut Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Abdullah bin Ubeji vdiq pak para vdekjes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Këta ishin një grup armiqsh, të cilët nuk përbënin një kërcënim real për qeverinë, për bashkësinë islame dhe sistemin islam.

Për sa u përket armiqve, që përbënin një kërcënim real, i Dërguari i Allahut, Muhamedi (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i ashpër me ta. Ky njeri i dhembshur, i mëshirshëm dhe tolerant urdhëroi vrasjen e tradhtarëve të Beni Kurejdhave, disa qindra njerëz, brenda një dite dhe dëboi Beni El Nadirin dhe Beni Kajnukën, si dhe pushtoi Hajberin, sepse ata ishin armiq të rrezikshëm.

Në fillim, kur hyri në Medine, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u soll me ta me mirësi dhe butësi, por ata u sollën egërsisht

dhe e goditën me thikë pas shpine, komplotuan kundër tij dhe e kërcënuan.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) duroi Abdullah bin Ubejin, duroi barrën e hebrenjve të Medines dhe barrën e kurejshëve, që u strehuan tek ai, ose që nuk përbënin rrezik. Edhe kur pushtoi Mekën, ai u soll me butësi me disa nga paria, përfshirë edhe Ebu Sufjanin. Këtë e bëri, sepse u fashit rreziku i tyre dhe ai e shtypi rëndë këtë armik të pabesë, të rrezikshëm, të cilit nuk mund t'i besohet.¹³¹

Islami na urdhëron për dashuri, mirësjellje, mirësi, të falim edhe armikun, jo vetëm mikun, sepse miku ynë është njëri prej nesh. Nëse ne i duam miqtë, ne nuk bëjmë ndonjë gjë të rëndësishme, por vlera, në këndvështrimin islam dhe moral, shfaqet atëherë kur e duam armikun dhe ne dëshirojmë ta ringjallim këtë vlerë.¹³²

Njohja e armikut është përmbledhja dhe plotësimi i të gjitha diturive. Pa e bërë këtë gjë, zemra dhe mendja e myslimanit do të ishte si një magazinë e pambrojtur nga agresioni i tradhtarëve dhe i sulmuesve. Gjatë

¹³¹ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 12.5.2000 (23.2.1379).

¹³² Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me drejtuesit dhe zyrtarët e kampit të të burgosurve në Irak, më 1.1.1984 (22.10.1362).

pelegrinazhit të Haxhit, vetë hedhja e gurëve është simbol i njohjes së armikut dhe luftimit të tij.

I Dërguari i Islamit e njoftoi gjatë Haxhit *el-beraetu* (Allahu dhe i Dërguari i Tij janë larg idhujtarëve)¹³³. Ishte Prijësi i besimtarëve ai që i recitoi vargjet e *el-beraetu* në ato ceremoni. Nëse, një ditë prej ditësh, për Islamin dhe umetin mysliman do të bëhet e mundur që të shpëtojnë nga ekzistenca e armiqve të egër, atëherë justifikimi për pafajësinë e politeistëve do të pushojë së ekzistuari. Por, për aq kohë sa ekzistojnë armiqtë, me armiqësitë e tyre, shkujdesja dhe indiferenca ndaj pafajësisë është ndër gabimet kryesore.¹³⁴

Veprimet e sakta politike përballë armikut

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i drejtpërdrejtë. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk fliste me fjalë që kishin kuptim të dyfishtë. Sigurisht, kur përballej me armiqtë, ai kryente

¹³³ Sure "Et Teube", ajeti 1: "**Lirim** (i deklaruar) **nga ana e Allahut dhe të Dërguarit të Tij prej çdo detyrimi ndaj idhujtarëve me të cilët kishit bërë marrëveshje**".

¹³⁴ Apeli drejtuar haxhinjve të Shtëpisë së Shenjtë të Zotit, më 1.4.1998 (12.1.1377).

veprime politike në mënyrë të saktë, duke e bërë armikun të bjerë në gabime.

Nga burime të shumta përcillet se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e neglizhonte armikun, as nga pikëpamja ushtarake, as nga pikëpamja politike. Me besimtarët dhe me popullin e tij ai ishte i sinqertë dhe transparent. Fliste qartë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me ta. Ai sillej më ta, më butë se sa duhej, edhe në momente të vështira. Si shembull është rasti i Abdullah bin Ubejit, i cili ka një histori.¹³⁵

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u nis drejt Mekës, me synimin për të kryer umren. Kurejshët e panë që ai po shkonte drejt Mekës në muajin e shenjtë, në të cilin nuk lejohej lufta, sepse e respektonin muajin e shenjtë. Çfarë duhet të bënin dhe si duhet të vepronin ata? A të hapnin rrugën dhe ta linin të vinte? Si do të vepronin ata në rast suksesi? Si mund ta përballonin atë? A kishin për qëllim që të luftonin në muajin e shenjtë? Si do të luftonin? Në fund, ata vendosën dhe thanë: “Do t’i ndalojmë, që të hynë në Mekë. Nëse gjejmë një justifikim (ose një mundësi), do t’i vrasim të gjithë myslimanët”.

I Dërguari i Allahut veproi me një shkallë të lartë zgjuarsie dhe me takt. Ai u ul për të nënshkruar një traktat

¹³⁵ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001 (2.2.1380).

marrëveshjeje me ta, për t'u kthyer në Medine, por, me kusht, që ai të vinte vitin e ardhshëm për të kryer umren, duke hapur kështu të gjithë hapësirën e nevojshme në rajon për të përcjellë mesazhin. Ajo ishte një marrëveshje paqeje. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: **“Ne të dhamë ty një fitore të qartë”**.¹³⁶

Ata që i rishikojnë burimet e sakta historike, do të shohin se sa e mahnitshme ishte historia e Hudejdijes. Vitin pasues, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shkoi për të kryer umren dhe fuqia e atij njeriu të madh po shtohet nga dita në ditë. Një vit më vonë, domethënë në vitin e tetë dhe, kur idhujtarët e thyen besëlidhjen, i Dërguari i Allahut e pushtoi Mekën. Ajo ishte një fitore e madhe, që tregonte fuqinë dhe forcën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

Bazuar në sa thamë më sipër, vërejmë se marrëdhëniet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me armiqtë, u karakterizuan nga planifikimi, zgjuarsia dhe aftësia, me durimin dhe qëndrueshmërinë e tij, pa u tërhequr as edhe një hap të vetëm. Ai përparonte moment pas momenti dhe ditë pas dite.¹³⁷

¹³⁶ Sure “El Fet’h”, ajeti 1.

¹³⁷ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001 (28.2.1380)

KRIJIMI I NJË ATMOSFERE BESNIKËRIE DHE NJOHJA E TË VËRTETËS

Ruajtja e besëlidhjes

Në një hadith kam lexuar se një delegacion erdhi te i Dërguari fisnik në Medine. Ajo ishte një përfaqësi e dërguar nga Nexhashiu, mbreti i Abisinisë, për të dhënë një mesazh. Ishte diçka e zakonshme midis shteteve. Nexhashiu ishte mbreti i Abisinisë. Ishte një nga shumë sulltanët dhe princat e asaj kohe. Ai ishte një i krishterë jomysliman. Në momentin që delegacioni erdhi nga Abisinia, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u ngrit nga vendi i tij për t'i pritur ata. Shokët e tij i thanë: "O i Dërguari i Allahut, na lejo ne të kujdesemi për pritjen, nderimin dhe mikpritjen e tyre". Profeti Muhamed Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) tha se ai donte të kompensonte respektin dhe nderimin që morën myslimanët, kur

emigruan në Abisini. Kjo është një shenjë e njohjes së të vërtetës.

Kjo është arsyeja pse ju vëreni që i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk drejtoi ushtri për në Abisini dhe nuk shkoi në të. Pavarësisht se ai kishte hyrë në shumë luftëra në jetën e tij me idhujtarët kurejsh dhe kishte ndërmarrë disa luftëra me Perandorinë Romake Lindore. Rajoni i Shamit dhe Palestina ishin pjesë e Perandorisë romake në atë kohë. Kjo ishte pikënisja e betejave në Jermuk, Mueta dhe Tebuk. Shkuarja në xhihad dhe hapjen e atyre vendeve për Islamin.

Nuk është e vërtetë që Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) luftonte me çdo mbret që nuk e pranonte besimin islam. Jo, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e ruajti besëlidhjen dhe të vërtetën dhe e falënderoi Nexhashin për miqësinë e tij. Kjo çështje vazhdoi gjatë periudhës së qeverisjes islame, ku i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte në krye të shtetit islam.

Gjatë qeverisjes islame, erdhi një grua në Medine për të takuar Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Shokët e tij ishin dëshmitarë se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut*

qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!), tregoi respekt të veçantë për të. E pyeti për kushtet e saj dhe të familjes së saj dhe e trajtoi atë me respektin dhe mirësinë më të madhe. Pasi ajo u largua, i Dërguari i Allahut shkoi te shokët e tij. Për të shuar kureshtjen e tyre, ai u shpjegoi se kjo grua vinte në shtëpinë e tij në kohën e Hatixhes (ajo ishte periudha e presionit, embargo dhe vështirësive në Mekë).

Ishte një periudhë e vështirë dhe të gjithë shokët e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishin nën embargo dhe presion dhe nuk mund ta vizitonin zonjën Hatixhe, bashkëshorten e të Dërguarit të nderuar. Kjo grua vinte dhe e vizitonte. Transmetimi nuk e përmend, nëse kjo grua ishte bërë myslimane apo jo. Mundet që ajo të mos ishte myslimane, por i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk u kujdes për të vetëm për shkak të kësaj veçorie. Ai tregoi respekt dhe mirësi për shkak të sjelljes së para shumë viteve.¹³⁸

¹³⁸ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989 (28.7.1368).

Promovoni i diturisë

Meka dhe Medina ishin qendrat e Shpalljes dhe vendet e bekimeve hyjnore, që zbrisnin mbi një grup besimtar dhe rezistues, të cilët u fuqizuan nga bekimi i besimit dhe puna e argumenteve hyjnore.

U ngritën nga pluhuri i poshtërimit që kishte rënë mbi ta. Ata morën lirinë që e meriton njeriu, si dhe ngritën flamurin e lirisë për mbarë njerëzimin. E shpëtuan njerëzimin e asaj periudhe nga shtypja dhe sundimi i perandorive të kohës dhe padrejtësisë mbi të cilën ato ishin ngritur. Ata, përmes dritës së dijes, që buron nga Kur'ani, themeluan një qendër madhështore të dijes njerëzore, për ta përhapur në shekuj. Ata ishin bujarë në edukimin e njerëzimit.

Ofruan veprat më të mira shkencore për shekuj me radhë dhe përcaktuan fatin e botës dhe të njerëzimit me njohuritë, politikën dhe kulturën e tyre. E gjithë kjo është nga bekimet e mësimave të Islamit dhe qeverisjes së pastër islame në periudhën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), si dhe gjatë periudhës së ditëve të para të Islamit, kur myslimanët vazhduan të shijonin frytet e saj. Kjo ndodhi, pavarësisht

mbizotërimit dhe rritjes së pemës së keqe të qeverive sunduese dhe braktisjes së periudhës monoteiste.¹³⁹

Krijimi i një atmosfere për të punuar dhe për të vepruar në shoqëri

Duhet ta përmendim dhe ta përkujtojmë të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), edhe në ditët që i kushtohen mësimi, arsimit, prodhimit dhe punës, sepse ai njeri i madh ishte mësuesi i qenieve njerëzore dhe flamurtari i arsimit, i edukimit, i respektit për punën dhe përpjekjet në shoqëri.¹⁴⁰

Kujdesi dhe vëmendja ndaj gjërave materiale, për të arritur në ato shpirtërore

Qëllimi më i lartë i njeriut nuk është të mbushë stomakun e tij me ushqim. Ai është qëllimi më i ulët dhe çdo kafshë mund ta zgjedhë si qëllim. Qëllimi më i lartë i njeriut është të arrijë të njohë të vërtetën. Qëllimi i tij është të afrohet me Allahun e Madhëruar dhe të pajiset me

¹³⁹ Apeli për pelegrinët e Haxhit, më 16.6.1991 (26.3.1370).

¹⁴⁰ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në takimin me mësuesit dhe punëtorët, më 30.4.2003 (10.2.1382).

moralin hyjnor. Për të arritur qëllime të tilla, njeriu duhet të pajiset me një sërë mjetesh materiale dhe morale. Ai ka nevojë për ushqim, që të jetë në gjendje të lëvizë drejt qëllimit. Një jetë e rehatshme është e nevojshme dhe e domosdoshme për njeriun. Islami, përmes ligjeve dhe rregulloreve të tij, i udhëheq njerëzit drejt mirëqenies dhe një jete të rehatshme, por kjo jetë e rehatshme nuk është një qëllim në vetvete.¹⁴¹

Përhapja e një atmosfere vëllazërimi dhe bashkëpunimi

Ndër veprimet e para që i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) veproi gjatë muajve të parë të hyrjes së tij në Medine, ishte vëllazërimi ndërmjet myslimanëve, domethënë, ai realizoi vëllazërimin midis myslimanëve. Kur themi se jemi vëllezër, ky nuk është një kompliment. Në fakt, myslimanët gëzojnë të drejtën e vëllazërisë mes tyre. Ata e kërkojnë njëri-tjetrin ashtu si vëllezërit i detyrohen njëri-tjetrit, si dhe duhet të respektojnë të drejtat e tyre

¹⁴¹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në mbledhjen me vizitorët në Xhaminë Redauj, më 18.4.1991 (29.1.1370).

reciprokisht. Pikërisht, kjo është ajo që bëri i Dërguari i Allahut në praktikë.¹⁴²

Ndërthurja dhe gërshetimi i jetës së njerëzve me vlerat islame

I Dërguari i Islamit e ndërthuri mjedisin jetësor me vlerat islame. Në këtë mënyrë, vlerat dhe morali islam të ishin të mishëruara plotësisht në shoqëri, dhe të përziera me shpirtin, besimin dhe jetën e njerëzve.¹⁴³

¹⁴² Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989 (28.7.1368).

¹⁴³ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989 (28.7.1368).

MJEDISI QË TË RRETHON, DUHET TË JETË I SHËNDETSHËM

Shfaqja e optimizmit dhe largimi i pesimizmit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) gjithmonë i këshillonte njerëzit: “Asnjëri prej jush nuk duhet të më informojë për (ndonjërin) nga shokët e mi, sepse unë dëshiroj t’ju takoj me zemër të hapur”.¹⁴⁴ Kjo do të thotë, të takohesh me myslimanët me zemër të pastër dhe pa ndonjë keqardhje. Këto janë fjalët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që i këshillonte myslimanët. Shihni me vëmendje se si kjo sjellje e ndihmoi të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) t’i bëjë myslimanët të ndiejnë nevojën për të ndërvepruar me shoqërinë dhe mjedisin islam pa dyshime. Për më tepër, domosdoshmërinë e marrëdhënieve me optimizëm.

Në disa transmetime përcillet se, kur qeverisja është me të keqen dhe korrupsionin, duhet të mendosh keq për

¹⁴⁴ El Al’lametu el Mexhlisij, “Biharul Anuar”, vëll. 16, f. 230.

gjithçka, por, kur qeverisja është e mirë dhe e drejtë në shoqëri, duhet të largohesh nga dyshimet e këqija dhe paragjykimet. Duhet të mendojmë mirë për njëri-tjetrin, të dëgjojmë fjalët e njëri-tjetrit dhe t'i pranojmë ato, të anashkalojmë gabimet e njëri-tjetrit, të drejtohem i dhe të shohim gjërat e bukura.

Ishte zakoni i myslimanëve që të vinin tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe t'i pëshpëritnin në vesh. Ata bisedonin me të ndonjë bisedë të fshehtë. Zbriti ajeti fisnik, që e ndalonte pëshpëritjen në veshin e tij, sepse kjo do të çonte në krijimin e mosbesimit në mesin e myslimanëve të tjerë.¹⁴⁵

Përballja me përhapjen e thashethemeve

Incidenti i shpifjes (el-ifk) është një ngjarje shumë e rëndësishme, për të cilin unë kam menduar vazhdimisht dhe i jam referuar ajeteve kur'anore që lidhen me të, pasi ka një numër ajetesh që shpjegojnë ngjarjen në suren "En Nur". Përmbledhja e incidentit të shpifjes (el-ifk) është: Njëra nga gratë e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), të cilën Profeti e kishte

¹⁴⁵ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 14.10.1989 (22.7.1368).

marrë me vete në një prej betejave, mbeti prapa kolonës dhe, kur u kthye, Profeti e inspektoi atë dhe nuk e gjeti. Ajo mbeti prapa për arsye të caktuara: ose sepse e kishte kapluar përgjumja, ose sepse kishte shkuar për të kryer nevojat personale. Myslimanët u mblodhën dhe zbuluan se gruaja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk ishte në mesin e tyre. Një mysliman kishte ardhur dhe e kishte shoqëruar gruan e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në Medine.

Çështja nuk është thjesht se ajo është gruaja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe duhet të respektohet, por çështja, në ajetet kur'anore, është diçka tjetër. Ajetet e sures "En Nur" e bënë të qartë dhe treguan ndjeshmëri ekstreme në lidhje me çështjen e shpifjes. Ajo ishte një shpifje që u shfaq nga hipokritët, njerëzit e korruptuar dhe njerëzit e sëmurë në shoqëri.

Një sërë ajetesh të njëpasnjëshme erdhën me një ton të mprehtë, drejtuar myslimanëve, duke i fajësuar dhe duke i kritikuar ata, se pse nuk u përballën ashpër me autorin e thashethemeve, kur i dëgjuan shpifjet dhe nuk iu përgjigjën kategorikisht atij. Ky është mësimi që del nga vargjet kur'anore.

Fjalja në këtë ajet fillon me frazën “*leu la*” dhe përsëritet në dy vende. Letrarët e letërsisë arabe thonë se paralajmërimi “*leu la*” përdoret, kur një person dëshiron t’i drejtohet adresuesit në ankth dhe qortim të plotë dhe t’i thotë: Pse nuk e bërë këtë veprim?

“Kur e dëgjuat këtë përgojim, përse besimtarët dhe besimtare nuk menduan mirë për njëri-tjetrin dhe të thoshin: ‘Kjo është shpifje e qartë’”?!”¹⁴⁶

Në një tjetër vend, Allahu i Madhëruar thotë: **“Përse kur e dëgjuat përgojimin, nuk thatë: ‘Nuk ka hije për ne të flasim për këtë. Ti qofsh lavdëruar (o Zot)! Kjo është shpifje e madhe!’”¹⁴⁷**

Unë besoj se ky incident i madh në historinë e Islamit dhe në kohën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) çoi në çrrënjosjen e plotë të rrënjëve të thashethemeve në çështjet personale të anëtarëve të bashkësisë islame. Thashethemet i çonin në mosbesim myslimanët dhe e bënë mjedisin të pashëndetshëm.

¹⁴⁶ Sure “En Nur”, ajeti 12.

¹⁴⁷ Sure “En Nur”, ajeti 16.

Largimi i urrejtjes, smirës dhe armiqësisë

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk donte të njollosej jeta e bashkësisë islame, qoftë edhe me pak urrejtje dhe armiqësi. Ai punonte shumë për të krijuar dashuri dhe miqësi mes njerëzve. Arriti deri në atë masë sa i fali banorët e Mekës, kur u zgjerua rrethi i Islamit dhe mori kontrollin e këtij qyteti.

Banorët e Mekës ishin ata njerëz që e dëbuan të Dërguarin të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nga qyteti i tyre. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i kishte duruar për trembëdhjetë vjet dëmet dhe dhimbjet e tyre. Ai kishte bërë disa luftëra me ta, ku u vranë shumë myslimanë. Gjithashtu, edhe myslimanët kishin vranë shumë prej tyre. Këta njerëz e pritën ushtrinë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me luftë dhe dukej e pamundur që për shumë vite të vendosej paqja me ta. Por sapo Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) hyri në Mekë¹⁴⁸, ai deklaroi publikisht: “Ju

¹⁴⁸ Duket se kuptimi i fjalëve të udhëheqësit kanë për qëllim: Nëse ata do të përballeshin me ushtrinë çlirimtare të Profetit Muhamed, dhe Profeti nuk do t'i falta ata, nuk do ndodhte paqja, nuk do ndalej gjakderdhja dhe luftërat dhe rebelimet do të kishin vazhduar.

jeni të lirë!”¹⁴⁹, domethënë, ju kam falur të gjithëve. Ai i fali të gjithë kurejshët dhe çështja u mbyll.¹⁵⁰

Krijimi i një atmosfere dashurie

Ndër veprat e rëndësishme të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ishte krijimi i një atmosfere bashkëpunimi, solidariteti, simpatie dhe dashurie reciproke mes myslimanëve. Për aq kohë sa i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i pranishëm në shoqërinë islame, ai bëri të gjitha përpjekjet që kjo atmosferë të ekzistonte. Myslmanëve nuk u lejohet të mbajnë urrejtje, keqdashje dhe armiqësi ndaj askujt. Me të vërtetë, përmes mençurisë dhe urtësisë së tij, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) arriti të krijonte një atmosferë të ëmbël dhe paqësore dhe një mjedis plot dashuri.

Ndër veprimet e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishin se ai e bëri mjedisin e shoqërisë islame të mbushur me dashuri dhe butësi, në mënyrë që të gjithë individët e kësaj

¹⁴⁹ El Al'lametu El Mexhlisij, “Biharul Anuar”, vëll. 97, f. 59.

¹⁵⁰ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989 (7.28.1368).

bashkësie ta duan njëri-tjetrin dhe ta shikojnë njëri-tjetrin me mirëbesim.¹⁵¹

Kur'ani Famëlartë shprehet për sahabët e të Dërguarit: **“Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre”**.¹⁵²

Këta janë të ashpër kundër jobesimtarëve, domethënë kundër armiqve që rreshtohen në luftë. Nuk kishin për qëllim hebrenjtë, ose të krishterët që jetonin në Medine, nën hijen e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Në atë kohë, shumë të krishterë dhe hebrenj jetonin në Medine.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe shokët e tij kishin marrëdhënie të mira me ta. Kur'ani nuk i nënkuptonte ata me frazën **“të ashpër ndaj jobesimtarëve”**. Përkundrazi, ai i quajti **“të ashpër ndaj jobesimtarëve”** ata jobesimtarë, të ngjashëm me kurejshët, të cilët bënë vazhdimisht lëvizje ushtarake kundër Islamit dhe qytetit islam, ose të ngjashmit me hebrenjtë e Benu Kurejdhes, ose si Hajberi dhe pjesa tjetër e rajoneve që nuk po i përmbushnin premtimet e tyre. Ata lëviznin në të gjitha drejtimet për të mbledhur dhe për të përgatitur ushtri kundër Islamit. Ishin aktivë dhe përhapnin thashetheme. Në dukje, ata shprehnin

¹⁵¹ I njëjti burim.

¹⁵² Sure “El Fet’h”, ajeti 29.

simpatinë ndaj myslimanëve. Në zemrat e tyre fshihnin mosbesimin. Jetonin brenda qytetit në Medine dhe mbanin marrëdhënie të vazhdueshme me jobesimtarët e shkallës së parë ose të dytë.

“Të ashpër ndaj jobesimtarëve”, domethënë, të ashpër kundër këtyre tri grupeve, por se ata janë **“të mëshirshëm me njëri-tjetrit”**. Kjo është rruga islame. Në këtë mënyrë, armiqtë nuk do të jenë në gjendje të ndikojnë në asnjë mënyrë kundër këtyre burrave të fortë. Çfarë do të thotë të ashpër? Do të thotë qëndrueshmëri absolute. Kur’ani thotë për hekurin: **“Ka fuqi të madhe në të”**.¹⁵³

Ajo që nënkuptohet këtu me fjalën **“të ashpër”**, nuk do të thotë padrejtësi, si dhe nuk ka për qëllim të derdhë gjak. Por ajo që nënkuptohet, është bashkimi. Kjo do të thotë se kjo ashpërsi nuk duhet të zbutet dhe kjo bashkësi nuk duhet të tronditet.¹⁵⁴

¹⁵³ Sure “El Hadid”, ajeti 25: **“Ne zbritëm hekurin në të cilin ka forcë dhe përfitime të mëdha për njerëzit”**.

¹⁵⁴ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një tubim të Gardës Revolucionare dhe studentëve, më 11.11.2000 (11.8.1379).

Luftimi i indiferencës

Myslimanët duhet të sillen me njëri-tjetrin me mirësi dhe butësi dhe pa indiferencën më të vogël. Nëse shihni një mysliman të sprovuar, nuk duhet të silleni me të me indiferentizëm. Ndër detyrat e rëndësishme të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte krijimi i bashkëpunimit, i mbështetjes reciproke dhe i dashurisë mes myslimanëve.¹⁵⁵

Luftimi i besëtytnive të injorancës

Çdokush, në një moment të caktuar, mund të urdhërojë, ose të rekomandojë njerëzit, që të kenë sjellje të mira, të sillen me tolerancë, durim dhe drejtësi për të fituar kënaqësinë e Allahut, të mos bëjnë padrejtësi dhe të bëjnë përpjekje për vendosjen e drejtësisë. Çështja që shtrohet këtu, është urdhërimi në të mirë, këshillimi dhe edukimi. Ato janë çështje të domosdoshme. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) edukonte njerëzit dhe u jepte mësimë mbi dijen dhe jetën. Por, çështja ndonjëherë mund të jetë më e madhe se arsimi. Do të thotë që mësuesi të veprojë dhe të adoptojë një sjellje që do ta bënte moral dhe përgjegjësi të qëndrueshme

¹⁵⁵ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989 (7.28.1368).

islame. Ajo sjellje do të përballej me besimet e gabuara të njerëzve dhe do të luftonte emocionet e injorancës dhe besëtytnitë e moralit joislam. Ajo krijon një tronditje në shoqëri dhe te njerëzit, sepse vepron në kohën e duhur dhe me metodat e duhura. Kjo çon në përzierjen e plotë të atmosferës së shoqërisë dhe mjedisit të jetesës së njerëzve, në përputhje me moralin dhe sjelljen e mirë.¹⁵⁶

1 butë me besimtarët dhe i ashpër me jobesimtarët

Islami flet për sjelljen dhe moralin individual të të Dërguarit të Allahut dhe thotë: **“Në saje të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje”**.¹⁵⁷

Allahu i Madhëruar e lavdëron të Dërguarin për butësinë e tij dhe për mënyrën se si i trajton njerëzit, duke i thënë atij se ti nuk je i ashpër dhe i egër. Në një tjetër ajet, Kur’ani Fisnik e përmend Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), duke thënë: **“O i Dërguar! Lufto kundër mohuesve dhe hipokritëve dhe bëhu i ashpër ndaj tyre!”**¹⁵⁸

¹⁵⁶ I njëjti burim.

¹⁵⁷ Sure “Ali Imran”, ajeti 159.

¹⁵⁸ Sure “Et Teube”, ajeti 73.

Fjala “el guldhu” në ajetin e mëparshëm, është e pranishme edhe në këtë ajet. Në ajetin e mëparshëm, ajo ka të bëjë me besimtarët, ndërsa në këtë ajet ajo flet për marrëdhënien dhe sjelljen individuale. Ky ajet, ka të bëjë me zbatimin e ligjit, menaxhimin e shoqërisë dhe krijimin e sistemeve. Vrazhdësia atje është e shëmtuar, ndërsa këtu është e mirë; ashpërsia atje është e shëmtuar, ndërsa këtu e është mirë.¹⁵⁹

Marrëdhënia me të huajt

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në Hudejbije nënshkroi një traktat paqeje me jobesimtarët kurejsh. Gjithashtu, ai kishte nënshkruar traktate paqeje afatgjata me jobesimtarët e tjerë, d.m.th. ai nuk kishte ndonjë motiv armiqësor me ta. Kjo çështje është e qartë, pasi edhe Kur’ani Fisnik ka folur për të: **“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët”**.¹⁶⁰

¹⁵⁹ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 14.4.2000 (26.01.1379).

¹⁶⁰ Sure “El Mumteherine”, ajeti 8.

Ju mund të krijoni marrëdhënie të mira me jobesimtarët që nuk armiqësohen me ju, si dhe me ata që nuk janë sjellë keq me ju, nuk ju kanë bërë padrejtësi dhe nuk ju kanë dëbuar nga vendbanimet tuaja.¹⁶¹

Kujdesi për të rinjtë

Vizioni i Islamit për të rinjtë korrespondon pikërisht me çështjet që konsiderohen sot pjesë e propozimeve dhe dëshirave tona për brezin e ri dhe për të rinjtë.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i këshillonte të rinjtë. Bisedonte dhe qëndronte me ta. E përdori energjinë e brendshme të rinisë për vepra të mëdha. Mos e shihni Prijësin e besimtarëve si një personalitet në periudhën dyzet, pesëdhjetë a gjashtëdhjetëvjeçare të jetës së tij. Përkundrazi, ai është një personalitet shkëlqyes dhe rrezatues që në rininë e tij. Ai përfaqëson një model të pavdekshëm, që të rinjtë duhet ta imitojnë dhe ta pasojnë. Gjatë dhjetë viteve e disa muajve të qeverisjes së tij, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) përfitoi nga

¹⁶¹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë, më 29.1.1990 (9.11.1368).

elementi “rini” deri në nivelet më të larta dhe jo vetëm nga personaliteti i Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*).¹⁶²

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i besoi një përgjegjësi të madhe një të riu tetëmbëdhjetëvjeçar, në një nga momentet më delikate të jetës së tij. Gjatë betejave, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e merrte vetë komandën. Por në javët e fundit të jetës së tij, i Dërguari e ndiente se ishte gati të largohej nga kjo botë dhe nuk mund ta udhëhiqte ushtrinë në luftë me Perandorinë Romake. Ajo ishte një detyrë e vështirë dhe e madhe. Duhet të zgjidhte një udhëheqës, vendosmëria e të cilit nuk do të dekurajohej nga pengesat e ndryshme.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ia besoi përgjegjësinë e drejtimit të ushtrisë një të riu tetëmbëdhjetëvjeçar. Me kënaqësi, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mund t’ia jepte këtë përgjegjësi njërit prej shokëve, që ishte në moshën pesëdhjetë apo gjashtëdhjetëvjeçare dhe që kishin përvojë në luftëra dhe në front. Përkundrazi, ai zgjodhi një djalë të ri tetëmbëdhjetë vjeç, emri i të cilit ishte Usama bin Zeid.

¹⁶² Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim të të rinjve, më 10.5.2000 (1.2.1379).

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e përzgjodhi atë për besimin e tij dhe të qenit bir i një dëshmori. Ai e dërgoi Usamën në një vend ku ishte dërguar babai i tij, Zeid bin Haritha, dy vjet më parë, kur edhe u martirizua atje. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ia besoi udhëheqjen e një ushtrie të madhe një të riu tetëmbëdhjetëvjeçar. Kjo ushtri përfshinte sahabë të mëdhenj, të vjetër në moshë dhe udhëheqës me përvojë.

I Dërguari i Allahut i tha: “Unë do të të dërgoj në vendin ku ra dëshmor babai yt, në Muetah”. Ajo ishte një zonë e lidhur me Perandorinë Romake në atë kohë dhe sot ndodhet në Sham. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u dha leje dhe i urdhëroi të luftonin. Në këndvështrimin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), energjia e të rinjve ishte e rëndësishme dhe duhet përfituar prej saj.¹⁶³

Këshillimi në marrjen e vendimeve

Krijimi i këshillave legjislativë, në formën e tanishme, në vendet islame ka qenë i përhapur gjatë shekullit të kaluar. Në të vërtetë, Islami është nismëtari

¹⁶³ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 8.5.1998 (18.2.1377).

dhe pionieri në krijimin e qeverive popullore, të bazuara në konsultime brenda kuadrit të Shpalljes dhe ligjit hyjnor. I Dërguari i nderuar i Islamit ishte ai që e zbatoi urdhrin hyjnor: **“dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme”**.¹⁶⁴

Ai konsultohet për detyrat qeveritare në Islam dhe, në disa raste, veproj sipas mendimit të shokëve të tij. Mund të thuhet me saktësi se kjo çështje është një nga sekretet e përparimit të shpejtë dhe unik të myslimanëve në fillim të historisë së Islamit.¹⁶⁵

¹⁶⁴ Sure “Ali Imran”, ajeti 159.

¹⁶⁵ Nga apeli i Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në Konferencën e Këshillave Islamike, më 15.6.1999 (25.3.1378).

MËSIMET PROFETIKE

Mësimi i dijes

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) krijoi një sistem, linjat bazë të cilit përfshinin disa çështje. Midis këtyre linjave bazë, gjenden katër pika themelore të cilat janë: transparenca, të njohësh fenë, të njohësh rregullat, të njohësh shoqërinë, të njohësh detyrat, të njohësh Zotin, të njohësh të Dërguarit, të njohësh natyrën. Këto njohuri dhe mësimet bënë të mundur që bashkësia islame, në fund të shekullit të katërt hixhri, të arrijë në kulmin e qytetërimit dhe të shkencës. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk lejonte paqartësi. Çuditërisht, sa herë që kishte paqartësi, zbrisnin ajetet kur'anore, të cilat e shtjellonin dhe e qartësonin atë.¹⁶⁶

¹⁶⁶ Kur kthehej në shtëpi, ai e ndante kohën e tij në tri pjesë: një pjesë për Allahun e Madhëruar, një pjesë për familjen e tij dhe një pjesë për veten e tij. Pastaj ai e ndante pjesën e tij midis vetes dhe njerëzve. Në këtë mënyrë, ai i përgjigjej masës së njerëzve, në përgjithësi dhe

Mësimi i sjelljes dhe trajtimi i familjes

Rrallë mund të shihni shembuj të individëve të tillë në mesin e njerëzve, që të zotërojnë emocione të tilla në lidhje me jetën familjare. Duke qenë baba, ky njeri i madh, luftëtar, sakrifikues në fushat e betejës, njëkohësisht ishte edhe një person i butë, i dhembshur dhe i mëshirshëm. Ju keni dëgjuar se si Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) sillej me dy nipërit e tij. Gjithashtu, kjo ishte edhe mënyra se si ai sillej me fëmijët e tjerë, madje edhe me fëmijët e huaj.

individëve në veçanti, duke mos kursyer asgjë nga vetja e tij. Në pjesën që i përkiste umetit, ai preferoi njerëzit që kishin merita dhe i ndau ata sipas meritës së tyre në fe. Prej tyre, disa kishin një nevojë, disa kishin dy nevoja dhe të tjerë kishin më shumë nevoja dhe ai shqetësohej me ta. Pra, ai shqetësohej për ta dhe për të mirën e umetit. (Shejkh Et-Tabrisi, “Mekarimul Ahlak”, f. 13.)

* Ai i rregullonte vetë sandalet, i arnonte rrobat, e hapte derën, e milte delen, e milte devenë, bluante me shërbëtorin... (El Alametu el Mexhlisi, “Biharul Anuar”, vëll. 16, f. 227.)

* I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i hante të gjitha llojet e ushqimit. Ai hante atë që Allahu e kishte bërë hallall dhe kishte lejuar. Hante me familjen e tij, me shërbëtorët e tij. Hante me këdo që e ftonte, nga myslimanët. Ulej në tokë dhe hante prej asaj që ata hanin. Kur i vinin mysafirë, ai hante me mysafirin e tij... (Shejkh el Tabrisi, “Mekarimul Ahlak”, f. 26.)

Po japim një shembull: Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) po ecte drejt xhamisë, ndërsa fëmijët po luanin në rrugë. Njëri nga fëmijët iu drejtua: “O i Dërguari i Allahut, ti merr Hasanin dhe Hysenin mbi supet e tua, prandaj na merr edhe neve ashtu”.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk e kishte problem, kështu që ai ngriti një fëmijë në njërën shpatull dhe tjetrin mbi shpatullën tjetër. Pasi eci pak, i uli ata dhe kërkoi dy fëmijë të tjerë, që të ngjiteshin mbi supet e tij. Ai dëshironte t’i merrte të gjithë fëmijët mbi supet e tij, ndërkohë që koha e namazit po afrohej. Disa nga shokët e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që po kalonin aty pranë për në xhami, e panë të Dërguarin që po mbante fëmijët. Ata i qortuan fëmijët dhe i ulën nga supet e tij, kurse i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vazhdoi rrugën për në xhami. Ky ishte një shembull i sjelljes së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me fëmijët.

Në familjen e tij, ai shprehte dashurinë dhe dhembshurinë si baba. Nuk është e vërtetë se, nëse jemi luftëtarë të xhihadit, punëtorë që kërkojmë riskun, luftojmë në fushën e luftës, përballojmë fatkeqësi, ne duhet të largohemi nga pasioni, dashuria, butësia dhe shfaqjet

natyrore njerëzore te njeriu. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), në shtëpi manifestonte pasionin, dashurinë dhe ndjenjat. Kam lexuar në një transmetim se, kur iu shpall ajeti: **“Mos ia drejtoni thirrjen të Dërguarit, njësoj si thirrjen që ia bëni njëritjetrit”**¹⁶⁷, ata filluan ta thërrasin atë “O i Dërguari i Allahut” dhe nuk e thërrisnin me emrin e tij.

I Dërguari i Allahut hyri në shtëpi. Sapo e pa atë Fatime El Zehraja (*Paqja qoftë mbi të!*), i tha: “O i Dërguari i Allahut! Ajo, gjithashtu, po e thërriste të Dërguarin me fjalët: ‘O i Dërguari i Allahut!’”

I Dërguari i Allahut, e përqafoi vajzën e tij, e përkëdheli atë dhe i tha: “O bija ime, më thirr ‘o babai im’ dhe mos thuaj ‘o i Dërguari i Allahut’! Kjo është më e ëmbël për mua”.

Kur donte të udhëtonte, personi i fundit që takonte, ishte Fatime El Zehraja. Kur kthehej, njeriu i parë që vizitonte, ishte Fatime El Zehraja.

Edhe pse kishte atë dashuri të madhe për vajzën e tij, Fatime El Zehranë, ai thoshte se, nëse do të dëgjonte se ajo kishte marrë diçka nga Bejtu el Mali (Shtëpia e thesarit) dhe ta kishte sjellë atë në shtëpinë e saj, ai do ta ndëshkonte ashtu siç ndëshkonte të tjerët.

¹⁶⁷ Sure “En Nur”, ajeti 63.

“Unë nuk do të të bëj asnjë lëshim ty para Allahut!”¹⁶⁸
Megjithëse ia shprehte gjithë dashurinë e madhe vajzës së tij, ai ishte i gatshëm të përballej me të, nëse ajo kundërshtonte drejtësinë me ndonjë sjellje të pahijshme, ose nëse ajo e tejkalonte ndonjë të drejtë.¹⁶⁹

Marrëdhënia e tij me njerëzit

Kur ne themi se jemi vëllezër, kjo nuk është thjesht një mirësjellje në Islam. Ajo do të thotë se myslimanët, me të vërtetë, kanë të drejtën e vëllazërisë mes tyre dhe ata e mbështesin njëri-tjetrin. Ashtu si vëllezërit i detyrohen njëri-tjetrit dhe ata duhet të respektojnë të drejtat e ndërsjella mes tyre. Kjo është ajo që bëri Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe e praktikoi në të vërtetë.¹⁷⁰

¹⁶⁸ “Sahih Muslim” i autorit Muslim El Nisaburi, Ebu El Hasan Muslim bin El Haxhaxh, Dar El Fikr, vëll. 1, f. 133, Bejrut-Liban.

¹⁶⁹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në qendrën “Teuhid”, më 1.11.1986 (10.8.1365).

¹⁷⁰ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989 (28.7.1368).

Sjellja e zyrtarëve me njerëzit

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) bëri atë që është më e vështira nga të gjitha. Ai pa një person që ishte i lodhur nga gërmimi i hendekut (gjatë betejës së Hendekut). Në të dukeshin qartë shenjat e lodhjes dhe ai nuk mund të vazhdonte më tej. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) shkoi dhe e mori përsipër punën e tij dhe filloi të punonte në vend të tij, domethënë, ai nuk mjaftohej vetëm duke lëshuar urdhra, por ishte i pranishëm dhe punonte vetë në mesin e turmës.¹⁷¹

Administrata e tij shoqërore dhe ushtarake ishte në nivelin e saj më të lartë dhe ai ndiqte gjithçka. Sigurisht, ai ishte një komunitet i vogël, qyteti dhe periferitë e tij. Më pas, kësaj administrate iu shtua Meka dhe një ose dy qytete të tjera. Por ai shqetësohej për çështjet e njerëzve dhe ishte i organizuar dhe i rregullt. Në atë shoqëri beduine, ai kryente administrimin, menaxhimin, kontabilitetin, i motivonte dhe i këshillonte njerëzit.

Kjo ishte jeta shoqërore e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), që

¹⁷¹ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001 (2.2.1380).

ne të gjithë duhet ta imitojmë dhe ta ndjekim shembullin e tij, zyrtarët e vendit dhe njerëzit e thjeshtë.¹⁷²

Mundohuni dhe përpiquni sa më shumë, që ta bëni administratën tuaj administratë islame, që do të thotë etikë njerëzore, duke i bashkangjitur edhe aftësinë administrative. A e keni parë ajetin kur'anor që thotë: **“Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai”**?¹⁷³

Allahu i Madhëruar i kërkon të Dërguarit të Tij që t'u kushtojë vëmendje këtyre njerëzve dhe të kujdeset për ta. Pas luftës së Uhudit, ata ndienin disfatë dhe dhimbje. Ai u këshillua me ta dhe i trajtoi ata me mirësi, por: **“Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu”**.¹⁷⁴

Menaxhimi ka të bëjë me: moralin e mirë, rregullin, fuqinë administrative, si dhe besimin dhe mbështetjen tek Allahu i Madhëruar, në të gjitha rastet dhe kërkimin e të mirës nga Krijuesi i botës dhe mbështetjen tek Ai.¹⁷⁵

¹⁷² I njëjti burim.

¹⁷³ Sure “Ali Imran”, ajeti 159.

¹⁷⁴ I njëjti burim.

¹⁷⁵ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me komandantët e forcës detare, në Gardë, më 25.4.1998 (5.2.1377).

Marrëdhënia me mësuesit dhe studentët

Ju vëreni interesin e madh që kultura dhe mësimet islame i kanë kushtuar mësuesit, si dhe përlësia dhe modestia e nxënësit para tij. Kjo është një domosdoshmëri. Është e ditur se Islami nuk pranon që asnjë person ta konsiderojë veten të vogël dhe të përlur para një qenie tjetër njerëzore, por kjo çështje që po prekim këtu, është një nga rastet e jashtëzakonshme.

Është për të ardhur keq, se në kulturën e botës materialiste ndodh e kundërta. Ajo nuk e sheh fare këtë çështje, domethënë, kultura që ne kemi huazuar nga evropianët, nuk ka respekt për mësuesin. Ne nuk themi se ata shkruajnë në librat e tyre, se nuk duhet të respektohet mësuesi, por, nuk vërejmë në kulturën perëndimore zakonet e respektimit dhe të edukatës ndaj një mësuesi.¹⁷⁶

¹⁷⁶ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me ministrin e Arsimit dhe mësuesit model, më 2.5.1991 (12.2.1370).

Trajtimi i të gjithëve me dashuri

Përpiquni dhe mundohuni t'i doni të gjithë. Kjo është një detyrë dhe mësim islam. Kjo nuk është diçka e keqe apo e gabuar, që një person duhet të largojë një person tjetër nga lista e tij e dashurisë, me disa justifikime, si p.sh. arsyetimi me armiqësinë. Këto nuk duhet të ekzistojnë! Atmosfera e shoqërisë islame është atmosfera e dashurisë, edhe nëse nuk e njihni personin tjetër.¹⁷⁷

Marrëdhënia me besimet e gabuara dhe kufizimet shoqërore

Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill. Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat; do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.”**¹⁷⁸

¹⁷⁷ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989 (7.28.1368).

¹⁷⁸ Sure “El Araf”, ajeti 157.

Allahu i Madhëruar e obligoi heqjen e skllavërisë dhe prangave nga qafat e qenieve njerëzore, si një nga veçoritë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Ajo nënkupton vendosjen e detyrimeve ndaj njeriut. Ky është një koncept shumë i gjerë dhe mahnitës. Nëse marrim parasysh situatën e shoqërisë fetare dhe jo fetare në atë periudhë, do të vërejmë se detyrimet e vendosura ndaj njeriut përfshinin shumë besime të rreme dhe paragjyquese, si dhe shumë kufizime të gabuara shoqërore, të vendosura ndaj njerëzve, që ishin në dorë të tiranëve. Ndërsa “prangat” janë të qarta, që janë zinxhirët.¹⁷⁹

¹⁷⁹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në mbledhjen e studentëve të universitetit, ku unë u rrita si mësues, më 3.9.1998 (12.6.1377).

LEKSIONE LUFTE

Objektivat dhe motivet

Të gjitha luftërat dhe betejat e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishin luftëra mbrojtëse. Kjo nuk do të thotë se në të gjitha betejat ai qëndronte ulur dhe priste që ata të vinin dhe ta sulmonin. Jo, mbrojtja, në këtë kuptim, nuk është e saktë. Nëse i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk do të ishte armatosur, nëse nuk do të ishte përgatitur, nisur edhe nga ajeti kur'anor: **“Përgatitni kundër tyre kuaj dhe forcë për luftë sa të mundni”**¹⁸⁰, atëherë lufta do të kishte përfunduar që në ditët e para. Ata do ta kishin zhdukur Islamin, Kur'anin, të Dërguarin, si dhe bashkësinë islame. Ky ishte edhe shkaku që i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i detyruar të luftonte.¹⁸¹

¹⁸⁰ Sure “El Enfal”, ajeti 60.

¹⁸¹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në kampin e Imam Hysenit (*Paqja qoftë mbi të!*), më 19.6.1984 (30.3.1363).

Rregullat që duhet të kihen parasysh në luftë

Ndër këshillat dhe urdhërimet e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në fushën e betejës, për njerëzit që po shkonin në luftë, përmendim: mëshira ndaj grave dhe fëmijëve, madhështia në marrëdhëniet me ushtarët e armikut, mosndërprerjen e ujit, të mos i pengonin nga ushqimi, të pranonin dorëzimin e tyre, të afronin ata që pranonin Islamin, edhe nëse çështja ishte në mes të betejës, të qëndronin plotësisht larg hakmarrjes dhe vrazhdësisë.

Jobesimtarët që nuk ishin në armiqësi me të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) vinin tek ai. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte i

* Gazeta “El Imam”, vëll.10, f. 106: “Nëse shikojmë periudhën e të Dërguarit të Allahut(*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe kalifatin e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), ne zbulojmë se shumë luftëra u zhvilluan. Të gjitha këto ndikuan në edukimin dhe përsosjen e shoqërisë. I Dërguari i Islamit(*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) luftoi luftëra të shumta dhe humbi disa prej tyre, por parimete tij nuk u mposhtën”.

sjellshëm dhe i mëshirshëm me ta deri në atë gradë sa ata turpëroheshin prej tij.¹⁸²

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte udhëheqës ushtarak. Në të kaluarën, rregulli ushtarak kërkonte që komandanti të

¹⁸² I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) i dërgonte ekspeditat në fillim të ditës. Transmetohet në “El Kafi”, me zinxhirin e transmetimit nga El Sekuni, nga Ebu Abdullahu, se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dërgoi një ekspeditë. Ai e thirri atë. Ndërsa në Kurb, me transmetim nga Rejan bin el Sulti lexojmë: “E kam dëgjuar El Ridhan se ka thënë: ‘Sa herë që i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dërgonte një ushtri, caktonte komandat të saj dhe e kishte zakon që e mbante të fshehtë”.

Në “El kafi” me transmetim nga Mesudetu bin Sadaka, nga Ebu Abdullah (*Paqja qoftë mbi ta*) lexojmë: “Nëse Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dërgonte ekspedita, caktonte për të një komandant dhe e këshillonte që të kishte frikë Allahun e Madhërishëm, për vetën e tij në veçanti dhe pastaj për shokët e tij në përgjithësi. Më pas u thoshte: ‘Luftojini jobesimtarët në emër të Zotit dhe për hir të Zotit dhe mos bëni tradhti, mos e teproni, mos i gjymtoni, mos vrisni një të porsalindur, mos i vrisni të moshuarit, mos digjni palma, mos i mbytni me ujë, mos e prisni një pemë frytdhënëse, mos i digjni të lashtat, sepse ju nuk e dini, mbase ju keni nevojë për të dhe mos i bëni shterpë kafshët, mishi i të cilëve hahet, përveç asaj që nuk dëshironi të hani. Nëse takoni një armik të myslimanëve, atëherë ftojini ata në njërën nga tri gjërat. Nëse ata ju përgjigjen, atëherë pranojini dhe mos i luftoni’”. (El Al'lametu Et Tabatabai, “Sunen En Nebij”, f. 84-86.)

vendosej në një vend të veçantë, duke qëndruar larg rrezikut.

Arsyeja për këtë ishte e qartë. Ajo ka dhe një aspekt të arsyeshëm dhe logjik. Nëse komandanti ishte në front dhe pastaj vritej, atëherë i gjithë aparati ushtarak do të tronditej. Por, nëse ai ishte prapa, mund të vazhdonte betejën, edhe nëse gjysma e ushtarëve do të vriteshin, dhe të paktën ai mund të tërhiqej dhe të mbijetonin. Në rast se vritej komandanti, jo vetëm që gjërat do të ndërlikoheshin, por edhe humbjet do të ishin edhe më të mëdha.

Për sa i përket të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*), ai ishte i pajisur me fuqi të mbinatyrshme. Ai qëndronte në ballë të frontit. Kur lufta ndizej dhe ashpërsohej, kur armiku fillonte sulme të fuqishme, aq sa dhe ata që ishin pranë tij, siç ishte Prijësi i besimtarëve, Hamzai dhe të tjerët, nuk ishin në gjendje të duronin dhe të rezistonin, strehoheshin tek ai.¹⁸³

¹⁸³ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në qendrën “Teuhid”, më 1.11.1986 (10.8.1365).

Mënyra e pranimit të paqes

Në vitin e gjashtë të hixhretit, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) u nis drejt Mekës. Allahu i Madhëruar i premtoi të Dërguarit të Tij se do të hynte në Mekë dhe i Dërguari, nga ana tjetër, i informoi njerëzit për këtë. Myslimanët erdhën me mendimin se do të hynin në Mekë. Armiqtë u mbledhën në një vend të quajtur el Hudejbije dhe i penguan ata të përparonin. Ata donin t'i vrisnin myslimanët dhe t'i zhduknin plotësisht, por Allahu i Madhëruar i ruajti myslimanët dhe robtë e Tij.

Çështja përfundoi me nënshkrimin e një traktati paqeje, e njohur si “Marrëveshja e Paqes së Hudejbijes”. Kur po e shkruanin traktatin e paqes, Profeti i kërkoi Prijësit të besimtarëve të shkruante, sipas emrit të Muhamedit, fjalën “I Dërguari i Zotit”. Ata kundërshtuan dhe thanë: “Ne nuk besojmë se ti je i Dërguari i Zotit”.

I Dërguari u pajtua dhe i kërkoi Prijësit të besimtarëve ta hiqte këtë fjalë.

Prijësi i Besimtarëve i tha të Dërguarit se zemra e tij nuk e lejonte ta hiqte këtë fjalë, kështu që i Dërguari e ndërroi vetë. I Dërguari e filloi këtë traktat paqeje me frazën: “Në emër të Allahut, Mëshiruesit, të

Gjithëmëshirshmit!”, që përfaqëson parullën islame. Jobesimtarët kundërshtuan, duke thënë se ata nuk e njihnin Mëshiruesin për të cilin po fliste dhe i kërkuan ta fillonte me frazën “Në emër të Zotit”, që është shprehja e përdorur nga politeistët dhe jobesimtarët kurejsh. Profeti pranoi të shkruante frazën “Në emër të Zotit”. Myslimanët u çuditën nga rrjedha e ngjarjeve.

Disa myslimanë filluan ta ngrenë zërin dhe të bëjnë zhurmë, si dhe iu drejtuan të Dërguarit me fjalët: “Çfarë po bëni? A nuk jemi në të drejtë? A nuk janë ata në të gabuar?” Çështja arriti sa njëri prej sahabëve të njohur ka thënë se atë ditë ai u bë dyshues për profecinë e të Dërguarit. A i dini ajetet që foli Kur’ani për këtë çështje? Ajetet e para të sures “El Fet’h”: **“Ne të dhamë ty një fitore të qartë”**.

Këto ajete i referohen kësaj marrëveshjeje. Fitorja e qartë, për të cilin flet Kur’ani, është marrëveshja e Hudejbijes. Ajo nuk është asnjë nga luftërat e Bedrit, Hunejnit, Uhudit dhe Ahzabit. Në luftërat para marrëveshjes së Hudejbijes, i Dërguari i Allahut ishte në një vend të pushtuar, si Bedri; në një vend tjetër ai pësoi një dështim, si Uhudi; në vendin e tretë ai u rrethua, si Ahzabi dhe në një vend tjetër, çështja përfundoi me lamtumirë, si në disa luftëra të tjera.

Marrëveshja e Hudejbijes nuk e rrëzoi parullën për luftën në Bedr dhe Uhud. Ato nuk ishin aspak parulla të gabuara, pasi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) nuk u tërhoq nga parulla e luftës me jobesimtarët dhe politeistët, si dhe as nuk ndryshoi qëndrim.

Sidoqoftë, interesi atë ditë e kërkonte ashtu si ajo ndodhi, ashtu siç e kërkonte interesi për Bedrin, që ndodhi, si dhe në Uhud dhe Ahzab. Këto janë rrënjët historike të këtyre veprimeve. Ju e vëreni se gjithçka në historinë e Islamit vlen sipas një sistemi logjik, të qartë dhe në vendin e tij.¹⁸⁴¹

Mënyra e trajtimit të humbësve dhe robërve

Shokët shkuan tek i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) me disa të krishterë të kapur në disa luftëra, qofshin nga fise arabe apo jo arabe. Ata ishin të ndikuar nga morali i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*). Prej kësaj sjellje ata motivoheshin që të hynin në Islam dhe të pranonin fenë e të Dërguarit. Kjo ishte

¹⁸⁴ Hytbeja e namazit të xhumasë, në Teheran, më 22.7.1988 (31.4.1367).

sjellja e urtë dhe butësia e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).¹⁸⁵

Luftërat mbarojnë, por përvojat mbeten. Ngjarjet e mëdha mbartin mësim për njerëzimin. Ky mësim do të mbetet në zemrat dhe mendjet e njerëzimit. Ai është se një qytetërim, pavarësisht gjithçkaje në të dhe me të gjitha pretendimet e tij, doli i mundur nga arena e provës përmes veprimeve të praktikuara nga këta (amerikanët). Ata ndezin luftëra, bënë padrejtësi, mendjemadhësi dhe sjellje joracionale. Ndër përvojat më të spikatura të këtij qytetërimi, janë ndezja e luftërave, kërcënimi i paqes, vrasja e të pafajshmëve, shpenzimi i kapitalit të madh në luftëra, nën justifikime jo të besueshme.

Krahasoni këtë me qytetërimin islam, kur myslimanët hapën rajonet perëndimore të botës islame, domethënë, rajonet e romakëve dhe të Sirisë së sotme, në kohën e kalifëve të drejtë. Ata silleshin me hebrenjtë dhe të krishterët në një mënyrë që shumë prej tyre u udhëzuan dhe kthyen drejt Islamit. Në vendin tonë, në Iran, shumë njerëz u dorëzuan pa rezistencë, sepse ata panë mëshirën dhe mirësjelljen e myslimanëve kundër armiqve, kështu që ata vetë erdhën në Islam. Historia përmend se, kur myslimanët hynë në Romë, hebrenjtë thërrisnin frazën:

¹⁸⁵ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në qendrën “Teuhid”, më 1.11.1986 (10.8.1365).

“Ue Teurat”, duke u betuar në Teurat, se nuk kishim parë kurrë një ditë kaq të bukur në jetën e tyre si kjo.¹⁸⁶

Mësim krenarie

Dija e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte bashkëshoqëruese me moralin; qeverisja me urtësinë; adhurimi i Zotit me shërbimin ndaj krijesave; xhihadi me mëshirën; dashuria e Zotit me dashurinë për krijesat e tij; krenaria me përulësinë; menaxhimi i përditshëm me largpamësinë; miqësia me thellësinë politike; zhytja e shpirtit në përkujtim të Zotit me vëmendje për atë që është në interes dhe ruajtjen e trupit. Dynjaja dhe Ahireti u bashkëshoqëruan me qëllime të larta hyjnore dhe me synime tërheqëse njerëzore.¹⁸⁷

Mësim edukimi

Myslimanët nuk janë të vetmit që përfituan nga mësimet e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë*

¹⁸⁶ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë, më 10.15.2001 (23.7.1380).

¹⁸⁷ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në mbledhjen e vizitorëve në xhaminë Redauij, më 21.3.2006 (1.1.1385).

mbi të dhe mbi familjen e tij!). Njohuritë bashkëkohore në botë, civilizimi bashkëkohor, njohuritë që ekzistojnë sot në këtë botë dhe zhvillimi i karvanit njerëzor, të gjitha varen nga ekzistenca e tij. Ky kuptim nuk është ajo që pretendojmë ne, myslimanët. Të gjithë historianët dhe njerëzit e drejtë pajtohen se shfaqja e zgjimit shkencor (rilindjes) në botën islame, kontribuoi në transmetimin e tij në vende të tjera përmes shkëmbimit, madje edhe përmes pushtimeve dhe luftërave.¹⁸⁸

Një mësim për mëshirën dhe dinjitetin

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) mund të krahasohet me yllin më të ndritshëm në mesin e qenieve të botës, si dhe t'i referohet asaj qenie të madhe e të shenjtë me këtë titull. Pse themi ylli vezullues dhe nuk themi diell? Sepse dielli është një trup specifik dhe i përcaktuar, i ndritshëm dhe madhështor, por është një trup dhe një top qiellor.

Në yjet që shihni, ka yje që formojnë një galaktikë, mijëra herë më të mëdha se galaktikat që ne shohim mbi kokat tona në qiell në netët e verës. Një galaktikë është një grup që përmban mijëra yje dhe mijëra diej. Ekzistenca e të

¹⁸⁸ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në mbledhjen e vizitorëve në xhaminë Redauij, më 1.7.1999 (10.4.1378).

Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) është e ngjashme me ekzistencën e galaktikës dhe në të ka mijëra pika të ndritshme të virtytit.

Mësim uniteti

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) e filloi punën e tij, sapo hyri në qytetin e Medines. Ai ndërtoi një xhami, pastaj planifikoi administrimin dhe politikën e atij sistemi. Mund të mos jetë e mundur t'i kushtohet vëmendje, nëse një person shikon secilën ngjarje veç e veç. Prandaj, ai duhet të kontrollojë dhe të shohë se si është organizuar puna dhe veprimtaria, si janë bërë të gjitha këto veprime, në një mënyrë që tregon për masën, ndërgjegjësimin dhe llogaritjen e saktë.

Fillimisht, u hodhën bazat e unitetit. Banorët e Medines nuk u konvertuan të gjithë në Islam, shumica e tyre u konvertua në Islam, por disa mbetën jomyslimanë. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) krijoi një marrëveshje të përgjithshme kolektive.

Lëvizja tjetër që bëri i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) ishte vëllazërimi. Ndër fatkeqësitë më të mëdha që kishte

pllakosur në atë kohë shoqërinë fanatike dhe injorante arabe, ishin aristokracia, fanatizmi supersticioz, krenaria fisnore dhe ndarja e klasave të ndryshme të njerëzve nga njëri-tjetri. Kur Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) bëri thirrje për unitet, ai i shkelte të gjitha.¹⁸⁹

Mirësia e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) qëndronte në majën e botës së krijimit, për sa i përket personalitetit. Qoftë në ato dimensione që njerëzit mund të kuptojnë, siç janë standardet e larta njerëzore, si: arsyeja, menaxhimi, vetëdija, bujaria, mëshira, falja, si dhe çështje të tjera të kësaj natyre, qoftë në dimensionet që nuk janë të rrethuara nga mendjet njerëzore: dimensionet që tregojnë shfaqjen e emrit më të madh të së vërtetës, në praninë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe pozicioni i afërsisë së të Dërguarit me Allahun e Madhëruar.

¹⁸⁹ Nga fjala e Imam Khameneit (*Allahu i dhëntë jetë të gjatë!*) në një takim me zyrtarët shtetërorë, më 20.5.2000 (31.2.1379).

Sa prekëm më sipër, janë çështje për të cilat dëgjojmë dhe i njohim vetëm me emër dhe formë, por realiteti i tyre është i njohur për Allahun e Madhëruar dhe evlijat e mëdhenj. Po kështu, mesazhi i atij njeriu të madh është mesazhi më i lartë dhe më i rëndësishëm për lumturinë njerëzore, mesazhi i monoteizmit, mesazhi i ngritjes së gradës njerëzore.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	5
E VËRTETA EKZISTENCIALE.....	11
- Pishtari ndriçues.....	11
- Përgëzimi me mesazhe, në transmetimet e feve të mëparshme.....	13
BIOGRAFIA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT <i>(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)</i>	15
- Prejardhja e tij fisnike.....	15
- Pasardhës i një prej familjeve më të mira.....	16
TERRENI PËR FORCIMIN E ISLAMIT.....	18
- Mjedisi i të Dërguarit të Allahut <i>(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)</i>	18
- Familja e Profetit Muhamed <i>(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)</i>	19
VETITË MORALE TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT <i>(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!)</i>	23
- Edukata hyjnore.....	23
- Lidhja me botën e fshehtë.....	26

- Pagabueshmëria.....	27
- Mesazhi.....	29
MREKULLITË.....	31
- Kur'ani.....	31
- Madhështia e Kur'anit.....	32
- Mënyra e zbritjes së Shpalljes.....	34
- Fazat e zbritjes.....	36
- Hapat për njohjen e Kur'anit.....	39
- Mbrojtja nga shmangiet.....	45
- El-Miraxhi.....	46
- Përballja me udhëheqjen hyjnore dhe sundimin absolut.....	48
- Padrejtësia.....	49
- Bashkimi i virtyteve të larta.....	52
- Përfundimi i profetësisë.....	53
SHENJAT (NDIKIMET, GJURMËT) DHE BEREQETI I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).....	54
- Dridhja e flamujve të politeizmit dhe adhurimit të idhujve.....	54
- Zbritja e mëshirës hyjnore mbi njerëzimin.....	56
- Lëvizja e myslimanëve drejt përsosmërisë.....	57
- Prirja ndaj Islamit.....	58
- Uniteti i myslimanëve.....	58
MORALI I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).....	60
- Etika e të Dërguarit të Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!).....	60

- Përkushtimi i të Dërguarit të Allahut (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>) ndaj Zotit.....	62
- Adhurimi dhe kërkimi i faljes (istigfari).....	64
- Përmendja vazhdimisht e Allahut.....	65
- Mbështetja tek Allahu.....	66
- Të mos kesh frikë nga askush, përveç Allahut.....	67
MARRËDHËNIA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>) ME VETVETEN.....	68
- Disiplina dhe rregulli.....	68
- Nderimi dhe prestigji.....	70
- Pastërtia.....	71
- Thjeshtësia në veshje.....	72
- Qëndrueshmëria dhe drejtësia.....	74
MARRËDHËNIET E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>) ME NJERËZIT.....	75
- Modestia dhe dëlirësia.....	75
- Falja dhe toleranca.....	75
- Ndërsshmëria.....	78
- Dashuria.....	79
- Drejtësia.....	80
- Shpenzimet.....	81
- Sjella e Profetit Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>) larg arrogancës.....	82
- Trimëria.....	82
- Thjeshtësia.....	82
- Shërim për dhembjet e njerëzve.....	85

MORALI QEVERISËS.....	86
- Robërim dhe bindje e pastër ndaj Zotit.....	86
- Baza është robëria ndaj Zotit.....	86
- Thirrja drejt të drejtës dhe të vërtetës.....	87
- Xhihadi në rrugën e thirrjes për të vërtetën.....	88
- Përmbushja e premtimeve.....	90
THEMELIMI I QEVERISJES ISLAME.....	92
- Misioni i të Dërguarit të Allahut (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>) për krijimin e qeverisë islame.....	92
-Përkujdesje serioze për të siguruar interesat e myslimanëve.....	95
- Durimi dhe përballimi i vështirësive.....	97
- Vendosja e rregullit në shoqëri.....	98
- Puna për të vendosur drejtësinë mes njerëzve.....	98
- Mirësjellja.....	101
- Caktimi në udhëheqje.....	102
- Pasimi i ligjit hyjnor.....	104
- Njohja e armikut.....	106
- Veprimet e sakta politike përballë armikut.....	109
KRIJIMI I NJË ATMOSFERE BESNIKËRIE DHE NJOHJA E TË VËRTETËS.....	112
- Ruajtja e besëlidhjes.....	112
- Promovimi i diturisë.....	115
- Krijimi i një atmosfere për të punuar dhe për të vepruar në shoqëri.....	116
- Kujdesi dhe vëmendja ndaj gjërave materiale, për të arritur në ato shpirtërore.....	116

- Përhapja e një atmosfere vëllazërimi dhe bashkëpunimi.....	117
- Ndërthurja dhe gërshetimi i jetës së njerëzve me vlerat islame.....	118
MJEDISI QË TË RRETHON, DUHET TË JETË I SHËNDETSHËM.....	119
- Shfaqja e optimizmit dhe largimi i pesimizmit.....	119
- Përballja me përhapjen e thashethemeve.....	120
- Largimi i urrejtjes, smirës dhe armiqësisë.....	123
- Krijimi i një atmosfere dashurie.....	124
- Luftimi i indiferencës.....	127
- Luftimi i besëtytnive të injorancës.....	127
- I butë me besimtarët dhe i ashpër me jobesimtarët.....	128
- Marrëdhënia me të huajt.....	129
- Kujdesi për të rinjtë.....	130
- Këshillimi në marrjen e vendimeve.....	132
MËSIMET PROFETIKE.....	134
- Mësimi i dijes.....	134
- Mësimi i sjelljes dhe trajtimi i familjes.....	135
- Marrëdhënia e tij me njerëzit.....	138
- Sjellja e zyrtarëve me njerëzit.....	139
- Marrëdhënia me mësuesit dhe studentët.....	141
- Trajtimi i të gjithëve me dashuri.....	142
- Marrëdhënia me besimet e gabuara dhe kufizimet shoqërore.....	142
LEKSIONE LUFTE.....	144
- Objektivat dhe motivet.....	144
- Rregullat që duhet të kihen parasysh në luftë.....	145

- Mënyra e pranimit të paqes.....	148
- Mënyra e trajtimit të humbësve dhe robërve.....	150
- Mësim krenarie.....	152
- Mësim edukimi.....	152
- Një mësim për mëshirën dhe dinjitetin.....	153
- Mësim uniteti.....	154
- Mirësia e të Dërguarit të Allahut (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!</i>).....	155

اسم الكتاب: الشخصية القيادية للنبي محمد صلى الله عليه وآله في فكر الامام الخامني دام ظله

المؤلف: الامام الخامني دام ظله

المترجم: الحاج الشيخ ولنت مريا

التصحيح اللغوي و الأدبي: بيردا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا - 2021